



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 93

**Tiranë – E hënë, 1 korrik 2019**

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 70/2019, datë 20.6.2019	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 86/2017 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar 6699
Vendim i Kuvendit nr. 71/2019, datë 20.6.2019	Për disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 6699
Rezolutë e Kuvendit datë 20.6.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2018..... 6699
Rezolutë e Kuvendit datë 20.6.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2018..... 6702
Rezolutë e Kuvendit datë 17.6.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2018..... 6705
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 412, datë 19.6.2019	Për miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit 6706
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 26.6.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar..... 6806
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 423, datë 26.6.2019	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 5.3.2019, për çështjen “Rinaldo Myrtaj dhe të tjerët kundër Shqipërisë” (për kërkesën nr. 62907/16)..... 6806
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 26.6.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Marqinet-1 dhe lagja ‘Llanaj’”, në Bashkinë e Vorës..... 6807

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.6.2019	Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre.....	6808
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 427, datë 26.6.2019	Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës, sipas niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, për arsimin dhe formimin profesional.....	6810
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 428, datë 26.6.2019	Për miratimin e tabelës së përshkruesve të detajuar për çdo nivel të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.....	6816
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 26.6.2019	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.....	6822
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 26.6.2019	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale.....	6825
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 26.6.2019	Për funksionimin, organizimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”.....	6828
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 26.6.2019	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 327/1, zona kadastrale 2671, Bashkia Finiq.....	6831
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 26.6.2019	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 120/10, zona kadastrale 1167, Bashkia Vorë.....	6834
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 26.6.2019	Për shkëmbimin e pronës/pasurive me nr. 171/59, nr. 171/143, zona kadastrale 3963, me sipërfaqe 12000 m <sup>2</sup> , me pasuritë me nr. 401/5, nr. 401/3, nr. 53/46, nr. 53/33, zona kadastrale 2735, me sipërfaqe 9956 m <sup>2</sup> .....	6839
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 439, datë 26.6.2019	Për rishpërndarje fondesh buxhetore brenda programeve të miratuara në buxhetin e vitit 2019, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	6844
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 440, datë 26.6.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 46, datë 30.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019”.....	6844
Urdhër i drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 380, datë 26.6.2019	Për delegim kompetencash.....	6846



**VENDIM  
Nr. 70/2019**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN  
E KUVENDIT NR. 86/2017 “PËR  
CAKTIMIN E KRYESIVE TË  
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË  
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, dhe të neneve 21, pika 1, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Grupit Parlamentar Demokrat,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në pikën I të vendimit të Kuvendit nr. 86/2017, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

I. Deputeti Arben Elezi caktohet Zëvendëskryetar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 20.6.2019

**VENDIM  
Nr. 71/2019**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN E  
KUVENDIT NR. 90/2017 “PËR  
CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË  
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME  
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, dhe të neneve 21, pika 2, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Grupit Parlamentar Demokrat,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Deputeti Korab Lita caktohet anëtar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

2. Deputeti Halil Jakimi caktohet anëtar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 20.6.2019

**REZOLUTË  
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË  
ENTIT RREGULLATOR  
TË ENERGJISË PËR VITIN 2018**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

- Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë, si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

- Duke konstatuar faktin që viti 2018 shënon fillimin e prodhimit të energjisë nga impiantet fotovoltaike, prodhues të tillë i hapin rrugën një kategorie të re të klientëve, të cilat janë të përhapura tej mase në vendet e Evropës Perëndimore të quajtur *Prosumers*, të cilët prodhojnë energji elektrike për nevojat e veta dhe mund të shesin një sasi të energjisë elektrike në treg;

- Duke konsideruar që një liberalizim i mëtejshëm i tregut të energjisë elektrike synon një siguri më të lartë furnizimi dhe një zhvillim më të mirë, kompetitiv dhe transparent të tregut të energjisë elektrike;

**Vlerëson për vitin 2018:**

- Trendin pozitiv sa i takon uljes së humbjeve të përgjithshme të raportuara nga OSHEE për



vitin 2018, të cilat arritën në masën 23,96 % krahasuar me shifrën prej 26,41% të një viti më parë dhe inkurajon OSHEE-në të vazhdojë në këtë drejtim, me qëllim arritjen e parametrave normalë të operimit.

- Nivelin e lartë të arkëtimit në total, i raportuar nga OSHEE sh.a., i cili ishte 101,9% kundrejt energjisë elektrike të faturuar për vitin 2018, shifër në të cilën përfshihen edhe arkëtimet e prapambetura të periudhës 2007–2017.

- Miratimin nga ERE, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, të “Planit të masave për OSHEE sh.a. për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”, i cili identifikon qartë përgjegjësitë e furnizuesit në kuadër të detyrimit të shërbimit publik.

- Vendimet e përbashkëta që Enti Rregullator i Energjisë së bashku me entet rregullatore të Greqisë dhe Italisë, kanë marrë në lidhje me projektin TAP-AG, vendime të cilat janë marrë në përputhje të plotë me Direktivën përkatëse të BE-së.

- Miratimin e strukturës së re të ERE-s në prill 2019, kërkesë e vazhdueshme edhe në raportet ndërkombëtare, përfshirë edhe raportprogresin, si dhe nga Sekretariati i Energjisë, misionet e ekspertëve të BE-së, në të cilët është theksuar domosdoshmëria e pavarësisë dhe rritjes së kapaciteteve njerëzore të ERE-s.

- Bashkëpunimin e ERE-s, përmes përfaqësuesve të saj në 3 grupet e punës të ngritura me qëllim bërjen efektive të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, si dhe bashkimin e tregjeve të një dite më parë me Kosovën, gjithashtu po në këtë kuadër vlerëson miratimin dhe firmosjen e “Memorandumit të mirëkuptimit mbi bashkëpunimin e tregjeve ditore të energjisë elektrike mes palëve” ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

- Vlerëson punën e ERE-s për rishikimin e rregullores së licencimit në sektorin e energjisë elektrike, duke pasur në vëmendje përmbushjen e detyrimit për njohjen reciproke në vendet e rajonit, si dhe duke shtuar si kriter për pajisjen me licencë nga ERE edhe miratimin nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) të projektit të digës, si dhe leja e vënies në ngarkesë për herë të parë të digës e objekteve.

- Punën e bërë nga ERE në plotësimin e kuadrit ligjor me legjislacionin sekondar, në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshimeve që ky ligj ka pësuar me ligjin nr. 7/2018, si dhe në funksion të vendimeve të Këshillit të Ministrave.

- Punën bërë nga ERE për plotësimin e kuadrit ligjor në legjislacionin sekondar, në zbatim të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” në përputhje me Direktivën 2009/73/EC, si dhe Rregullores EC nr. 715/2009.

- Punën e bërë nga ERE për reflektimin në legjislacionin aktual rregullator të ndryshimeve të nevojshme, në përputhje me Paketën e Tretë të BE-së në fushën e energjisë.

#### **Rekomandon për vitin 2019:**

- Të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për marrjen e masave të nevojshme për monitorimin e ndarjes së OSHEE sh.a., sipas parashikimeve ligjore. Proces i cili shoqërohet me ndarjen ligjore, funksionale dhe organizative ndërmjet aktivitetit të shpërndarjes dhe Furnizuesit Universal. Nga ana tjetër, të vijojë ndarja e aktiviteteve, llogarive dhe kostove midis Furnizuesit të Mundësisë së Fundit dhe aktiviteteve të tjera, duke mundësuar shërbim të sigurt, kompetitiv, transparent dhe me cilësi të klientëve fundorë.

- Të luajë një rol proaktiv për rishikimin e akteve ligjore dhe nënligjore respektive, gjatë periudhës transitorë, për bërjen efektive të ndarjes ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

- Të vijojë bashkëpunimin me aktorët e mandatuar për operimin dhe monitorimin e Bursës së Energjisë.

- Të propozojë ndryshimet e nevojshme pranë MIE për zbatimin e kërkesave të certifikimit të operatorëve të transmetimit në përputhje me opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

- T’i kushtojë një vëmendje të veçantë implementimit të planit të masave nga OSHEE sh.a. në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, si dhe përditësimit të tij në funksion të problematikave që kanë dalë përgjatë zbatimit të tij, duke u fokusuar në zgjidhjen e ankesave të





klientëve në një kohë sa më të shkurtër. Lidhur me zbatimin e tij, të monitorojë në mënyrë periodike, çdo tre muaj, OSHEE-në dhe të informojë çdo katër muaj Kuvendin e Shqipërisë.

- Të punojë, në bashkëpunim me aktorët e tjerë, nga njëra anë për nxitjen e investimeve në impiante të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, si centralët fotovoltaikë, eolike, biomasë etj., investime të cilat sjellin edhe një diversifikim gradual të prodhimit të energjisë, dhe nga ana tjetër të bashkëpunojë me MIE në përgatitjen e kuadrit ligjor dhe rregullator për thithjen e tyre, si dhe uljen e kostove apo dhe shpërndarjen e drejtë të tyre tek të gjithë klientët.

- Të bashkëpunojë me MIE për kryerjen e një vlerësimi për menaxhimin e riskut hidrologjik në mënyrë që të menaxhohen risqet e rritjes së kostove të furnizimit të energjisë elektrike për klientët fundorë, për shkak të kushteve klimatike, si dhe të konsiderojë mundësinë e krijimit të një fondi garancie nga KESH me përfitimet financiare të nxjerra gjatë një viti hidrologjik të mirë, të cilat mund të kompensojnë riskun financiar të një viti hidrologjik jo të mirë.

- T'i kushtojë vëmendje të veçantë, gjatë vitit 2019, implementimit të strukturës së miratuar dhe rekrutimit të një stafi sa më të aftë profesionalisht për përballimin e sfidave të sektorit të energjisë dhe gazit natyror, profesionalizmi i stafit ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së punës dhe pavarësisë operationale të ERE-s.

- Të vazhdojë punën së bashku me entet rregullatore të Italisë dhe Greqisë për marrjen e vendimeve dhe nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse për projektin TAP-AG dhe krijimin e kushteve për hapjen e tregut të gazit natyror në vendin tonë, në përputhje me direktivën 2009/73/EC dhe Rregulloren 715/2009, EC.

- Të japë opinion për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe atë të Financave dhe Ekonomisë për gjetjen e rrugëve dhe zgjidhjeve për shuarjen e detyrimeve reciproke midis operatorëve publikë të sektorit të energjisë elektrike dhe marrjen e masave për parandalimin e krijimit të tyre në të ardhmen.

- Të punojë për hartimin e një strategjie për infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë, në përputhje me direktivën e BE-së “Mbi sigurinë e sistemit dhe sistemeve informatike”, duke

përfshirë në listën e këtyre infrastrukturave dhe infrastrukturave të kompanisë publike të gjenerimit apo dhe impiantet private të gjenerimit, të cilat mund të kenë impakt në sigurinë territoriale.

- Të bëjë vlerësimet e propozimeve të paraqitura nga OSHEE, pas përfundimit të “Studimit të vlerësimit të humbjeve të energjisë elektrike në traktin e lidhjes nga njësi gjeneruese deri në pikën e lidhjes me rrjetin e OSHEE sh.a.”, lidhur me humbjet e OSHEE-së prej pikës së lidhjes së prodhuesve të energjisë.

- Të kërkojë nga OSHEE, që pas shtyrjes së afateve të përcaktuara në rregulloren “Kriteret Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike”, shtyrje në të cilën OSHEE kërkojë një aplikim të përshkallëzuar për të miratuar nivelin e lejuar të kriterëve standarde të performancës në zona të ndryshme, respektimin që brenda kësaj periudhe shtyrjeje shoqëria të dorëzojë në ERE një studim të detajuar mbi përshkallëzimin e realizimit të parametrevave të kërkuara sipas zonave të sipërcituara dhe vënien e treguesve për monitorimin e tyre.

- Të caktojë afate konkrete për OSHEE-në lidhur me vënien sa më shpejt në punë të sistemit të ri të faturimit, të paktën në disa projekte pilot të identifikuar nga vetë OSHEE, i cili lehtëson në mënyrë të ndjeshme leximin e matjes së energjisë dhe krijon mundësi dhe opsione të reja, duke përfshirë edhe leximin periodik disamujor, si dhe në përfundim të konsultimeve me palët e interesit, aty ku kushtet teknike të kompanisë e lejojnë, të sigurojë përfshirjen në kontratën tip për vitin 2019 të kësaj mënyre leximi të sistemit të matjes.

- Të kërkojë nga OSHEE që në periudhë afatshkurtër të mundësojë lidhjen në rrjetin e shpërndarjes të impianteve fotovoltaikë në ndërtesa, nxitja e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme është një prioritet i përcaktuar edhe në ligjin përkatës.

- Të vijojë punën për mbrojtjen e konsumatorit përmes kompetencave që i jep ligji, mosrespektimi i afateve për shërbimet përkatëse, sjelljet arbitrare dhe të papërgjegjshme ndaj klientëve vijnë të mbeten problem me gjithë uljen e numrit të ankesave pranë ERE-s. OSHEE duhet të ofrojë një qasje të re për shërbimin e kujdesit ndaj klientit.



- Të kërkojë nga OSHEE anulimin e faturimeve të klientëve të energjisë elektrike, të cilët janë faturuar nën emërtimin “energji e pamatur” dhe “dëm ekonomik” në periudhën tetor 2008–prill 2011. Me gjithë vendimin e ERE-s, problemi vijon të mbetet i pazgjidhur.

- Në bashkëpunim me OSHEE-në dhe institucionet përgjegjëse, të mbështesë propozimet për dhënien e një zgjidhjeje të problemit të pronësisë së kabinave elektrike, 51,3% e të cilave nuk janë në pronësi të OSHEE-së, si dhe të disa rrjeteve shpërndarëse të energjisë në pronësi private, duke krijuar kështu pengesa për të drejtën e ndërhyrjes dhe kryerjen e shpenzimeve financiare nga ana e OSHEE-së në rastet e nevojshme, si dhe të japë opinion nëse është e nevojshme për ndryshimet në legjislacion për zgjidhjen e këtij problemi në të ardhmen.

Miraturar në datën 20.6.2019

KRYETAR  
Gramoz Ruçi

## REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË PROKURORISË PËR VITIN 2018

### Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

- Rolin e Prokurorit të Përgjithshëm në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre;

- Raportimin në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit dhe për zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave për kriminalitetin dhe ndikimin e tyre në gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara;

- Kontributin e prokurorisë në hartimin e statistikave të njehsuara në fushën e drejtësisë që shërbejnë si bazë për të analizuar kriminalitetin, prirjet e tij, politikën penale të zbatuar dhe efektivitetin e saj, efektivitetin e instituteve penale të parashikuara në kuadër të reformës në drejtësinë penale;

**Bazuar në analizën e të dhënave të referuara nga Prokuroria e Përgjithshme në**

### **raportin e paraqitur, Kuvendi i Shqipërisë vëren se gjatë vitit 2018:**

- Materialet kallëzuese të trajtuara nga prokuroria dhe procedimet penale të regjistruara kanë shënuar ulje, ndërsa numri i ndjekjeve penale është rritur, krahasuar me vitin 2017.

- Procedimet penale të përfunduara, të pushuara, numri i çështjeve penale dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë është rritur, në krahasim me vitin 2017.

- Mosfillimet e procedimeve penale për kallëzime dhe referime dhe i çështjeve të pezulluara është ulur në krahasim me vitin 2017.

- Procedimet penale për veprat penale “Vjedhje e pasurisë” zënë vendin e parë (33,67%), pasuar nga veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike (23,99%), ato që cenojnë regjimin juridik të tokës (4,75%), veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes (4,31%), shkatërrimi i pronës (3,97%) dhe falsifikimi i dokumenteve (3,56%).

- Për sa i përket të pandehurve, shumica e tyre janë meshkuj (95,19 %); përfshirja e të miturve është e ulët (3,37% janë të mitur-djem); 47,42 % e të pandehurve kanë arsim deri 9 vjet; 50,29% e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të mesëm dhe 2,29 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të lartë; 64,34% e të pandehurve janë të papunë, 34,88% e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat dhe 0,78% rezultojnë të punësuar në sektorin publik; rreth 65,57% e të pandehurve janë banues në zonat urbane; vetëm 6,32% e të pandehurve janë përsëritës në krim.

### **Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi:**

- Rezolutën e Kuvendit, datë 20.9.2018, “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2017” dhe konstaton se Prokuroria e Përgjithshme, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në lidhjen 3, pika 5, të vendimit të Kuvendit nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, ka plotësuar rekomandimet e rezolutës së Kuvendit.

- Rekomandimet e Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018”, të miratuara me vendimin nr. 203, datë 11.4.2018, në zbatim të nenit 103, pika 3, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e



prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe mbështet gjetjet dhe analizën e bërë nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me nivelin e zbatimit të tyre.

#### **Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:**

- Procedimet e regjistruara për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” janë rritur, ndërsa numri i procedimeve penale për veprat e tjera penale të tjera në fushë ka shënuar ulje.

- Numri e hetimeve proaktive lidhur me veprën penale të korrupsionit dhe i çështjeve të dërguara në gjykatë është ende i ulët.

- Hetimet proaktive për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimit të narkotikëve dhe kultivimit të bimëve narkotike janë rritur.

- Hetimet pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, mjeteve dhe produkteve të veprave penale me origjinë krimin e organizuar, sipas legjislacionit të fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, janë ende në nivele të ulëta.

- Respektimi i rregullave, procedurave për ruajtjen e sekretit hetimor për procedimet ka cenuar besimin e publikut në hetimet penale.

- Statistikat për procedimet penale për lloje të caktuara të veprave penale dhe në nivel të prokurorisë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm nuk janë të standardizuara.

- Ka vijuar puna në mbështetje të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, sipas detyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

- Bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel qendror dhe vendor në përgjithësi është rritur, por ka ende nevojë për përmirësim dhe rritje të cilësisë së tij.

- Bashkëpunimi me autoritetet gjyqësore të huaj për të shkëmbyer informacion lidhur me veprimtaritë e grupeve kriminale që shtrijnë aktivitetin jashtë vendit dhe për krijimin e grupeve hetimore të përbashkëta për hetimin dhe goditjen e veprimtarisë së tyre brenda dhe jashtë vendit është rritur, por ka ende nevojë të forcohet.

- Sektori i verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, pranë Prokurorisë e

Përgjithshme, ka administruar 185 raste për verifikim të thelluar.

- Angazhimi i Prokurorisë për zbatimin e rekomandimeve të Progresraportit të Bashkimit Evropian në lidhje me luftimin e kriminalitetit është rritur.

#### **Bazuar sa më sipër, për vitin 2019, Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Prokuroria e Republikës së Shqipërisë:**

1. Forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëpërmjet zbatimit më të mirë të procedurave të hetimit proaktiv dhe përdorimit në kufijtë e ligjit të teknikave speciale të hetimit.

2. Sigurimin e zbatimit të drejtë dhe të njëjlojtë të procedurave për sa u takon hetimeve pasurore, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve. Brenda muajit tetor 2019, të përcjellë në Kuvendin e Shqipërisë një raport në lidhje me ecurinë e zbatimit të këtij rekomandimi.

3. Zgjerimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me agjencitë ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, me qëllim rritjen cilësore, thellimin dhe intensifikimin e hetimeve në funksion të zbulimit dhe goditjes të veprimtarisë kriminale brenda vendit dhe të lidhjeve të tij jashtë vendit.

4. Rritjen e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe autoritetet gjyqësore të huaja në të gjitha fushat e bashkëpunimit ndërgjyqësor, me qëllim shkëmbimin e informacionit lidhur me veprimtaritë e grupeve kriminale që shtrijnë aktivitetin me lidhjet e tyre jashtë vendit dhe nxitjen e krijimit e grupeve hetimore të përbashkëta për hetimin dhe goditjen e veprimtarisë së tyre brenda dhe jashtë vendit.

5. Bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës për identifikimit dhe planifikimin e drejtë të nevojave për magjistratë në sistemin e prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm. Forcimi i marrëdhënie të Prokurorit të Përgjithshëm me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për qartësimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit është i mirëpritur.

6. Hartimin e udhëzimeve të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave për luftimin e kriminalitetit për vitin 2019. Kopje të udhëzimeve të miratuara të



përcillen në Kuvend, menjëherë pas miratimit të tyre.

7. Hartimin e një kalendari të trajnimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, sipas kërkesave dhe nevojave për zbatimin e reformës në drejtësi brenda muajit shtator të viti 2019, si dhe të fillojë zbatimin i tij.

8. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në konsulencë dhe me asistencë të partnerëve ndërkombëtarë, të hartohen/ose të përmirësohen manuale të mënyrës së identifikimit, evidentimit dhe ndjekjes së veprave penale të shtetasve shqiptarë, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim jo vetëm sigurimin e të dhënave për veprat penale, në të cilat shtetasit shqiptarë mund të jenë përfshirë si autorë, por edhe si viktime.

9. Përbushjen e rekomandimeve të adresuara për Prokurorinë e Përgjithshme nga Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

10. Raportimin në Kuvend brenda muajit dhjetor 2019 në lidhje me zbatimin e rregullave të trajtimit të të miturve me kontakt në drejtësinë penale dhe ecurinë e zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

11. Marrjen e masave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të veprës penale dhe për të adresuar dhe rekomanduar zgjidhje për zbatimin e drejtë të rregullave për kërkesat e viktimës akuzuese.

12. Përdorimin më efektiv të instituteve procedurale të reja si: urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë, duke hartuar dhe nxjerrje udhëzime të përgjithshme, me synim qartësimin e kuptimit dhe zbatimit në praktikë të kuadrit ligjor përkatës dhe mbikëqyrja e zbatimit tyre.

13. Mbledhjen, hedhjen dhe përpunimin, nga çdo prokurori, të statistikave të ndjekjes penale dhe të kriminalitetit, sipas standardeve ndërkombëtare, me qëllim që të mundësohet vlerësimi dhe krahasimi i kriminalitetit ndër vite dhe në raport me vendet e rajonit, në nivel evropian dhe ndërkombëtar, si dhe të mundësohet vlerësimi i politikës penale të zbatuar. Kuvendi kërkon dërgimin në Ministrinë e Drejtësisë të të dhënave statistikore të plota dhe të sakta për të gjitha veprat penale, të

pandehurit, viktimat, dëmet ardhura nga vepra penale dhe në lidhje me zbatimin e politikës penale.

14. Hartimi dhe nxjerrja e rregullave standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm që sigurojnë efikasitet në organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës në çdo prokurori.

15. Rritjen e pavarësisë së prokurorisë dhe forcimin e kuptimit më të mirë të përgjegjësive nga çdo prokuror. Në këtë kuadër, Kuvendi kërkon hartimin dhe nxjerrjen e rregullave për garantimin e pavarësisë së prokurorit, koordinimin e punës ndërmjet prokurorive të ndryshme, mes tyre dhe Policisë Gjyqësore të përfshira në hetime të përbashkëta.

16. Respektimin e ligjit për sekretin hetimor nga çdo prokuror dhe punonjës i prokurorisë. Në këtë kuadër, Kuvendi kërkon hartimin dhe nxjerrjen e rregullave të unifikuara për informimin e publikut dhe medias lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, duke respektuar parimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi në lidhje me ruajtjen e sekretit hetimor.

17. Hartimin dhe nxjerrjen e udhëzimeve në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, që mundësojnë përbushjen e qëllimit të ligjit.

18. Sigurimin e bashkëpunimit, koordinimit, shkëmbimit të informacionit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë, me të gjitha institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese që kanë shërbime të Policisë Gjyqësore.

19. Monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e ndjekjes penale, nëpërmjet mbikëqyrjes nga prokuroria të respektimit të të drejtave dhe lirive kushtetuese dhe në ligj të shtetasve.

20. Rritjen e angazhimit të prokurorisë për zbatimin e rekomandimeve të Progresraportit të Bashkimit Evropian në lidhje me ndjekjen penale dhe luftimin e kriminalitetit.

Miraturar në datën 20.6.2019

**KRYETAR  
Gramoz Ruçi**

**REZOLUTË****PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË  
INSPEKTORATIT TË LARTË  
TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT  
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT  
TË INTERESAVE PËR VITIN 2018**

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke besuar në objektivat dhe përpjekjet e vendit tonë për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, si kusht dhe detyrim thelbësor në kuadër të procesit të integritetit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe përballjen me sfidat e tij përmes një qasjeje të trefishtë ndërgjegjësuese, parandaluese dhe ndëshkuese;

- Duke theksuar rëndësinë e koordinimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse ligjzbatuese në vend dhe institucioneve të pavarura, për rritjen e efikasitetit të hetimeve penale apo administrative, si dhe ndëshkimin e praktikave korruptive, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete dhe të prekshme në parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit;

- Duke vlerësuar gjetjet në raportin për Shqipërinë për vitin 2018 të Komisionit Europian në lidhje me progresin e shënuar nga Inspektorati në zbatim të Strategjisë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit 2015–2020, arritjen e zbatimit të plotë të rekomandimeve të GRECO-s në Raportin e Katërt të Vlerësimit për Shqipërinë, si dhe sigurimin e mbështetjes së vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë për përmbushjen e objektivave prioritarë të institucionit;

- Duke inkurajuar e mbështetur Inspektoratin me forcimin e kapaciteteve administrative, teknike, financiare dhe të instrumenteve ligjore, me qëllim përmbushjen e misionit institucional për zbulimin e pasurimit korruptiv dhe praktikave të ngjashme me të, në parandalimin e konfliktit të interesave për të gjithë kategoritë e zyrtarëve, subjekteve të ligjit dhe personave të lidhur, si dhe inkurajimin për denoncimin e tyre;

Vlerëson veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, për vitin 2018, në drejtim të:

- Progresit të shënuar në funksionimin tërësor institucional dhe, në veçanti, në përmbushjen e të gjitha rekomandimeve të lëna në Raportin e Katërt të Vlerësimit për Shqipërinë të GRECO-s, si dhe në rezolutën e Kuvendit të datës 20.9.2018 “Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2017”.

- Performancës në rritje lidhur me zbulimin e rasteve të fshehjeve të pasurisë, si dhe shkeljeve të ndryshme të ligjit për deklarimin e interesave privatë, duke administruar një numër total prej 3679 deklaratash të interesave privatë, duke kaluar në kontroll të plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë 780 subjekte deklaruese, duke ndëshkuar me masën administrative “gjobë” për rastet e refuzimeve për deklarim, rastet e mosdeklarimeve dhe rastet e konfliktit të interesit 112 zyrtarë, si dhe duke paraqitur pranë Prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Policisë së Shtetit dhe strukturave të hetimit tatimor 53 raste referimesh penale.

- Mbështetjes së procesit reformues të sistemit të drejtësisë, si një masë e domosdoshme dhe emergjente për të rikthyer besimin e publikut tek institucionet e këtij sistemi, duke përfunduar verifikimin e të gjitha të dhënave të paraqitura gjatë vitit në deklaratat e pasurisë për 411 subjekte të rivlerësimit dhe duke dorëzuar dokumentacionin e plotë për gjyqtarët e gjykatave të apelit, Gjykatës së Apelit Administrativ, Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, si dhe prokurorët e prokurorive të apelit, Prokurorisë së Apelit të Krimeve të Rënda, ndihmësit dhe këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe gjykatave administrative.

- Përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, duke plotësuar 5 anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit që sipas përcaktimeve përzgjidhen mes punonjësve të institucionit, si dhe marrjen e masave për



kryerjen e procesit të kontrollit për subjektet e ligjit brenda afateve të parashikuara.

- Administrimit dhe analizimit të 404 raporteve të dërguara nga njësitë përgjegjëse, nga të cilat 157 i përkasin sektorit publik dhe 247 sektorit privat, si dhe përditësimit të të dhënave të regjistrave kombëtarë të këtyre njësive, sipas kompetencave që i janë caktuar Inspektoratit në dispozitat e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Zhvillimit të një sërë aktiviteteve trajnuese dhe informuese në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, si OSBE, Këshilli i Evropës etj., me qëllim rritjen e kapaciteteve të njësive përgjegjëse të sektorit publik dhe privat për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si dhe ndërgjegjësimin e publikut lidhur me mekanizmat e luftës kundër korrupsionit.

- Ofrimit të asistencës teknike dhe ligjore për autoritetet përgjegjëse si struktura kryesore për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave brenda institucionit.

- Intensifikimit të bashkëpunimit me institucionet kryesore që kanë fushë të përgjegjësive luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe parandalimin e pastrimit të parave.

- Ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët e shoqërinë civile, si dhe forcimin e bashkëpunimit me median investigative në veçanti, duke trajtuar me përparësi, korrektësi dhe brenda afateve ligjore kërkesat e publikut në lidhje me publikimin e deklaratave të interesave privatë.

Kuvendi kërkon që Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, për vitin 2019, të vazhdojë punën në këto drejtime:

- Të vazhdojë procesin e dorëzimit të dosjeve dhe raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për pjesën e mbetur të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe përkatësisht të gjykatave dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, si dhe gjykatave administrative të shkallëve të para.

- Të vijojë angazhimin, së bashku me partnerët ndërkombëtarë, për të garantuar përfundimin e të gjitha fazave të nevojshme për ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit

elektronik të deklarimit të interesave privatë brenda vitit 2021 dhe garantimin e qëndrueshmërisë së mëtejshme të funksionimit të vetë sistemit.

- Të vijojë forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve investiguese me fokus të veçantë trajtimin e rasteve të fshehjes apo mosdeklarimit të pasurive, të konfliktit të interesit, si dhe hetimit të rasteve të sinjalizimit.

- Të vijojë aktivitetet informuese e sensibilizuese në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim ndërgjegjësimin e të gjitha palëve në proces, mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

- Të bëjë një vlerësim gjithëpërfshirës mbi ndërhyrjet e nevojshme në kuadrin ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, për zgjidhjen e problematikave të evidentuara deri më tani, si dhe të informojë Kuvendin për gjetjet e këtij vlerësimi.

- Të pasqyrojë në raportin vjetor të dhëna statistikore për kategoritë e zyrtarëve, për të cilët është kryer gjatë vitit kontrolli i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë e të interesave privatë dhe cilat janë rezultatet e këtyre kontrolleve.

Miraturar në datën 17.6.2019.

KRYETAR  
Gramoz Ruçi

## VENDIM Nr. 412, datë 19.6.2019

### PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave



## VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**

PLANI KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E  
CILËSISË SË AJRIT

**Hyrje**

Plani kombëtar i menaxhimit të cilësisë së ajrit është mjeti planifikues, me anë të të cilit Qeveria shqiptare synon zbatimin e direktivës 2008/50/EC<sup>1</sup> mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në ambient, si dhe direktivave bijë

<sup>1</sup> Zakonisht referuar si Direktivë Kuadër e Cilësisë së Ajrit, ai përshkruan parimet bazë se si cilësia e ajrit duhet të vlerësohet dhe menaxhohet në Shtetet Anëtare. Ai rendit ndotësit, për të cilët do të zhvillohen standardet dhe objektivat e cilësisë së ajrit dhe të përcaktohen në legjislacion, dhe kjo kërkon që Shtetet Anëtare të vënë në vend planet dhe programet, në rastet kur përqendrimet e cilësisë së ajrit për ndotësit e rregulluar tejkalojnë vlerat kufi të përcaktuara në Direktivat bija:

Direktiva 1999/30 /EC në lidhje me vlerat kufi të dyoksidit të squfurit, dyoksidit të azotit dhe oksideve të azotit, grimcat dhe plumbit në ajrin e mjedisit.

Direktiva 2000/69/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit Europian në lidhje me vlerat kufi për benzenin dhe monoksidin e karbonit në ajrin e ambientit.

Direktiva 2002/3 / EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit Europian në lidhje me ozonin në ajrin e mjedisit.

Direktiva 2004/107 / EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit Europian në lidhje me arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarbureve aromatike policiklike në ajrin e mjedisit.

përkatëse. Në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 162/2014 “Mbi mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”, ky plan ndjek dy objektiva:

1. përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonat ku janë tejkaluuar limitet e vendosura me ligj, si dhe në zonat ku ekziston një risk i lartë i tejkalimit të këtyre limiteve;

2. ruajtjen e nivelit të cilësisë së ajrit në pjesën e ngjitur të territorit.

Këto objektiva do të arrihen duke implementuar masa, për të mos lejuar dhe për të reduktuar shkarkimet nga trafiku, burimet industriale apo burimet difuze, me qëllim për t’iu përmbajtur limiteve të përcaktuara nga ligji. Pritet që masat do të ruajnë ose do të përmirësojnë më shumë cilësinë e ajrit në ato zona të vendit ku nuk janë detektuar vlera kritike të cilësisë së ajrit.

Plani përbëhet nga 7 kapituj si vijon:

1. Një përmbledhje e strategjive dhe planeve, karakteristikat e përgjithshme të territorit dhe kuadri rregullator.

2. Një pasqyrë e ndotjes atmosferike, përfshirë kuadrin e shkarkimeve dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit.

3. Karakterizimi i zonave, duke përfshirë përkufizimin e zonave të planit.

4. Plani i veprimeve, duke përfshirë masat e zgjedhura dhe koha për zbatim.

5. Vlerësimi i kostos dhe shpenzimeve të zbatimit të planit.

6. Strategjitë për pjesëmarrjen e publikut.

7. Plani i Monitorimit dhe Verifikimit, nëse plani është zbatuar në përputhje me objektivat e vendosura dhe nëse ai ndjek evolucionin e kontekstit në të cilin vepron.

**Fjalor dhe shkurtime**

CAM/AAQ	Cilësia e Ajrit të Mjedisit
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
NJQV	Njësia e Qeverisjes Vendore
LRTAP	Ndotja e Ajrit në Distancë të Largët Ndërkuftare
MM	Ministria përgjegjëse për Mjedisin
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
NO <sub>x</sub>	Oksidet e azotit (NO <sub>x</sub> ) - oksid i azotit (NO) dhe dyoksidi i azotit (NO <sub>2</sub> ). NO është formuar kryesisht, në proceset e djegies në temperaturë të lartë, dhe më pas mund të konvertohet në NO <sub>2</sub> në atmosferë.
O <sub>3</sub>	Ozoni i nivelit të tokës (O <sub>3</sub> ). Ozoni i formuar në pjesën e ulët të atmosferës nga reagimi i oksideve të azotit dhe komponimeve organike të paqëndrueshme, në prani të diellit. Ozoni është një gaz i fuqishëm oksidues.
Pb	Plumb (emri latin: Plumbum)
PM <sub>10</sub> , PM <sub>2.5</sub>	Grimca të ngurta në ajrin e mjedisit me një diametër më pak se 10 apo 2.5 mikrometër respektivisht.
SO <sub>2</sub>	Dyoksidi i squfurit – gaz që formohet nga djegia e lëndëve djegëse që përmbajnë squfur.
PQT/STP	Plani i Qëndrueshëm i Transportit
SKT	Strategjia Kombëtare e Transportit
PKT	Plani Kombëtar i Transportit
PPKT	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit

**Tabela e përmbajtjes**

HYRJE

FJALOR DHE SHKURTIME

1. TË PËRGJITHSHME 1

1.1 Situata e pritshme

1.1.1 Objektivat

1.1.2 Kuadri njohës

1.1.3 Skenarët dhe masat e Planit

1.2 Karakteristika të përgjithshme të vendit

1.2.1 Sipërfaqja dhe popullsia

1.2.1 Ekonomia

1.2.1 Transporti

1.2.2 Topografia dhe moti

1.3 Kuadri ligjor

1.3.1 Plani i përafrimit

1.4 Informimi dhe komunikimi i planit

2. KARAKTERISTIKAT E AJRIT TË NDOTUR

2.1 Cilat janë burimet e ndotjes në Shqipëri?

2.1.1 Burimet pikësore

2.1.2 Burimet difuze

2.2 Shkarkimet totale kombëtare dhe trendi i tyre

2.3 Vlerësimi i cilësisë së ajrit

2.3.1 Struktura dhe rrjeti i monitorimit

2.3.2 Analiza statistikore e të dhënave të cilësisë së ajrit

2.3.3 Vërejtjet përfundimtare për cilësinë e ajrit në bashkitë kryesore të Shqipërisë

3. KARAKTERIZIMI I ZONAVE

3.1 Modeli konceptual





3.1.1 Klasifikimi i njësive bashkiake	
3.2 Përkufizimi i zonave të planit	
3.2.1 Zonë A: Aglomeratet e Tiranës dhe Elbasanit	
3.2.2 Zonë B: Njësitë bashkiake të Fierit, Durrësit, Vlorës, Shkodrës, Korçës, Patosit dhe Ballshit	
3.2.3 Zonë C: Territori i mbetur i vendit	
4. PLANI I MASAVE	
4.1 Reduktimi i burimeve difuze	
4.1.1 Reduktimi nga shkarkimet e trafikut	
4.1.2 Përmirësimi i kontrollit të cilësisë së lëndës djegëse	
4.1. Reduktimi i shkarkimeve nga zhvillimi urban dhe ndërtimi	
4.1.4 Reduktimi i shkarkimeve nga bujqësia	
4.1.5 Reduktimi i shkarkimeve nga djegia e druve të zjarrit	
4.1.5 Reduktimi i shkarkimeve nga burimet difuze industriale	
4.2 Reduktimi i shkarkimeve nga burimet pikësore	
4.3 Forcimi i inspektimit dhe kapaciteteve monitoruese	
4.4 Përmirësimi i ndërgjegjes së publikut	
4.5 Vlerësimi i masave të propozuara për cilësinë e ajrit	
5. KOSTOT DHE PËRFITIMET E ZBATIMIT TË PLANIT	904
5.1 Kostot dhe Burimet Financiare	
5.2 Strategjia e Financimit	
5.3 Përfitimet	
6. STRATEGJIA PËR PJESËMARRJEN E PUBLIKUT	
7. MONITORIMI DHE VERIFIKIMI I PLANIT	
7.1 Monitorimi i Planit	
7.2 Verifikimi i Planit	
7.3 Rishikimi i Planit	
ANEKSI A: TË DHËNAT E MONITORIMIT 2002-2015	
ANEKSI B: BUXHETI SIPAS VEPRIMEVE DHE MASAVE	

### Përmbajtja e tabelave

Tabela 1: Lidhja midis sektorëve të ekonomisë, shkarkimeve dhe ndotjes së ajrit

Tabela 2: Burimet kryesore të ndotjes në Shqipëri

Tabela 3: Përshkrimi i masave të identifikuara

Tabela 4: Lista e bashkive, njësive bashkiake, popullsia, sipërfaqja dhe dendësia e qarqeve të shqipërisë

Tabela 5: Masat për përafrim të plotë

Tabela 6: Shkarkimet e NO<sub>x</sub> sipas kategorisë më 1990-n dhe 2015-n, trendi dhe përqindja e tyre ndaj emetimeve totale

Tabela 7: Shkarkimet e SO<sub>2</sub>-it sipas kategorisë më 1990-n dhe 2015-n, trendi dhe përqindja e tyre ndaj emetimeve totale

Tabela 8: Shkarkimet e PM<sub>10</sub>-s sipas kategorisë më 1990-n dhe 2015-n, trendi dhe përqindja e tyre ndaj emetimeve totale

Tabela 9: Përqendrimit e benzenit (µg /m<sup>3</sup>) gjatë viteve 2010–2015, në bashkitë kryesore të vendit

Tabela 10: Masat për reduktimin e shkarkimeve nga trafiku

Tabela 11: Masat për reduktimin e shkarkimeve nga zhvillimi urban dhe ndërtimi

Tabela 12: Masat për reduktimin e shkarkimeve nga bujqësia

Tabela 13: Masat për reduktimin e shkarkimeve nga burimet difuze industriale

Tabela 14: Masat për reduktimin e shkarkimeve nga burimet pikësore

Tabela 15: Masat për forcimin e inspektimit dhe kapaciteteve monitoruese



Tabela 16: Masat për përmirësimin e ndërgjegjësimit të publikut

Tabela 17: Prioriteti dhe vlerësimi i masave të propozuara

Tabela 18: Kostot totale për zbatimin e planit të cilësisë së ajrit të mjedisit

Tabela 19: Shpenzimet në lidhje me përmirësimin e cilësisë së ajrit

Përmbajtja e figurave

Figura 1: Shkarkimet totale (Gg/vit) të SO<sub>x</sub>, NO<sub>x</sub>, NMVOCs, NH<sub>3</sub> dhe PM<sub>10</sub> 1990–2015

Figura 2: Shkarkimet totale kombëtare të NO<sub>x</sub> (Gg/vit) dhe trendi 1990–2015

Figura 3: Shkarkimet kombëtare totale dhe trendi i SO<sub>2</sub>, gjatë 1990–2015

Figura 4: Shkarkimet totale kombëtare të PM<sub>10</sub> (Gg/vit) dhe trendet 1990–2015

Figura 5: Përqendrimit mesatare vjetore të NO<sub>2</sub> (vitet 2011–2015) (µg /m<sup>3</sup>)

Figura 6: Përqendrimit mesatare vjetore (vitet 2011–2015) të PM<sub>10</sub> (µg /m<sup>3</sup>)

Figura 7: Përqendrimit mesatare vjetore të benzenit (vitet 2011–2015) (µg /m<sup>3</sup>)

Figura 8: Përqendrimit mesatare vjetore të ozonit (vitet 2011–2015) (µg /m<sup>3</sup>)

Figura 9: Përqendrimit mesatare vjetore (vitet 2011–2015), të dyoksidit të squfurit

Figura 10: Tirana - Vlerat mesatare vjetore dhe trendi i NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub> PM<sub>10</sub> dhe O<sub>3</sub>

Figura 11: Shkodra - Vlerat mesatare vjetore dhe trendi i NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub> PM<sub>10</sub> dhe O<sub>3</sub>

Figura 12: Durrës - Vlerat mesatare vjetore dhe trendi i NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub> PM<sub>10</sub> dhe O<sub>3</sub>

Figura 13: Elbasan - Vlerat mesatare vjetore dhe trendi i NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub> PM<sub>10</sub> dhe O<sub>3</sub>

Figura 14: Fier - Vlerat mesatare vjetore dhe trendi i NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub> PM<sub>10</sub> dhe O<sub>3</sub>

Figura 15: Vlorë - Vlerat mesatare vjetore dhe trendi i NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub> PM<sub>10</sub> dhe O<sub>3</sub>

Figura 16: Korçë - Vlerat mesatare vjetore dhe trendi i NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub> PM<sub>10</sub> dhe O<sub>3</sub>

#### **Përmbajtja e hartave**

Harta 1: Densiteti i popullsisë në njësitë bashkiake të Shqipërisë

Harta 2: Vlerësimi i shkarkimeve difuze të NO<sub>x</sub> (ton/vit) për vitin 2015

Harta 3: Vlerësimi i shkarkimeve difuze të SO<sub>x</sub> (ton/vit) më 2015

Harta 4: Vlerësimi i shkarkimeve difuze të PM<sub>10</sub> (ton/vit) më 2015

Harta 5: Klasifikimi i territorit në lidhje me ndotjen e ajrit.

Harta 6: Klasifikimi i territorit - zonat e planifikimit



## 1. TË PËRGJITHSHME

Gjendja e cilësisë së ajrit është një ndër çështjet mjedisore më kritike, që ka të bëjë me administratorët lokalë dhe autoritetet qendrore, si dhe prek jetën e përditshme të çdo qytetari. Nëse koncepti i mirëqenies ka qenë më parë i lidhur ngushtë më të mirat materiale dhe zhvillimin ekonomik, sot është më i lidhur me aspekte të tjera, si shëndeti, mjedisi, marrëdhëniet shoqërore, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me perceptimin subjektiv të çdo individi. Kushtet e jetesës së njeriut janë të varura nga ekosistemi në të cilin ai jeton, kështu që është e nevojshme që të mbrojmë dhe të ruajmë mjedisin, në mënyrë që të sigurojmë një kualitet jete të qëndrueshëm, për gjeneratat e së tashmes dhe së ardhmes.

Vitet e fundit, konteksti ligjor i Bashkimit Evropian (BE) dhe legjislacioni kombëtar kanë ndihmuar në përcaktimin e një kuadri referencë, për përcaktimin e veprimeve që duhet të ndërmerren për përmirësimin e cilësisë së ajrit, bazuar në politikat e zbatimit dhe parandalimit (reduktimi i shkarkimeve në atmosferë), si dhe në identifikimin e kriterëve inovative, për kontrollin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në nivel lokal.

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit (PKMCA) është i drejtuar kryesisht, në mbrojtjen e asetit të vlefshëm të cilësisë së mirë të ajrit në Shqipëri (dhe në Evropë) dhe sidomos, për të siguruar që cilësia e dobët ose e keqe e ajrit, nuk ndikon negativisht në pjesën më të prekshme të popullsisë; dobësia e të cilëve vjen për shkak të profesionit, moshës, kushteve ekzistuese shëndetësore ose faktorëve të tjerë. Ky Plan duhet të paraqitet në një format, që do të lejojë, që raporti të lexohet dhe të kuptohet nga të gjitha shtresat e shoqërisë, duke përfshirë qytetarët, përfaqësuesit e zgjedhur, autoritetet kompetente, agjencitë shtetërore dhe institucionet, ambientalistët dhe unionin mjekësor.

Ky plan (PKMCA) lidhet me shtatë ndotësit kryesorë ose grupet ndotëse, si më poshtë:

1. Dyoksidi i squfurit (SO<sub>2</sub>);
2. Dyoksidi i azotit (NO<sub>2</sub>) dhe oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>);
3. Lënda e ngurtë pezull (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>);
4. Benzeni (C<sub>6</sub>H<sub>6</sub>);
5. Monoksidi i karbonit (CO);
6. Plumbi (Pb);

## 7. Ozoni.

Në përputhje me nenin 7, të ligjit nr. 162/2014, datë 4.12.2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, plani i cilësisë së ajrit përgatitet dhe zbatohet, kur nivelet e dyoksidit të squfurit, dyoksidit të azotit, benzenit, monoksidit të karbonit, plumbit, lëndës së ngurtë pezull ose ozonit në ajrin e mjedisit, kalojnë vlerat kufi apo vlerat e synuara respektive, të përcaktuara sipas nenit 5 të këtij ligji. Gjatë hartimit të planit merret parasysh kufiri përkatës i tolerancës, pavarësisht nëse ka kapërcyer ose jo data e arritjes së vlerës kufi apo vlerës së synuar respektive. Planet e cilësisë së ajrit për kapërcimet e PM<sub>10</sub>, përgatiten vetëm për ato zona dhe aglomerate, ku kapërcimet shkaktohen nga burime të ndryshme nga ato natyrore, apo nga hedhja e rërës dhe kripës në rrugë gjatë dimrit. Plani i cilësisë së ajrit, përfshin gjithashtu, monitorimin e treguesve të ndotjes së ajrit në hotspotet e identifikuar.

Kuadri i politikave të BE-së është i orientuar në thelb në dy nivele kryesore: në njërin anë qëndron identifikimi i limiteve të përqendrimit për ndotës të ndryshëm për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe ekosistemet, dhe në anën tjetër zhvillimi i një plani të koordinuar kontrolli dhe menaxhimi të ajrit, që mundëson një pamje më eficiente të problemeve dhe strategjive të ndërhyrjes që duhet adoptuar. Seti i rregullave të direktivave të BE-së mbi cilësinë e ajrit, i përafëruar në legjislacionin kombëtar nëpërmjet ligjit nr. 162/2014 “Mbi mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, si dhe akteve të tij zbatuese, e shqyrtojnë problemin e ndotjes së ajrit, si një fenomen dinamik, i cili është i nevojshëm të njihet dhe të zotërohet.

Në këtë kontekst dhe, në përputhje me këto rrethana, ky plan vjen si një instrument për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe proceseve të lidhura me njëra-tjetrën, duke lejuar respektimin e objektivit të përgjithshëm të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve dhe ekuilibrit të ekosistemeve.

Për të arritur objektivat e Planit, masat zbatuese janë identifikuar në detaje, duke përfshirë përgjegjësit për zbatimin e tyre, zonat territoriale të aplikimit, si dhe kohën e aplikimit dhe burimet e nevojshme.

## KUADRI LIGJOR



Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT) “Shqipëria 2030”, ka një rol të rëndësishëm në zbatimin e kuadrit ligjor sektorial në fushën e planifikimit dhe të administrimit të territorit. Ky Plan rrjedh si detyrim i ligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe rregulloreve në zbatim të tij si dhe është kusht për hartimin dhe zbatimin e planeve të hierarkive më të ulëta. PPKT ofron kornizën strategjike referuese për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, për 15 vitet e ardhshme, me qëllim sigurimin e zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social të vendit, menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore të tij, mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar njëkohësisht edhe përdorimin racional të tokës.

Referuar kuadrit ligjor për detyrimin e hartimit të VSM-së së Planit, dokumenti i PPKT-së shoqërohet me studimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, i cili do të sigurojë

shmangien dhe minimizimin e ndikimeve negative në territor.

Objektivi mjedisor 3 i VSM-së është:

- Ajri (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimal të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë.

Ndikimet Potenciale:

- emetimi i ndotësve në ajër, të cilët kanë ndikime të dëmshme tek ekosistemet dhe biodiversiteti

- emetimi i ndotësve për të cilët janë përcaktuar kufijtë e sipërm në nivel kombëtar

- ndikimi në shëndet (sistemi respirator) në rastet e një pranie të lartë të ndotësve në ajër

Kriteret e Vlerësimit dhe metodologjia për OM 3:

Indikator / Kriteri i Vlerësimit	Shkalla e Vlerësimit
<p>- sasia vjetore e emetimeve të ndotësve në ajër, dmth e oksideve të squfurit, oksideve të azotit, lëndes organike volatile pa permbajtje metani, amoniakut dhe pjesezave</p> <p><i>(përmirësime të matshme të cilësive së ajrit duke arritur nivelet e synuara të ndotësve e ajrit në lidhje me shenjetin e njerezve, sipas vlerave respektive: për NOx - 40 µ/m³, për PM<sub>10</sub> - 40 µ/m³, për PM<sub>2.5</sub> - 25 g/m³ dhe 20 g/m³ dhe SO<sub>2</sub> - 125 µ/m³.</i></p>	<p><b>A – s’ka ndikim/ndikim pozitiv:</b> Aktivitetet e parashikuara nuk do të shkaktojnë emetime të ndotësve në ajër (përfshirë edhe pjesezat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar. Zbatimi i aktiviteteve do të reduktojë emetimet e ndotësve.</p>
<p>- numri vjetor i diteve kur tejkalohet niveli i ndotjes së ajrit me pjeseza, i matur në pikat e monitorimit, të cilat janë të ekspozuara ndaj emetimeve të ndotësve</p> <p><i>(duhet të reduktohet me 40% numri i diteve kur tejkalohet niveli i ndotjes së ajrit me pjeseza; sa më pak dite me ndotje të lartë të ajrit, aq më i ulët është ndikimi tek shëndeti i njerezve dhe kostoja për shoqërinë, për shkak të numrit relativisht të lartë të njerezve të ekspozuar, shëndeti i të cileve preket nga ky faktor)</i></p>	<p><b>B – ndikim i parendesishëm:</b> Zbatimi i aktiviteteve do të shkaktojë emetime të ndotësve në ajër (përfshirë edhe pjesezat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar, por jo deri në atë masë sa të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II.</p> <p><b>C – ndikimi behet i parendesishëm për shkak të zbatimit të masave zbutese:</b> Zbatimi i aktiviteteve do të shkaktojë emetime të ndotësve në ajër (përfshirë edhe pjesezat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar deri në atë masë sa do të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. për të reduktuar emetimet duhet të parashikohen dhe zbatohen masa zbutese në mënyrë që niveli maksimal i emetimeve të zbrese në kufijtë e parashikuar në SKZHI-II.</p> <p><b>D – ndikim i rëndesishëm:</b> Zbatimi i aktiviteteve do të shkaktojë emetime të ndotësve në ajër (përfshirë edhe pjesezat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar deri në atë masë sa do të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. Nuk mund të merren masa zbutese për të reduktuar nivelin e emetimeve nën kufijtë e përcaktuar dhe për të mbajtur ndikimin në nivelin e përcaktuar të ndotjes së ajrit me pjeseza.</p> <p><b>E – ndikim shkatërrues:</b> Zbatimi i aktiviteteve do të shkaktojë emetime të ndotësve në ajër (përfshirë edhe pjesezat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar deri në atë masë sa kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II do të tejkalohen në mënyrë të konsiderueshme dhe ndotja e ajrit me pjeseza do të jetë në nivel të tillë që do të ketë një efekt të konsiderueshëm dhe të dëmshëm mbi shëndetin e njerezve.</p> <p><b>X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur:</b> Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave</p>

Në vijim janë evidentuar impaktet mjedisore në cilësinë e ajrit për projektet strategjike në PPKT:



### **PN1: Rrjeti kombëtar i biçikletave**

#### *Përshkrimi*

Krijimi i këtij rrjeti është e sigurt që do të ketë impakte pozitive dhe në një shkallë të lartë në kuadër të Përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe uljes së nivelit të zhurmave. Këto impakte janë të përhershme dhe sinergjike me aktivitetet e tjera që parashikohen në këtë fushë.

#### *Komente*

Ndërkohë që Plani zhvillon konceptin mbi rrjetin kombëtar, të përshpejtohen zhvillimet e ngjashme dhe zbatimi brenda rrjetit lokal urban si paraprirje e realizimit të rrjetit kombëtar.

### **PN2, PN3 dhe PN4: Shpallja e parqeve të reja (lumi Buna, Alpet, lumi Vjosa)**

#### *Përshkrimi*

Shpallja e këtyre parqeve është e sigurt që do të ketë impakte pozitive dhe në një shkallë të lartë në kuadër të Përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe uljes së nivelit të zhurmave. Këto impakte janë të përhershme dhe sinergjike me aktivitetet e tjera që parashikohen në këtë fushë.

#### *Komente*

Kujdes të tregohet në konceptimin e Planeve të parqeve për mobilitetin e vizitorëve në respekt me natyrën. Promovimi duhet të jetë për ngritjen e infrastrukturave të lehta që mbështesin aktivitetet pa makina, në drejtim të sporteve dhe aktiviteteve në natyrë.

### **PI1: Funkcionimi i 2 aeroporteve të reja (në veri – Kukës dhe ndërtimi i atij në jug)**

#### *Përshkrimi*

Impaktet janë negative dhe me një shkallë të lartë. Impaktet që lidhen me uljen e cilësisë së ajrit dhe ndotjen akustike në rastin e ndërtimit dhe funksionimit të aeroporteve, janë të përhershme dhe të pakthyeshme. Këto janë impakte direkte dhe i shtohen impakteve të projekteve të tjera në këtë fushë. Për shkak se aeroportet do të ndërtohen në zona kufitare me vendet fqinje, impakti pritet që të jetë edhe ndërkufitar.

#### *Komente*

Konsiderohet që Aeroporti i Jugut do të zhvillohet në territorin ekzistues të njërës nga fushat e aviacionit dhe duke qenë pranë zonave të mbrojtura dhe biokorridoreve do të kërkojnë investime shtesë për të minimizuar impaktet e drejtpërdrejta afatgjatë. Elementi ndërkufitar i impaktit shkon për të dy aeroportet e

parashikuara dhe kërkon të trajtohet qysh herët në zhvillimin e masave.

### **PI2 dhe PI3: Ndërtimi i stacioneve intermodale kombëtare (Fier, Elbasan dhe Berat) dhe ndërkombëtare (Tiranë, Durrës, Lezhë, Shkodër, Kukës, Pogradec, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë)**

#### *Përshkrimi*

Probabiliteti që projektet në fjalë të shkaktojnë impakte mbi cilësinë e ajrit dhe zhurmat, është i ulët, ndërkohë që edhe vetë impaktet janë në një shkallë të ulët, afatshkurtra dhe të kthyeshme. Infrastruktura ndikon direkt në uljen e cilësisë së ajrit dhe rritjen e nivelit të zhurmave, prandaj impaktet janë primare dhe njëkohësisht kumulative.

#### *Komente*

Impaktet negative duhet të kompensohen me masa zbutëse efektive që janë pjesë e projektimit dhe planit afatgjatë e të operimit. Në asnjë rast stacionet nuk duhet të projektohen brenda, por as në afërsi të territorit të zonave të mbrojtura. Në tërësi, gjithë stacionet duhet të projektohen në harmoni me standardet e cilësisë së ajrit dhe zhurmave, ku elementet e cilësisë së mjedisit të jenë parësor duke aplikuar “best practices”.

### **PI4: Ndërtimi i 5 korridoreve strategjike (I Gjelbër, Blu Veri -Jug, Tetë - Rruga e Arbrit, Dhjetë - Segmeti Durrës – Kukës – Morinë dhe Boshti Qendror Jugor)**

#### *Përshkrimi*

Probabiliteti që projektet në fjalë të shkaktojnë impakte mbi cilësinë e ajrit dhe zhurmat, është i lartë, megjithatë këto impakte janë në një shkallë të ulët. Sidoqoftë impaktet janë afatgjata, deri dhe të përhershme dhe të pakthyeshme. Infrastruktura ndikon direkt në uljen e cilësisë së ajrit dhe rritjen e nivelit të zhurmave, prandaj impaktet janë primare dhe njëkohësisht kumulative.

#### *Komente*

Impaktet më të drejtpërdrejta që krijojnë 5 korridoret rrugore kanë të bëjnë mjaft me impaktet në cilësinë e ajrit dhe zhurmat. Në tërësi, 5 korridoret rrugore duhet të projektohen në harmoni me habitatet natyrore ( përfshirë cilësinë e ajrit dhe zhurmat), ku elementet e mbrojtjes së mjedisit të jenë parësore duke aplikuar “best practices”.

### **PI5: Ndërtimi i 4,500 km rrjet hekurudhor**

#### *Përshkrimi*

Probabiliteti që projektet në fjalë të shkaktojnë



impakte mbi cilësinë e ajrit dhe zhurmat, është i lartë, megjithatë këto impakte janë në një shkallë të ulët. Sidoqoftë impaktet janë aftagjata, deri dhe të përhershme dhe të pakthyeshme. Infrastruktura ndikon direkt në uljen e cilësisë së ajrit dhe rritjen e nivelit të zhurmave, prandaj impaktet janë primare dhe njëkohësisht kumulative.

#### *Komente*

Duke ju referuar Strategjisë së Transportit “2016 -2020” kjo masë duket jorealiste për t’u realizuar brenda afatit të planit, por për këtë duhet të ndiqet korigjimi në bazë të konkluzioneve që do të nxjerrë Strategjia e Transportit për sektorin e hekurudhës. Megjithatë edhe për referencat e zbatimit të infrastrukturës hekurudhore, nëse do të rehabilitohen/ndërtohen, elementet e mbrojtjes së mjedisit të jenë parësore duke aplikuar “*best practices*”.

### **PI6: Zhvillimi i 4 porteve kryesore (Shëngjin, Durrës, Vlorë, Sarandë)**

#### *Përshkrimi*

Probabiliteti që projektet në fjalë të shkaktojnë impakte mbi cilësinë e ajrit dhe zhurmat, është i lartë, megjithatë këto impakte janë në një shkallë të ulët. Sidoqoftë impaktet janë aftagjata, deri dhe të përhershme dhe të pakthyeshme. Infrastruktura ndikon direkt në uljen e cilësisë së ajrit dhe rritjen e nivelit të zhurmave, prandaj impaktet janë primare dhe njëkohësisht kumulative.

#### *Komente*

Impaktet priten të jenë më shumë gjatë fazës së ndërtimit. Masat zbutëse që do të zbatohen për infrastrukturën portuale, gjatë rehabilitimit / ndërtimit duhet të parashikojnë edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar “*best practices*”.

#### **Rekomandime**

Impakte negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe impaktet në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqendrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

Në vijim raporti VSM thekson edhe rekomandimet e mëposhtme të përgjithshme:

Rritja e transparencës për investimet e reja, kontrollin e shkarkimeve në ujë apo ajër, administrimin e zonave të mbrojtura, menaxhimin e mbetjeve etj. ndihmon në rritjen e bashkëpunimit

me publikun dhe zbatimin e politikave të parashikuara nga Plani.

Ka nevojë për integrim të mëtejshëm mjedisor të planeve sektoriale dhe atyre vendore në Plan, me qëllim zbatimin e masave zbutëse dhe zbatimin e procedurave të parashikuara nga VSM-ja dhe VNM-të specifike.

Masat zbutëse që do të zbatohen për zhvillimin e infrastrukturës, gjatë rehabilitimit/ndërtimit duhet të parashikojnë edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar “*best practices*”.

Ndërkohë që Plani zhvillon konceptin mbi rrjetin kombëtar të rrugëve automobilistike dhe biçikletave, të përshpejtohen zhvillimet e ngjashme dhe zbatimi brenda rrjetit lokal urban duke aplikuar “*best practices*” ndaj përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe uljes së efekteve negative/ndotëse nga zhurma.

### **1.1 Situata e pritshme**

#### **1.1.1 Objektivat**

Plani Kombëtar për Menaxhimin e cilësisë së ajrit është një mjet planifikimi, nëpërmjet të cilit Qeveria shqiptare do të vendosë në zbatim, ligjin nr. 162/2014 “Mbi mbrojtjen e cilësisë së ajrit të ambientit”. Në përputhje me kërkesat e legjislacionit, ky plan ndjek dy objektiva:

- përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonat që kanë kaluar limitet e vendosura me ligj, ose zonave ku ekziston një rrezik i lartë i tejkalimit të limiteve;

- ruajtjen e nivelit të cilësisë së ajrit në territorin e mbetur.

Plani ka si qëllim reduktimin e shkarkimeve nga trafiku, nga burimet industriale dhe burimet e shpërndara, me qëllim arritjen e përputhshmërisë me vlerat kufi të përcaktuara në ligj, por gjithashtu mbajtjen ose, më mirë, përmirësimin e cilësisë së ajrit, në zonat e vendit ku arrihen standardet e cilësisë së ajrit.

Organet e qeverisjes qendrore, së bashku me Ministrinë përgjegjëse për mjedisin, Inspektoratin përgjegjës për mjedisin dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), sipas aftësive dhe kompetencave të tyre, duhet të aktivizojnë dhe të forcojnë kontrollet mbi shkarkimet nga instalimet industriale, duke vendosur theks të veçantë në monitorimin e instalimeve të Klasës A dhe Klasës B; të përmirësojnë në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e cilësisë së ajrit; të



rrisin ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me cilësinë e ajrit, dhe të forcojnë zbatimin e inspektimit dhe programit të kontrollit të shkarkimeve për automjetet motorike.

Njësitë e qeverisjes lokale (NQL) së bashku me bashkitë duhet që, sipas aftësive dhe kompetencave të tyre, të adoptojnë dhe zbatojnë planet lokale të menaxhimit të cilësisë së ajrit; të përmirësojnë transportin publik, të rrisin vendet e parkimit dhe zonat e gjelbra, si dhe të krijojnë zona me trafik të kufizuar.

Qeveria shqiptare ka gjithashtu për detyrë: inkurajimin e përdorimit të burimeve të energjisë së ripërtëritshme ose të rinovueshme, për të kënaqur nevojat energjetike për ngrohje, ftohje, ndriçim dhe prodhim të ujit të ngrohtë për ndërtesat; të promovojë nisma për përdorimin e bashkëprodhimit dhe ngrohjes qendrore, në mënyrë të veçantë në shëndetin publik dhe në zonat e zhvillimit të banesave të reja etj. Qeveria shqiptare është gjithashtu e angazhuar të promovojë hulumtimin dhe zhvillimin teknologjik që ka për qëllim: realizimin e sistemeve jokonvencionale/origjinale të transportit dhe prodhimit të energjisë; dhe të krijojë një program që ka për qëllim heqjen e automjeteve që ndotin më shumë dhe rritjen e përdorimit të automjeteve me emetim të ulët.

Një vëmendje kryesore duhet t'i jepet informimit dhe sensibilizimit të popullatës. Suksesi i masave të Planit do të jetë më i madh, nëse popullata do të përfshihet dhe bëhet pjesë e problemeve të ndotjes së ajrit, dhe do të jetë në dijeni të nevojës për zbatimin e ndryshimeve të rutinës dhe sjelljeve, që kanë të bëjnë me lëvizshmërinë, konsumimin e energjisë dhe përputhshmërisë me disponibilitetin e burimeve. Plani pret që autoritet qendrore dhe lokale, brenda kompetencave përkatëse, të promovojnë fushata informuese, informacion dhe edukim mjedisor, mbi natyrën, burimet, shpërndarjen e ndotësve dhe gjendjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe efektet në shëndetin e njeriut.

### 1.1.2 Kuadri njohës

Informacioni për qëllime të vlerësimit të cilësisë së ajrit, është mbledhur duke iu referuar të dhënave të fundit të disponueshme nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, që identifikon sipas radhës sektorët me kontributin kryesor në ndotjen e ajrit në Shqipëri: transportin, industrinë, bujqësinë,

zhvillimin urban dhe menaxhimin e mbetjeve. Të gjithë këta sektorë emetojnë një shumëllojshmëri të ndotësve të ajrit, si dyoksidi i squfurit, oksidet e azotit, amoniaku, substancat organike të avullueshme, si dhe grimcat e ngurta.

Dokumenti i Planit Kombëtar të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, është një dokument strategjik që ka përmbledhur dhe marrë në konsideratë një seri dokumentesh politike dhe strategjike të të gjithë institucioneve që janë kontribues apo investues në fushën e përmirësimit të cilësisë së ajrit. Të tilla si:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014–2020, pjesa e cilësisë së ajrit;
- Strategjia Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit, miratuar me VKM nr. 594, datë 10.9.2015;
- Plani Kombëtar i Veprimit të Eficiencës së Energjisë, miratuar me VKM nr. 709, datë 1.12.2017 “Mbi miratimin e Planit të Dytë dhe të Tretë Kombëtar të veprimit mbi Eficiencën e Energjisë për Shqipërinë, 2017–2020”;
- Plani i Qëndrueshëm i Transportit;
- Strategjitë kombëtare me karbon të ulët në sektorin e energjisë dhe të transportit.

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit nuk duhet të shikohet në mënyrë të izoluar, pasi ai është i lidhur ngushtë me politikat e klimës dhe të energjisë, të transportit dhe të politikave tregtare, si dhe të politikave bujqësore dhe të biodiversitetit. Një qasje e integruar merr parasysh bashkëpërfitimet e lidhjes me politikat e klimës dhe të ajrit, si edhe ndikimet e mundshme të veprimit nga një zonë në tjetrën.

Ky dokument është edhe një hap pozitiv në drejtim të kuadrit ligjor dhe të politikave për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Shqipëri. Duke qenë se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka rolin koordinues dhe raportues kundrejt përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë evropian, në kuadër të kapitullit 27 “Mjedisit”, është detyrim i MTMs që të kontribuoj në hartimin e atyre politikave dhe akteve ligjore të cilat bëjnë të mundur arritjen e detyrimeve të vendosura në indikatorët e performancës të dokumenteve strategjike të institucioneve kontribuese në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Të gjithë indikatorët apo objektivat e këtyre dokumenteve strategjike të cilat janë tashmë të miratuara, shërbejnë edhe si objektiva dhe indikatorë për këtë Plan Kombëtar veprimi.



Ndërsa shumë aktivitete kontribuojnë si në ndryshimet klimatike dhe në ndotjen e ajrit, masat për zvogëlimin e ndotësve të veçantë do të kontribuojnë për të dy problemet, sikurse janë karboni i zi ose ozoni troposferik, pra është një përfitim i dyfishtë. Karboni i zi është një grimcë e shkarkuar nga djegia jo e plotë e karburanteve, dhe burimet kryesore janë sobat me djegie të druve, motorët me naftë dhe djegia e biomasës. Ozoni troposferik dhe karboni i zi janë në të njëjtën kohë, ndotës të ajrit dhe gazeve me efekt serrë, kështu që përpjekjet me uljen e ngrohjes globale nga këta ndotës, premtan në mënyrë të konsiderueshme

përfitime në terma-afatgjatë të përmirësimit të shëndetit human.

Zbatimi i strategjive kombëtare me karbon të ulët në sektorin e energjisë dhe të transportit, ose nëpërmjet rritjes së eficiencës së energjisë, ose kalimi në teknologjitë e rinovueshme, do të reduktojë shkarkimet e ndotësve të ajrit, duke përfshirë edhe pararendësit e ozonit dhe karbonit të zi.

Marrëdhënia ndërmjet sektorëve të ekonomisë, shkarkimeve dhe efekteve negative në cilësinë e ajrit jepen në tabelën më poshtë:





Tabela 1: Lidhja midis sektorëve të ekonomisë, shkarkimeve dhe ndotjes së ajrit

Aktiviteti human	Ndikimi në cilësinë e ajrit të mjedisit
Transporti	<p>Sektori i transporteve është kontributori më i madh, për sa u përket shkarkimeve të përgjithshme në ajër, por kontributi ekzakt duhet të përcaktohet saktësisht. Shkarkimet e CO<sub>2</sub> nga transporti (% e djegies totale të karburantit) në Shqipëri janë matur në masën 59.95% më 2011 dhe në masën 58.2% më 2012. (Burimet: Banka Botërore dhe Indikatorët e Zhvillimit të Botës, 2015). Shkarkimet e CO<sub>2</sub> nga transporti përbajnë emetime nga djegia e karburanteve për të gjitha aktivitetet e transportit, pavarësisht sektorit, me përjashtim të bunkerëve ndërkombëtarë detarë dhe aviacionit ndërkombëtar. Kjo përfshin aviacionin e brendshëm, lundrimin e brendshëm, transportin rrugor, hekurudhor dhe korrespondon me IPCC Source / Sink Category 1 A 3.</p> <p>Përqendrime të larta të grimcave dhe të oksideve të azotit NO<sub>2</sub> janë regjistruar në stacionet monitoruese të vendosura afër rrugëve me trafik të dendur në Tiranë dhe ka një pranim universal që trajtimi i problemit të transportit është çelësi për përmirësimin e cilësisë së ajrit në qytet. Bllokimet nga trafiku për shkak të menaxhimit joeficient të tij, rrisin shkarkimin e këtyre ndotësve. Menaxhimi i trafikut mund të japë një kontribut të rëndësishëm për të ndihmuar në reduktimin e shkarkimeve të ndotësve nga automjetet, si për shembull: skema që ndalojnë ose përjashtojnë autovetura, automjete më pak të pastra nga rruga ose zona të veçanta, ose skema që zgjidhin probleme të parkimit, pasi kapaciteti i rrugëve mund të rritet në mënyrë të konsiderueshme, në qoftë se autoveturat dhe automjetet e parkuara në mënyrë ilegale dhe parkimi paralel i dyfishtë do të reduktohej, duke përforcuar zbatimin e legjislacionit mbi trafikun, si dhe duke rritur numrin e vendeve të disponueshme të parkimeve.</p>
Industria	<p>Zonat industriale kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndotjen e ajrit. Matjet e CAM-it kanë treguar probleme serioze për grimcat në Elbasan, të shkaktuara nga industria metalurgjike, fabrika e çimentos dhe nga depozita të hapura. Në zonën e Fierit, matjet indikative kanë regjistruar probleme serioze të shkaktuara nga industria prezente dhe e mëparshme e naftës. Në afërsi të industrive të mëdha mund të ekzistojnë probleme me CAM-in, por monitorimi i një burimi të vetëm nuk është një mjet eficient për strategjitë e pakësimit/zvogëlimit. Një monitorim i përshtatshëm i shkarkimeve, duhet t'i prezantohet kontrollit të shkarkimeve nga burime pikësore. Dampat dhe depozitat e krijuara nga aktivitetet të mëparshme industriale, mund të kontribuojnë gjithashtu, në shkarkimet dhe formimin e pezullive të grimcave. Depozitat në Elbasan konsiderohen si kontribues në ndotjen grimcore. Shumë “pellgje vajrash” në zonën e Fierit kontribuojnë në një emetim të konsiderueshëm të hidrokarburëve.</p>
Bujqësia	<p>Ndotja nga aktivitetet bujqësore ndikon negativisht në cilësinë e ajrit. Kimikatet dhe nënproduktet e agroindustrisë janë shumë të dëmshme ndaj mjedisit natyror dhe gjithashtu, mund të përbëjnë një problem edhe për njerëzit. Pesticidet e përdorura për të vrarë insektet që ushqehen me të korra, mund të shkaktojnë një dëm të madh në mjedis, nëse nuk përdoren në mënyrën e duhur. Metani i çliruar nga “proceset e keqtretjes së ushqimit”, si pasojë e keqshqyerjes së lopëve, është gjithashtu një lloj gazi serrë, duke e shndërruar kështu pjesërisht në një përgjegjës për ngrohjen globale. Shkarkimet nga përdorimi i karburanteve nga traktorët dhe pajisje të tjera të fermave të përdorura në bujqësi, gjithashtu kontribuojnë në ndotjen e ajrit. Zjarret, të cilët nuk janë të pazakonshme në ferma, mund të jenë shumë të dëmshëm për mjedisin, nëse plehrat dhe mbetjet që vijnë nga ky sektor, digjen në mënyrë të pakontrolluar. Një draftshënim i vendit (2009), i hartuar nga Banka Botërore, tregoi se agrikultura në Shqipëri është përgjegjëse për 77% të metanit në vend dhe 91% të shkarkimeve të oksidive të azotit. Njësoj si me emetime të tjera sektoriale, kërkohet informacion më i përditësuar dhe më i saktë në lidhje me kontribimet relative të gazeve me efekt serrë, substancave ozonholluese dhe ndryshimeve klimatike.</p>
Zhvillimi urban	<p>Tradicionalisht aktivitetet ndërtimore janë kontribuesit kryesor në përqendrimin e lartë të grimcave në ajër. Në zonat e ndërtimit, përveç aktivitetëve ndërtimore që natyrisht kanë kontributin e tyre, një kontribues i rëndësishëm mund të jetë edhe trafiku, rrugët dhe zonat e pasistemuara, si dhe më së shumti qëndrimi pezull i grimcave të ngurta. Meqë përqendrimi i këtyre grimcave është i lartë në të gjithë Shqipërinë, duhet të merret parasysh sa i madh është “kontributi natyror”.</p>
Menaxhimi i mbetjeve	<p>Ka disa landfille sanitare dhe asnjë impiant për incinerimin (djegjen) e mbetjeve shtëpiake në Shqipëri. Mbetjet ruhen në vendgrumbullime të mbetjeve, dhe sasia e tyre reduktohet nëpërmjet zjarreve të pakontrolluara që shkaktojnë probleme në afërsi të depozitave. Djegia e pakontrolluar e mbetjeve shtëpiake përbën një burim të rëndësishëm të emetimit të dyoksinës. Ky problem vazhdon të bëhet më i madh, sepse shtresa më e varfër e popullsisë beson se djegia e këtyre mbetjeve është një metodë e pranueshme e asgjësimit të mbetjeve.</p>

Tabela e mëposhtme përmbledh burimet kryesore të çdo ndotësi. Është e vlefshme të diktohet se burimet më të mëdha të shkarkimeve nuk janë domosdoshmërisht kontribuesit më të mëdhenj të cilësisë së ulët të ajrit. Ekspozimi varet edhe nga faktorë të tjerë, si për shembull: afërsia e burimit me receptorin si dhe efienca në shpërndarjen në atmosferë.



Tabela 2: Burimet kryesore të ndotjes në Shqipëri

Ndotësi	Burimi kryesor në Shqipëri	Ndikimi në shëndet	Ndikimi mjedisor
Lënda grimcore (PM-PM <sub>10</sub> dhe PM <sub>2.5</sub> )	Lënda grimcore kategorizohet në bazë të madhësisë së grimcave (për shembull PM <sub>2.5</sub> janë grimca me diametër më të vogël se 2.5µm) dhe çlirohet nga burime të ndryshme. Përqendrimet e PM-ve përfshijnë grimca primare të emetuara direkt në atmosferë nga burimet e djegies dhe grimca dytësore të formuara nga reaksione kimike në ajër. Burime të PM-së vijnë si nga aktivitetet njerëzore, ashtu edhe ato natyrore (si stërkalat e detit dhe pluhuri i Saharasë). Në Shqipëri burimet më të mëdha njerëzore janë impiantet stacionare rezidenciale, të cilat përbëjnë rreth 74% të totalit. Këto impiante lëshojnë ngarkesa të mëdha të grimcave, për shkak të përdorimit të burimeve të energjisë me kualitet të ulët dhe mungesës së teknologjive adekuate të trajtimit.	Ekspozim në terma afatshkurtër dhe afatgjatë mund të përkeqësojë sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare, si dhe rritjen e vdekshmërisë.	PM-të dytësore përfshijnë sulfate, nitate dhe ammonium të formuara nga: SO <sub>2</sub> , NO <sub>x</sub> dhe NH <sub>3</sub> që janë faktorët kryesorë të acidifikimit dhe eutrofikimit. Karboni i zi, një agjent jetëshkurtër me potencial në ndryshimet klimatike, është pjesë kyçe e përzierjes së grimcave të ngurta, që rezultojnë nga shkarkimet e proceseve industriale të djegies.
Oksidet e Azotit (NO <sub>x</sub> )	Të gjitha proceset e djegies në ajër prodhojnë okside azoti (NO <sub>x</sub> ). Dyoksidi i azotit (NO <sub>2</sub> ) dhe monoksidi i azotit (NO) janë të dy okside azoti dhe të dy së bashku referohen si (NO <sub>x</sub> ). Transporti rrugor është burimi kryesor, i ndjekur nga sektori i industrisë.	Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive. Përfshihet në formimin e PM-së dhe ozonit. Efektet e ekspozimit afatgjatë janë më pak të sigurt se sa efektet e ekspozimit afatshkurtër.	Kontribuon në acidifikimin dhe eutrofikimin e tokës dhe ekosistemeve ujore, duke dëmtuar habitatet, dhe çon në humbjen e biodiversitetit.
Ozoni (O <sub>3</sub> )	Ozoni nuk emetohet direkt nga ndonjë burim njerëzor. Ai është produkt i reaksioneve kimike, që ndodhin ndërmjet ndotësve të ndryshëm të ajrit, kryesisht NO <sub>x</sub> , dhe përbërjet organike të avullueshme (volatile) VOC, të iniciuar nga rrezatimi i fortë diellor.	Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive.	Mund të shkaktojë dëmtime në bimë, duke çuar në uljen e prodhimit të ushqimit dhe ndikimit në biodiversitet. Ozoni është gjithashtu GES.
Diosksidi i Squfurit (SO <sub>2</sub> )	Ka për origjinë djegjen e karburanteve që përmbajnë squfur, si qymyri dhe vajra të rëndë nga rafineritë.	Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive. Përfshihet në formimin e PM-së	Kontribuon në acidifikimin dhe eutrofikimin e tokës dhe ekosistemeve ujore, duke dëmtuar habitatet, dhe çon në humbjen e biodiversitetit.
Benzeni	Ka një shumëllojshmëri burimesh, por mënyra kryesore është përfundimi nga djegiet shtëpiake, si dhe nga transporti rrugor.	Ekspozimi i njerëzve ndaj benzenit është i lidhur me një sërë sëmundjesh dhe efektesh në shëndet, akute dhe afatgjata, përfshirë kancerin dhe anemone plastike. Benzeni është shumë i avullueshëm dhe ekspozimi më i madh është nëpërmjet frymëmarrjes.	Benzeni avullon shumë shpejt në ajër dhe transportohet në distanca të largëta. Nëse ai shkarkohet në tokë, mund të zbrërthohet shpejt dhe të kontaminojë ujërat nëntokësore.
Monoksidi i Karbonit (CO)	Formohet nga djegia jo e plotë e karburanteve që përmbajnë karbon. Burimi më i madh është transporti rrugor, që së bashku me djegjen nga sektori shtëpiak dhe industrial, konsiderohen si kontribues kryesorë	Shkakton dëmtime të rënda në shëndet, duke reduktuar shpërndarjen e oksigjenit në gjak, në organet e trupit (si zemra dhe truri) dhe në indet.	CO kontribuon në formimin e smogut, ozonit të nivelit të tokës, që shkakton probleme serioze të frymëmarrjes.
Plumbi (Pb)	Shkarkohet nga djegia e qymyrit dhe gjithashtu nga industria e prodhimit të hekurit dhe çelikut, si dhe metaleve joferrorë.	Plumbi akumulohet në gjak, kocka, muskuj dhe dhjam, dhe ka ndikim negativ në tru, nerva, zemër dhe gjak. Të miturit dhe fëmijët e vegjël janë veçanërisht të ndjeshëm edhe ndaj niveleve të ulëta të plumbit	Ndikon në kafshët dhe bimët. Përqendrimet e ulëta të plumbit mund të ngadalësojnë rritjen e bimësisë pranë objekteve industriale. Ndikon tek peshqit. Plumbi mund të hyjë në sistemet e ujërave të shiut dhe ujërave të ndotura urbane dhe industriale. Nivele të larta të plumbit në ujë mund të shkaktojnë dëme riprodhuese në disa jetë ujore dhe shkaktojnë ndryshime të gjakut dhe neurologjike te peshqit dhe kafshët e tjera që jetojnë atje



Në nivel vendi, ndotja e ajrit konsiderohet si një nga problemet kryesore mjedisore. Në të vërtetë, nevoja për përmirësim në sektorin e ajrit është kërkuar në raporte të ndryshme të Komisionit Evropian, duke përfshirë Raportet e Progresit të Monitorimit të KE-së, që japin gjithashtu raporte në sektorin mjedisor.

Një përshkrim më i detajuar i cilësisë së ajrit, shkarkimeve të ndotësve të ajrit, si dhe një vlerësim i cilësisë së ajrit jepet në kapitullin 2.

Disa nga të metat aktuale të sektorit listohen si më poshtë:

1. Monitorimi i cilësisë të ajrit është një komponent kryesor i çdo metode efektive të menaxhimit të cilësisë së ajrit, sepse siguron një dëshmi për vendimmarrësit në menaxhimin dhe përmirësimin e mjedisit tonë. Fatkeqësisht, mungesa e deritanishme e një financimi të përshtatshëm, si dhe deficitet e burimeve, e limitojnë në mënyrë të ndjeshme aftësinë për të ndërmarrë të gjithë monitorimin, që kërkohej për raportimin mbi shkarkimet në ajër dhe cilësinë e ajrit në mjedis. Programi i monitorimit të ajrit duhet të marrë prioritetin e duhur.

2. Praktika e tanishme e monitorimit të cilësisë së ajrit të mjedisit, nuk është në linjë me kërkesat e BE-së. Stacionet automatike të monitorimit prodhojnë të dhëna të përqendrimeve të cilësisë së ajrit, por Siguria dhe Kontrolli i Cilësisë të të dhënave QA/QC nuk është aplikuar ndonjëherë. Sigurimi i Cilësisë është i nevojshëm, nëse të dhënat do të konsiderohen të pranueshme dhe do të përdoren për krijimin e informacionit që duhet për menaxhimin e cilësisë së ajrit. Për të zhvilluar një sistem informacioni dhe monitorimi të mirëpajisur dhe të konsoliduar, është e nevojshme të merren sa më shpejt masat e duhura.

3. Monitorimi i shkarkimeve të substancave ndotëse nga impiantet industriale, nuk mund të arrihet, për sa kohë inspektimi i kontrollit të monitorimit të shkarkimeve industriale nuk kryhet. Për të pasur të dhëna të besueshme të matjeve të kryera nga sektori industrial, do të lindë nevoja për verifikimin e të dhënave të monitorimit, nga Inspektorati Kombëtar i Mjedisit.

4. Në nivel lokal, dy problemet më kritike të cilësisë së ajrit janë:

a) Urbanizimi i lartë i Tiranës, që është qendër atraksioni e shumë aktiviteteve kombëtare, dhe ndotja që rezulton nga trafiku rrugor, që lind si nevojë e lëvizjes së popullatës.

b) Aktiviteti industrial, në zonën – Elbasan dhe Fier - që në kontekst gjeografik nuk favorizon zhvendosjen e masave të ajrit.

5. Analiza e të dhënave tregon problem të përputhshmërisë në lidhje me dy ndotësit, të cilët janë më shqetësuesit për cilësinë e ajrit në Tiranë, Elbasan dhe Fier, si:

a) Dyoksidi i azotit (NO<sub>2</sub>) dhe oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>)

b) Materia/lënda grimcore, më pak se 10 dhe 2.5 mikron në diametër (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>).

Një objektiv specifik për qeverinë është gjithashtu, objektivi i implementimit të një sistemi vlerësimi dhe monitorimi në kohë reale të niveleve të ndotjes, i cili është i aftë të marrë dhe të shpërndajë informacionet e nevojshme, për menaxhimin e duhur të cilësisë së ajrit për situatat e riskut. Nga kjo perspektivë, forcimi i kapaciteteve ekzistuese të AKM-s dhe burimeve monetare shoqëruese kanë prioritet të lartë.

### 1.1.3 Skenarët dhe masat e Planit

Për implementimin e masave të planit, janë identifikuar tri zona të ndryshme me nivele të ndryshme kritike të ajrit të mjedisit:

- **Zona A**, që përfshin aglomeratin e Tiranës dhe Elbasanit, ku janë raportuar situata më kritike për shkelje të limiteve të ligjit dhe për sasinë e popullsisë së ekspozuar.

- **Zona B**, që përfshin njësitë bashkiake të Fierit, Durrësit, Vlorës, Shkodrës, Korçës, Patosit, Ballshit, Kamzës dhe Paskuqanit, e përcaktuar ose nga matje direkte, ose si rezultat i studimeve lokale, nga kapërcimi efektiv, ose risku i lartë i tejkallimit të limiteve të ndotjes, nga të paktën një ndotës.

- **Zona C**, që përfshin territorin e mbetur të vendit, ku ndodhen komunat që kanë një risk të ulët të tejkallimit të kufijve të ndotjes të përcaktuara në ligj.

Të dhënat që janë të disponueshme momentalisht, edhe pse të limituara, tregojnë persistencën e shkeljeve të kufijve për vlerat e ndotësve PM<sub>10</sub> dhe NO<sub>2</sub>, dhe si pasojë, nevojën për të identifikuar masat e duhura, për të arritur vlerat kufi ose një ulje të shkarkimeve. Disa nga veprimet e parashikuara prekin të gjithë vendin,



në mënyrë që të sigurojnë mirëmbajtjen e cilësisë së ajrit, përveç rasteve kur tejkallimet e kufijve nuk janë regjistruar; masa të tjera kanë të bëjnë me ato komuna ku tejkallimi i limiteve është duke u monitoruar, ose janë në risk të lartë tejkallimi të

vlerave kufi, nga të paktën një ndotës. Së fundmi, për dy aglomeratat më kritike (Tiranë dhe Elbasan) parashikohet marrja e masave specifike.

Tabela e mëposhtme jep një skicë të masave të identifikuar.

Tabela 3: Përshkrimi i masave të identifikuar

Zonat kombëtare	Masat e planifikuara
Zona A	<p>Të forcohet kontrolli i shkarkimeve të substancave ndotëse nga impiantet industriale dhe vendosja e gjobave fikse, nëse vlerat e lejuara të shkarkimeve nuk arrihen.</p> <p>Forcimi i kontrollit të shkarkimeve të automjeteve në rrugë dhe lëshimi i gjobave fikse, nëse automjetet nuk plotësojnë kufijtë e lejuar të shkarkimeve.</p> <p>Kufizimi dhe reduktimi i lëvizjes së autoveturave dhe automjeteve private në qendrat urbane.</p> <p>Inkurajimi i lëvizjes nga përdorimi i autoveturave private drejt përdorimit të transportit publik, duke nxitur çiklizmin.</p> <p>Vlerësimi i efekteve në shëndet nga ndotja e ajrit.</p>
Zonat A dhe B	<p>Përtëritja dhe forcimi i mjeteve të transportit publik me ndikim të ulët mjedisor;</p> <p>Zhvillimi i iniciativave, me qëllim inkurajimin e përdorimit të transportit publik;</p> <p>Nxitja e modernizimit të flotës së automjeteve të kompanive të shërbimeve, me mënyra që i përshtaten standardeve evropiane;</p> <p>Të lehtësojë adoptimin e planit të trafikut urban nga bashkitë, që ul trafikun e automjeteve në qendër të bashkisë, adoptim i planit për trafikun e mallrave, për të evituar ose reduktuar lëvizjen e automjeteve të rënda në qendrat urbane.</p> <p>Kontrolli i shkarkimeve nga automjetet, dhe largimi nga përdorimi i atyre me shkarkime të tepërta;</p> <p>Zbatimi i masave të identifikuar në Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Energjitë e Rinovueshme.</p>
Të gjitha Zonat: A; B dhe C	<p>Implementimi i skemave efektive të monitorimit, kontrollit dhe raportimit të burimeve të shkarkimeve;</p> <p>Forcimi i kapaciteteve monitoruese të AAQ-s, AKMs dhe ARMve;</p> <p>Vendosje e shpejtë e standardeve më të shtrënguara të shkarkimeve nga automjetet, me qëllim eliminimin e automjeteve më ndotëse, nëpërmjet përdorimit të taksave të diferencuara.</p>

Për verifikimin dhe monitorimin e planit, do të përgatiten raporte të veçanta nga AKM-ja, për të vlerësuar statusin e implementimit të masave, veçanërisht efektivitetin e tyre, për sa i përket uljes së përqendrimeve të ndotësve në atmosferë.

## 1.2 Karakteristika të përgjithshme të vendit

### 1.2.1 Sipërfaqja dhe popullsia

Plani mbulon të gjithë sipërfaqen e vendit prej 28,748 km<sup>2</sup>.

Shqipëria ndan një kufi 186 km me Malin e Zi në veriperëndim, 112 km me Kosovën në verilindje, 181 km me Maqedoninë, në lindje dhe veri, dhe 212 km me Greqinë, në jug dhe juglindje. Gjatësia e bregdetit të Shqipërisë, në detin Adriatik dhe detin Jon, është 476 km.

Nga pikëpamja administrative, Shqipëria ndahet në 12 rajone administrative (qark). Prej qershorit 2015, këto qarqe ndahen në 61 (bashki), bashkitë ndahen më tej në të paktën dy njësi administrative. Njësitë administrative përbëhen nga një ose më shumë komuna, ose fshatra, dhe përbëjnë ndarjen e tretë dhe të fundit administrative të Shqipërisë.



Tabela 4: Lista e bashkive, njësive bashkiake, popullsia, sipërfaqja dhe dendësia e Qarqeve të Shqipërisë

Qark	Bashkia	Njësia bashkiake	Sipërfaqe (km <sup>2</sup> )	Popullsia	Denditeti
BERAT	Berat	<b>Berat</b> , Otlak, Roshnik, Sinjë dhe Velabisht	380	60,031	158
	Kuçovë	Kozare, <b>Kuçovë</b> , Lumas dhe Perondi	160	31,262	195
	Poliçan	<b>Poliçan</b> , Tërpan dhe Vërtop	272	10,953	40
	Skrapar	Bogovë, Çepan, <b>Çorovodë</b> , Gjerbës, Leshnjë, Potom, Qendër Skrapar, Vendreshë dhe Zhepë	832	12,403	15
	Ura Vajgurore	Cukalat, Kutalli, Poshnjë dhe <b>Ura Vajgurore</b>	157	27,295	174
DIBËR	Bulqizë	<b>Bulqizë</b> , Fushë-Bulqizë, Gjoricë, Martanesh, Ostren, Shupenzë, Trebisht dhe Zerqan	679	31,210	46
	Dibër	Arras, Fushë-Çidhën, Kala e Dodës, Kastriot, Lurë, Luzni, Maqellarë, Melan, Muhurr, <b>Peshkopi</b> , Selishtë, Sillovë, Tomin, Zall-Dardhë	939	61,619	66
	Klos	Gurrë, <b>Klos</b> , Suç dhe Xibër	358	16,618	46
	Mat	Baz, <b>Burrel</b> , Derjan, Komsí, Lis, Macukull, Rukaj and Ulëz.	494	27,600	56
DURRËS	Durrës	<b>Durrës</b> , Ishëm, Katund i Ri, Manëz, Rrashbull and Sukth	339	175,110	517
	Krujë	Bubq, Cudhi, <b>Fushë-Krujë</b> , <b>Krujë</b> , Nikël dhe Kodër-Thumanë	339	59,814	176
	Shijak	Gjepalaj, Maminas, <b>Shijak</b> dhe Xhafzotaj	92	27,861	303
ELBASAN	Belsh	<b>Belsh</b> , Fierzë, Grekan, Kajan dhe Rrasë	197	19,503	99
	Cërrik	<b>Cërrik</b> , Gostimë, Klos, Mollas dhe Shalës,	190	27,445	144
	Elbasan	<b>Bradashesh</b> , <b>Elbasan</b> , Funarë, Gjergjan, Gjinar, Gracen, Labinot-Fushë, Labinot-Mal, Papër, Shirgjan, Shushicë, Tregan dhe Zavalinë	873	141,714	162
	Gramsh	<b>Gramsh</b> , Kodovjat, Kukur, Kushovë, Lenie, Pishaj, Poroçan, Skënderbegas, Sult and Tunjë	740	24,231	33
	Librazhd	Hotolisht, <b>Librazhd</b> , Lunik, Orenjë, Polis, Qendër Librazhd dhe Stëblevë	794	31,892	40
	Peqin	Gjoçaj, Karinë, Pajovë, <b>Peqin</b> , Përparim and Shezë	198	26,136	132
	Prenjas	<b>Prenjas</b> , Qukës, Rrajcë dhe Stravaj	323	24,906	77
FIER	Divjak	<b>Divjak</b> , Grabian, Gradisht, Remas dhe Tërbuf	310	34,254	110
	Fier	Cakran, Dërmenas, <b>Fier</b> , Frakull, Levan, Libofshë, Mbrostar Ura, Portëz, Qendër dhe Topojë	620	120,655	195
	Lushnjë	Allkaj, Ballagat, Bubullimë, Dushk, Fier-Shegan, Golem, Hysgjokaj, Karbunarë, Kolonjë, Krutje dhe <b>Lushnjë</b>	373	83,659	224
	Mallakastër	Aranitas, <b>Ballsh</b> , Fratar, Greshicë, Hekal, Kutë, Ngraçan, Qendër Dukas dhe Selitë	329	27,062	82
	Patos	<b>Patos</b> , Ruzhdie dhe Zharrëz	83	22,959	277
	Roskovec	Kuman, Kurjan, <b>Roskovec</b> dhe Strum	118	21,742	184
GJIROKASTËR	Dropull	Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm dhe Pogon	449	3,503	8
	Gjirokastër	Antigonë, Cepo, <b>Gjirokastër</b> , Lazarat, Lunxhëri, Odrie dhe Picar	470	28,673	61
	Këlcyrë	Ballaban, Dishnicë, <b>Këlcyrë</b> dhe Sukë	305	6,113	20
	Libohovë	Libohovë, <b>Qendër Libohovë</b> dhe Zagori	248	3,667	15
	Memaliaj	Buz, Krahës, Luftinjë, <b>Memaliaj</b> , Memaliaj Fshat dhe Qesarat	372	10,657	29
	Përmet	Çarçovë, Frashër, <b>Përmet</b> , Petran dhe Qendër Piskovë	602	10,614	18




	Tepelenë	Kurvelesh, Lopës, Qendër Tepelenë dhe <b>Tepelenë</b>	432	8,949	21
KORÇË	Devoll	<b>Bilisht</b> , Hoçisht, Miras, Progër dhe Qendër Bilisht	454	26,716	59
	Kolonjë	Barmash, Çlirim, <b>Ersekë</b> , Leskovik, Mollas, Novoselë, Qendër Ersekë dhe Qendër Leskovik.	865	11,070	13
	Korçë	Drenovë, <b>Korçë</b> , Lekas, Mollaj, Qendër Bulgarec, Vithkuq, Voskop dhe Voskopojë	807	75,994	94
	Maliq	Gorë, Libonik, <b>Maliq</b> , Moglicë, Përg, Pojan dhe Vreshtas.	657	41,757	64
	Pogradec	Buçimas, Çërravë, Dardhas, <b>Pogradec</b> , Proptisht, Trebinjë, Udenisht dhe Velçan	595	61,530	103
	Pustec	<b>Pustec</b>	199	3,290	17
KUKËS	Has	Fajzë, Gjinaj, Golaj dhe <b>Krumë</b>	400	16,790	42
	Kukës	Arrën, Bicaj, Bushtricë, Grykë-Çajë, Kalis, Kolsh, <b>Kukës</b> , Malzi, Shishtavec, Shtiqën, Surroj, Tërthore, Topojan, Ujmisht dhe Zapod	935	47,985	51
	Tropojë	<b>Bajram Curri</b> , Bujan, Bytyç, Fierzë, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj dhe Tropojë	1,058	20,517	19
LEZHË	Kurbini	Fushë Kuqe, <b>Laç</b> , Mamurras dhe Milot	269	46,291	172
	Lezhë	Ballëdren, Blinisht, Dajç, Kallmet, Kolsh, <b>Lezhë</b> , Shëngjin, Shënkoll, Ungrej dhe Zejmen	510	65,633	129
	Mirditë	Fan, Kaçinar, Kthellë, Orosh, <b>Rrëshen</b> , Rubik and Selitë	870	22,103	25
SHKODËR	Fushë- Arrës	Blerim, Fierzë, <b>Fushë-Arrëz</b> , Iballë dhe Qafë-Mali	541	7,405	14
	Malësi e Madhe	Gruemirë, Kastrat, Kelmend, <b>Koplik</b> , Qendër dhe Shkrel	952	30,823	32
	Pukë	Gjegjan, <b>Pukë</b> , Qelëz, Qerret dhe Rrapë	506	11,069	22
	Shkodër	Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, <b>Shkodër</b> , Shosh dhe Velipojë	873	135,612	155
	Vau i Dejës	Bushat, Hajmel, Shllak, Temal, <b>Vau i Dejës</b> dhe Vig-Mnelë	499	30,438	61
TIRANË	Kamzë	<b>Kamzë</b> dhe Paskuqan	37	104,190	2816
	Kavajë	<b>Kavajë</b> , Golem, Helmas, Luz i Vogël dhe Synej	199	40,094	201
	Rrogozhinë	<b>Tirana</b>	224	22,148	99
	Tiranë	Gosë, Kryevidh, Lekaj, <b>Rrogozhinë</b> dhe Sinaballaj	1,111	557,422	502
	Vorë	Bërxullë, Prezë dhe <b>Vorë</b>	83	25,511	307
VLORË	Delvinë	<b>Delvinë</b> dhe Vergo	183	7,598	42
	Himarë	Aliko, Dhivër, <b>Finiq</b> , Livadhja dhe Mesopotam	572	7,818	14
	Konispol	<b>Himarë</b>	222	8,245	37
	Finiq	<b>Konispol</b> , Markat dhe Xarrë	442	10,529	24
	Sarandë	Ksamil dhe <b>Sarandë</b>	59	20,227	343
	Selenicë	Armen, Brataj, Kotë, <b>Selenicë</b> , Sevaster dhe Vllahinë	562	16,396	29
	Vlorë	Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë, Shushicë dhe <b>Vlorë</b>	617	104,827	170
			<b>28,368</b>	<b>2,800,138</b>	



Harta 1 tregon densitetin e popullsisë në nivel të njëjësive bashkiake. Vërehet një shpërndarje hapësinore e pabarabartë e popullsisë, ku 27% e banorëve janë përqendruar në qarkun e Tiranës, sipërfaqja e të cilit përbën vetëm 5% të të gjithë vendit. Rëndësi të madhe ka sigurisht Bashkia e Tiranës, me 557,422 banorë<sup>2</sup>, ekuivalente me 74% e popullsisë së qarkut, duke e bërë më të populluarën në Shqipëri. Një tjetër zonë dendësisht e populluar është rripi bregdetar (Durrës dhe Vlorë), si dhe zona e industrializuar e njëjësive administrative të Fierit dhe Elbasanit.

Harta 1: Densiteti i popullsisë në njësitë bashkiake të Shqipërisë



<sup>2</sup> Burimi: INSTAT Census 2011.



### 1.2.1 Ekonomia

Shqipëria ka një ekonomi të tregut të lirë, që prej fillimit të viteve '90. Vendi është i pasur me burime natyrore dhe ekonomia mbështetet më shumë nga agrikultura, përpunimi i ushqimit, prerja e drurëve, minierat, nxjerrja e naftës dhe vajrave, metalet bazike, hidrocentralet, turizmi dhe industria e tekstileve. Ndërtimi, sidomos për strehim, është një nga faktorët që ndikon në rritjen e investimeve.

**Bujqësia** ka punësuar 47.8% të popullsisë dhe rreth 24.31% e tokës përdoret për qëllime bujqësore. Produktet kryesore bujqësore janë: duhani, fiqtë, ullinjë, gruri, misri, patatet, perimet, frutat, panxhari i sheqerit, rrushi, mish, mjalti, produktet e bulmetit si dhe mjekësia tradicionale dhe bimët aromatike. Megjithatë agrikultura kontribuon 18.9% të GDP-së së vendit dhe një pjesë të madhe të eksporteve, ushtrimi i saj mbetet i kufizuar vetëm për operacionet e vogla familjare dhe kultivimit për të siguruar jetesën. Mungesa e aparateve moderne, të drejtat e paqarta të pronës dhe mbizotërimi i parcelave të vogla dhe joeficiente të tokës, përbëjnë pengesë për zhvillimin e një industrie moderne agrikulturore. Megjithatë, skena agrikulturore është duke ndryshuar gradualisht, me futjen e kooperativave, investimit të huaj, formalizimit të fermerëve dhe ndërtimit të qendrave të mbledhjes dhe shpërndarjes.

**Shfrytëzimi i minierave** është një sektor i madh (por në tkurrje) i ekonomisë, duke pasur parasysh depozitat e pasura me minerale të boksitit, kromit, nikelit, hekurit dhe bakrit. Ka aktivitete të ndryshme të dhëna me koncesion ndaj kompanive vendase ose/dhe atyre të huaja, për shfrytëzimin e kromit, nikel-silikatit, bakrit, bitumit, çimentos, kaolinit, alabastrës, mermerëve dhe baltës për prodhimin e tullave, prodhimin e zhavorrit të shtratit të lumit dhe materialeve të ndërtimit prej guri.

Shqipëria ka depozitën e dytë më të madhe në Ballkan (pas Rumanisë) dhe rezervat më të mëdha tokësore të naftës në Evropë. Prodhimi krudo i Shqipërisë arriti në më shumë se 1.2 milionë tonë më 2013, megjithatë prodhimi i naftës dhe prodhimi nga rafinerië e naftës ka rënë që pas 1990-s, për shkak të teknologjisë së

tyre të papërshtatshme.<sup>3</sup>

### 1.2.1 Transporti

Shqipëria u është nënshtruar ndryshimeve të rëndësishme në dy dekadat e fundit, duke modernizuar gjerësisht infrastrukturën e vendit. Përmirësimet në infrastrukturën e rrugëve, hekurudhave, transportit urban dhe aeroporteve, kanë çuar në një përmirësim të madh në transport. Këto përmirësime kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në mbështetjen e ekonomisë së Shqipërisë, që në dekadën e fundit është mbështetur kryesisht në industrinë e ndërtimit.

Në vitet e fundit, ka pasur një dyndje të ndërtimit të rrugëve kryesore në Shqipëri, duke përfshirë ndërtimin e rrugëve të reja, vendosjen e sinjalistikës bashkëkohore, mbjelljen e pemëve si dhe projekte të tjera të gjelbërimit. Punimet në shumicën e rrugëve kombëtare kanë mbaruar. Aktualisht, bashkitë kryesore lidhen me njëra-tjetrën me rrugë interurbane kryesore ose dytësore. Ekziston një karrexhatë dyshe, që lidh bashkinë e Durrësit me atë të Tiranës dhe pjesërisht Kukësin. Ka tre segmente kryesore autostrade në Shqipëri: Thumanë-Milot-Rrëshen-Kalimash (A1), Levan-Vlorë (A2), dhe pjesërisht Tiranë-Elbasan (A3). Shumica e rrjetit rrugor në zonat rurale vazhdojnë të mbeten në kushte të këqija, sepse rikonstruktimi i tyre ka filluar nga fundi i viteve 2000. Investimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit kanë sjellë përmirësimin e rrjetit rrugor rural.

### 1.2.2 Topografia dhe moti

Cilësia e ajrit në mbarë vendin është rezultat i ndikimit të shkarkimeve ndotëse, të shoqëruara me ndërveprimin e topografisë së terrenit, si malet, luginat dhe motit, të tilla si: era, temperatura, turbulencat e ajrit, presionet e ajrit, reshjet dhe retë.

#### Topografia

Shqipëria është kryesisht malore, me 70% të territorit në lartësi prej më shumë se 300 m. Pjesa tjetër e vendit përbëhet nga një ultësi bregdetare dhe luginat më të ulëta të lumenjve hapen në ultësinë bregdetare. Malet shqiptare, që përfaqësojnë një vazhdimësi jugore të sistemit Dinarik, ngrihen befas nga fusha, duke u thyer

<sup>3</sup> Burimi:

<http://www.nationsencyclopedia.com/economies/Europe/Albania-INDUSTRY.html#ixzz3zCXaCSur>





sidomos, përgjatë kufijve të vendit. Topografia e vendit luan një rol të rëndësishëm në qarkullimin atmosferik dhe shpërndarjen e ndotësve.

Në të vërtetë përqendrimet e ndotësve mund të jenë më të mëdha në luginat, sesa në zonat më të larta. Kjo është për shkak se, në kushte të caktuara atmosferike, ndotësit mund të bllokohen në zonat e ulëta, të tilla si lugina. Kjo ndodh për shembull, në ditët ende me diell, kur nivelet e ndotjes mund të rriten për shkak të mungesës së erës për të shpërndarë ndotjen. Kjo mund të ndodhë në ditët e qeta, të ftohta dhe me mjegull gjatë dimrit. Natën, ajri i ftohtë ka tendencë të thahet drejt kodrës, duke u vendosur në basenet e ulëta dhe lugina. Në pamundësi për të ngritur, ajri i ftohtë vendoset dhe grumbullohet në këto lugina, duke bllokuar ndotësit e ajrit. Përveç kësaj, ndërmarrjet bujqësore dhe hortikulturore (kopshtaritë) në luginat pjellore, nxisin shpërndarjen e ndotjes nga ndikimet e fekondimit, korrijës, rritjes së kafshëve dhe aktiviteteve të tjera. Gjatë kushteve mbizotëruese të temperaturës inverse, pjesa më e madhe e shkarkimeve të shoqëruara nga ajri, mund të mbeten të bllokuara pjesërisht dhe të lokalizohen në luginë për periudha të zgjatura.

Nëse qytetet janë të rrethuar nga kodra, siç është rasti për Elbasanin dhe Tiranën, gjatë dimrit mund të ndodhë smogu. Ndotja nga automjetet, shtëpitë dhe burime të tjera mund të bllokohen në luginë, shpesh pas një natë të kthjellët pa re. Ajri i ftohtë pastaj, bllokohet nga një shtresë e ajrit të ngrohtë të mësipërm të luginës. (temperatura inverse)

#### **Kushtet e motit**

Ultësira bregdetare ka një mot të tipik mesdhetar (dimër të butë dhe me shi dhe verë me diell dhe të nxehtë), ndërsa zona malore ka një klimë më kontinentale. Në të dyja zonat, e ulët dhe terrenin më malor në brendësi, moti ndryshon nga veriu në jug. Ultësira bregdetare ka një dimër të butë, me pak mundësi të netëve të ftohta në dimër, dhe vera të freskëta pasditeve. Temperaturat gjatë ditës janë kryesisht rreth 7°C. Temperaturat verore mesatare janë 24°C, por ndonjëherë shkojnë më shumë se 30°C. Në ultësirën jugore, temperaturat mesatare shkojnë rreth pesë gradë më të larta gjatë gjithë vitit.

Në Tiranë, e cila ndodhet rreth 30 kilometra nga bregdeti, dimri është ende i butë dhe me shi,

por ndonjëherë gjatë natës, ajo mund të bëhet e ftohtë, ndërsa vera është e nxehtë dhe me diell, me disa ditë shumë të nxehta.

Në qytetet e vendosura në pjesën më të brendshme fushore apo ato të strehuara nga malet (të tilla si Shkodra), klima bëhet pak më shumë kontinentale, që është, më pak e ftohtë në dimër, me një mesatare në janar rreth 5°C, dhe më nxehtë në verë, që shkon rreth 35°C.

Duke lëvizur në brendësi, dhe me rritjen e lartësisë, klima bëhet shumë më e ashpër, me dimër të ftohtë dhe me dëborë, dhe vera progresivisht e freskët. Për shembull, në Korçë, e vendosur në lindje, 900 metra mbi nivelin e detit, temperatura mesatare shkon nga 0,5 ° C në janar, në 21°C në gusht.

Reshjet mesatare janë të rënda; shira të rënda bien në shpatet kodrinore dhe malore me të cilat përballen perëndimi dhe jugu, dhe ato shpesh e kalojnë 2,000 milimetra në vit. Përgjatë bregdetit dhe në fushë, regjimi i reshjeve është mesdhetar, me një shumë maksimale në mes të vjeshtës dhe dimrit, dhe minimum në verë, kur rrallë bie shi, ndërsa në zonat malore gjatë verës mund të ketë disa stuhi pasditeve.

Moti ka një efekt të rëndësishëm në nivelet e ndotjes së ajrit dhe në shpërndarjen e shkarkimeve ndotëse. Në përgjithësi, shpejtësia e erës luan një rol në hollimin e ndotësve në zonat më të prekura dhe në rritjen e përqendrimeve ndotëse në zonat me aktivitete më të pakta antropogjene. Erërat mbizotëruese janë gjithashtu, përgjegjëse për transferimin e shkarkimeve ndërkufitare ajrore. Në përgjithësi, erërat e forta shpërndajnë ndotësit, ndërsa erërat e lehta rezultojnë në kushte të “palëvizshmërisë”, duke lejuar ndotësit të qëndrojnë në një sipërfaqe. Vendet bregdetare dhe zonat e hapura shpesh përjetojnë mot me shumë erë dhe prandaj ka të ngjarë, të kenë cilësinë më të mirë të ajrit, siç është rasti për qytetet dhe qytezat përgjatë bregdetit Adriatik dhe Jon.

Drejtimi i erës gjithashtu, ndikon në ndotjen e ajrit. Në qoftë se era fryn drejt një zone urbane nga një zonë industriale, atëherë nivelet e ndotjes kanë të ngjarë të jenë më të larta në qytet ose qytezë, në krahasim me nivelet e ndotjes kur ajri fryn nga një drejtim tjetër, për shembull tokë bujqësore e hapur. Modelimi duke përdorur shpejtësinë e erës, dhe treguesit e drejtimit



(trëndafilat e erës) mund të japin të dhëna për drejtimin, nivelin dhe ndikimin e mundshëm të ndotësve të përkohshëm.

Dielli që shkëlqen mund të ndikojë edhe në nivelet e ndotjes. Në ditët e nxehta të verës, ndotja nga automjetet, veçanërisht  $\text{NO}_x$ , mund të reagojë me komponimet organike të avullueshme (VOCs) për të formuar ozonin. Ky reaksion nxitet nga rrezet ultravjollcë të diellit. Ndotja që shkakton ozonin, formohet zakonisht nga automjetet në qytete dhe qyteza, dhe që mund të transportohet nga erërat, duke bërë që nivele të larta të ozonit mund të gjenden në zonat rurale. Presioni i ajrit gjithashtu ndikon në krijimin e niveleve të ndotjes. Gjatë sistemeve me presion të lartë, ajri lejon krijimin e niveleve të ndotjes, por gjatë sistemeve të presionit të ulët, moti është shpesh i lagësht dhe me erë, duke bërë që ndotësit të shpërndahen ose të lahen jashtë në atmosferë nga shiu.

Inversioni i temperaturës, i cili çon në rritje të kushteve “të palëvizshme” është i lidhur zakonisht me episode të mëdha të ndotjes së ajrit. Në kushte normale, ajri pranë sipërfaqes është më i ngrohtë. Ajri i ngrohtë ngrihet dhe përzihet me ajrin e ftohtë më sipër. Kjo është e njohur si një gjendje “e paqëndrueshme”. Inversioni mund të zhvillohet, kur masa e ajrit të ngrohtë, më pak i dendur, lëviz sipër mbi një masë ajri më të ftohtë dhe më të dendur, duke krijuar një temperaturë inversioni, ku ajri i ftohtë tani është më afër sipërfaqes. Ndotësit nuk janë në gjendje të përzihen vertikalisht, dhe do të qëndrojnë të grumbulluar pranë tokës, për shkak të këtyre kushteve “të qëndrueshme”

### **Shkarkimet nga ndotja**

Disa ndotës janë të përqendruar më shumë, në zona të ndryshme, në varësi burime të emetimit. Për shembull, ndotja nga automjetet mund të gjenerojë nivele të larta të dyoksidit të azotit, monoksidin e karbonit dhe hidrokarbureve në qytete, siç është rasti për Tiranën, Elbasanin dhe Fierin. Megjithëse ndotësit nga transporti janë përgjithësisht të përhapur, për shkak të lëvizshmërisë së automjeteve, ndikimet e tyre negative në përgjithësi lokalizohen në qytete, sidomos në qytetet ku intensiteti i qarkullimit të automjeteve është më i madh. Ndotja nga grimcat mund të jetë e lartë, si pasojë e djegies së karburantit nga ana e mjeteve rrugore, hekurudhore, detare dhe ajrore, punëve të ndërtimit, shkarkimeve industriale, pluhurit të

tokës, rrugëve dhe guroveve. Shkarkimet nga ndotja mund të transportohen në vende të tjera gjithashtu, përtej kufijve, për të krijuar nivele të larta të ndotësve, të tilla sikurse është rasti i ozonit.

### **1.3 Kuadri ligjor**

Progres është bërë në fushën e menaxhimit të cilësisë së ajrit, që me miratimin e ligjit nr. 162/2014, datë 4.12.2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”; dhe VKM-së nr. 352, datë 29.4.2015 “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”, që përaftron direktivat 2008/50/EC (Ajër më i pastër për Evropën) dhe 2004/107/EC (Metalet e rënda në ajrin e mjedisit).

Lista e akteve ligjore që përafrojnë direktivat e BE-së janë:

- VKM-ja nr. 147, datë 21. 3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel”;

- VKM-ja nr. 781, datë 14.11.2012 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme të lëngshme për përdorim termik, civil dhe industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”;

- VKM-ja nr. 1075, datë 23.12.2015 “Për masat për kontrollin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezultojnë nga magazinimi dhe shpërndarja e benzinës nga terminallet në stacionet e shitjes së karburanteve”.

- VKM nr. 907, datë 21.12.2016 “Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve”;

- VKM nr. 908, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e masave për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime”.

- VKM nr. 909, datë 21.12.2016 “Për rikuperimin e avujve të benzinës në fazën e dytë, gjatë mbushjes së mjeteve motorike në stacionet e shitjes së karburanteve”.

Është e nevojshme t'i jepet formë aspektit ekzistues rregullator, i cili në mënyrë direkte ose jodirekte rregullon çështjet e ndotjes së ajrit, në mënyrë që të merren parasysh masat strukturore të parashikuara nën dispozitat ekzistuese rregullatore.

Plani për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Shqipëri është në përputhje me kërkesat e ligjit të



mbrojtjes së cilësisë së ajrit dhe legjislacionit të sektorit të ajrit të BE-së, duke përfshirë:

- masat dhe standardet për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit;
- masat dhe standardet për të limituar shkarkimet nga burimet pikësore;
- masa për të luftuar shkarkimet nga automjetet;
- standardet për cilësinë e karburantit.

Qeveria është angazhuar, që, nëpërmjet përafrimit dhe implementimit të plotë të standardeve ligjore të Komunitetit Evropian, në sektorët e njëjtë dhe ata të lidhur me ajrin, dhe nëpërmjet rregullimit të shkarkimeve nga proceset industriale, të arrijë një ajër më të pastër, duke shtrënguar shkarkimet dhe standardet e karburanteve për automjetet rrugore në mënyrë progresive, duke kontrolluar tymin nga burimet shtëpiake dhe nga djegia e mbetjeve.

Prioritet është përbushja e kërkesave ligjore të BE-së, duke përfshirë vlerat kufi të cilësisë së ajrit të BE-së kudo në Shqipëri; monitorimi i ndotjes së ajrit që rrjedh nga burime të ndryshme, si burimet stacionare (impiante industriale), automjete etj., si dhe marrja e masave për të hequr shkaqet e tejkalimeve të kufijve të lejuar për agjentët e ndryshme të ndotjes, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit.

Drafti final i Planit të Transportit të Qëndrueshëm (STP), ndihmon për të përbushur objektivat e mëposhtëm sfidues, për të reduktuar konsumin e energjisë dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së përgjithshme në sektorin e transportit:

- Ulja e ndikimeve të ndotjes së ajrit në shëndetin, të lashtat etj. (tregues: shkarkimet e ndotësve të ajrit ton / vit);
- De-karbonizimi, reduktimi i emetimeve të GS-ve (tregues: emetime të CO<sub>2</sub> ton / vit);
- Efikasiteti i energjisë (treguesi: ton naftë ekuivalent).

Në përputhje me objektivat e BE-së (20-20-20), Shqipëria ka vendosur objektiva sasiorë, në lidhje me efikasitetin e energjisë (rritje prej 9%), dhe nga burime të ripërtëritshme të energjisë (të rritet deri në 38%), në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Këto objektiva janë shqyrtuar me Planin Kombëtar të Veprimit të Eficiencës së Energjisë, miratuar me VKM nr. 709, datë 1.12.2017 “Mbi Miratimin e Planit të Dytë dhe të Tretë Kombëtar të veprimit mbi Eficiencën e Energjisë për Shqipërinë, 2017–2020”.

Bashkëpërfitimet e cilësisë së ajrit/ndryshimeve klimatike do të realizohen përmes veprimeve, të tilla si: promovimit të burimeve të ripërtëritshme të karburantit, masave të eficiencës së energjisë, si dhe masave të transportit të qëndrueshëm.

Prioritetet e mëposhtme janë vendosur për të arritur standardet evropiane të cilësisë së ajrit të ambientit:

- Të vazhdohet me zhvillimin e një kuadri të qartë të politikave, i cili do të përfshijë, aty ku është e përshtatshme, legjislacionin dhe/ose masat jorregullatore;

Të sigurojë përafrim të plotë: duke përgatitur, adoptuar dhe implementuar legjislacionin e ri dhe/ose të rishikuar, procedurat administrative, udhëzimet dhe standardet.

### 1.3.1 Plani i përafrimit

Përafrim do të thotë: adoptim ose ndryshim të ligjeve, rregullave dhe procedurave kombëtare, në mënyrë që kërkesat e çdo ligji të BE-së, të përfshihen në rendin ligjor kombëtar, ndaj ky plan përbën një prioritet të lartë të Qeverisë.

*Plani ligjor i përafrimit* përbëhet nga një sërë veprimesh që duhen të ndërmerren, në mënyrë që ta arrijnë përafrimin e plotë, në mënyrë graduale. Këto veprime jepen në tabelën e mëposhtme.



Tabela 5: Masat për përafrim të plotë

Direktiva/Rregullorja	Akti ligjor kombëtar	Masat për përafrim të plotë	Koment
Direktiva e cilësisë së Ajrit të Mjedisit (direktiva kuadër) Direktiva 2008/50 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 21 maj 2008, mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajrit më të pastër për Evropën.	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Ligji 162/2014 “Mbi mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”.</li> <li>➤ VKM-ja Nr. 352/2015, datë 29.4.2015, “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”.</li> </ul>	<p>Hartimi, miratimi dhe hyrja në fuqi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ VKM-ja mbi Metodologjinë dhe Procedurën për Vlerësim paraprak dhe krijimin e Listës së Zonave dhe Aglomerateve të Cilësisë së Ajrit në Mjedis.</li> <li>➤ VKM-ja mbi Monitorimin dhe Raportimin e Cilësisë së Ajrit në Mjedis.</li> <li>➤ VKM-ja mbi vlerat limit të niveleve dhe tipeve të substancave ndotëse në ajrin e mjedisit dhe pragjeve alarmante, mbi afatet për arritjen e vlerave limit, kufijve të tolerancës për vlerat limit, vlerat e synuara, objektivat afatgjatë.</li> </ul>	
Direktiva e metaleve të rënda në Ajrin e Mjedisit. Direktiva 2004/107/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 15 dhjetor 2004, në lidhje me arsenikun, kadmiumin, zhivën, nikelin, dhe hidrokarburet policiklike aromatike në ajrin e mjedisit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Ligji 162/2014 “Mbi mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”;</li> <li>➤ VKM-ja nr. 352/2015, datë 29.4.2015. “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”.</li> </ul>		
Direktiva e Tavaneve të Emetimit (NEC) Direktiva e këshillit dhe e Parlamentit evropian, 14 dhjetor 2016 2016/2284/EC mbi reduktimin e shkarkimeve kombëtare të disa ndotësve atmosferikë që amendon direktivën 2003/35/EC dhe shfuqizon direktivën 2001/81EC.		Hartimi i një VKM-je nën ligjin 162/2014.	Nuk është përafuar akoma Planifikuar, nga MTM, për dhjetor 2019.
Vendimi i Këshillit 81/462/EEC i datës 11 qershor 1981, mbi konkluzionet e Konventës “Për ndotjen ndërkuftare të ajrit në distancë të largët”.	<p>Kjo Konventë dhe Protokollet e saj janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Ligji nr. 10422, datë 26.5.2011 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin për Financimin Afatgjatë të Programit Kooperues, për Monitorimin dhe Vlerësimin e Transferimit të Ndotësve të Ajrit në Distancë të Mëdha në Evropë” (Gjenevë 1984).</li> </ul>		



- Ligj nr. 10062, datë 29.1.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin “Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare”, të Konventës së vitit 1979, “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët”; Fletorja Zyrtare: Viti 2009, nr. 9, Faqe 221; Data e botimit: 9.2.2009.
- Ligj nr. 10063, datë 29.1.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin “Për reduktimin e shkarkimeve të squfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare, të paktën në masën 30 për qind të Konventës së vitit 1979, “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët”; Fletorja Zyrtare: Viti 2009, nr. 9, Faqe 221; Data e botimit: 9.2.2009.
- Ligji nr.10436, datë 28.6.2011 “Për aderimin në “Protokoll për reduktimin e mëtejshëm të shkarkimeve të SO<sub>2</sub> (Oslo 1994)”.
- Ligji nr.10476, datë 3.11.2011 “Për aderimin në Gothenburg Protocol për të pakësuar acidifikimin, eutrofikimin dhe përqendrimin e nivelit të ozonit në shtresën e poshtme të atmosferës (Gothenburg, November 1999)”.

#### Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Direktiva për Shkarkimet VOC-ve që rezultojnë nga magazinimi dhe shpërndarja e benzinës

Direktiva 94/63 / KE-së e Parlamenti Evropian dhe e Këshillit mbi kontrollin e përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezultojnë nga magazinimi i benzinës dhe shpërndarjes së saj nga терминаlet në stacionet e shërbimit, e ndryshuar me Rregulloren (KE) nr. 1882/2003.

Direktiva 1999/13 / KE-së e Këshillit “Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime” e ndryshuar nga Rregullorja 1882/2003 (OJ L 85, 29.3.99). Kjo Direktivë është shfuqizuar prej 2014 nga

VKM nr.1075, datë 23.12. 2015 “Për masat për kontrollin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC), që rezultojnë nga magazinimi dhe shpërndarja e benzinës nga терминаlet në stacionet e shitjes së karburanteve”.

VKM-ja nr. 908, datë 21.12.2016 “Për masat për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime”.

VKM nr. 908/2016, ka përafuar pjesërisht Direktivën IED 2010/75/BE. Referencat e bëra tek Direktiva e shfuqizuar duhet të konsiderohen sikur janë bëre tek



Direktiva IED 2010/75/BE.

2002/529 / KE: Vendimi i Komisionit i 27 qershorit 2002 në lidhje me një pyetësor për raportimet e Shteteve Anëtare mbi zbatimin e Direktivës 1999/13 / KE “Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime”.

VKM-ja nr. 908, datë 21.12.2016 “Për masat për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime. (Kreu IV i VKM përcakton rregullat për monitorimin dhe raportimin, në zbatim të tij)

Urdhër i përbashkët i ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrit përgjegjës për industrinë, në zbatim të pikës 4, të kreut IV, të VKM 908/2016.

kapitulli V i Direktivës mbi Shkarkimet industriale (IED)

Nuk është përafuar akoma. Nuk ka një detyrim specifik për ta transpozuar atë. Pyetësi për raportimet, i përcaktuar në vendimin e Komisionit 2002/529/KE, do të ndihmojë në përcaktimin e formatit të raportimit dhe koordinimin në nivel ndërinstitucional.

2000/541 / KE: Vendimi i Komisionit i 6 shtatorit 2000 mbi kriteret për vlerësimin e planeve kombëtare sipas nenit 6 të Direktivës së Këshillit 1999/13 / KE.

Përgatitja nuk ka filluar akoma.

Nuk është përafuar akoma

#### Direktiva e Bojërave

Direktiva 2004/42/CE e Parlamentit dhe e Këshillit e 21 prillit 2004 për kufizimin e përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i përbërësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e automjeteve dhe amendimin e direktivës 1999/13/EC; (FZ L 143, 30.4.2004, fq.0087-0096).

VKM-ja nr. 907, datë 21.12.2016 “Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve”.

#### Direktiva faza II

Direktiva 2009/126/EC mbi fazën II të rigjenerimit të avullit të benzinës gjatë mbushjes së mjeteve motorike në pikat e shitjes.

VKM-ja nr. 909, datë 21.12.2016 “Për rikuperimin e avujve të benzinës në fazën II gjatë mbushjes së mjeteve motorike në stacionet e shitjes së karburanteve”.

#### Transporti dhe mjedisi

Përafuar (pjesërisht) me anë të:

Direktiva e Këshillit 70/220 / EEC e 20 marsit 1970 mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare mbi masat që do të merren kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e automjeteve, i ndryshuar. (Direktiva është shfuqizuar nga Rregullorja (KE) Nr. 715/2007)

➤ Udhëzimit të përbashkët nr. 6527, datë 24.12.2004, të Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Transportit “ Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre”;

➤ Udhëzimit nr. 12, datë 2010/06/15 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.

VKM “Për masat që do të merren kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e automjeteve”. Planifikuar të hartohet në bazë të ligjit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit nëpërmjet bashkëpunimit të Ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe Ministrisë përgjegjëse për transportin. Afati nuk është përcaktuar ende



6527, datë 24.12.2004 shoqëruar nga Manuali i kontrollit të mjeteve.

Direktiva 97/68/EC e Këshillit dhe e Parlamentit Evropian e datës 16 dhjetor 1997 mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me djegie të brendshme që instalohen në makineritë e lëvizshme jorrugore, amenduar nga Direktiva 2002/88/EC, Direktiva 2004/26/EC, Direktiva 2006/105/EC, Direktiva 2010 / 26 / EU, Direktiva 2011/88 / EU, Direktiva 2012/46 / EU). Direktiva është shfuqizuar nga Rregullorja 2016/1628/BE mbi kërkesat që lidhen me kufizimin e shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull dhe miratimin e tipit për motorët me djegie të brendshme për makinerinë jorrugore, që amendon Rregulloren nr. 1024/2012 dhe N° 167/2013 dhe që amendon dhe shfuqizon Direktivën 97/68/EC

Përgatitja nuk ka filluar akoma.

Vendim “Për masat që do të ndërmerren kundër shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me djegie të brendshme që instalohen në makineritë e lëvizshme jorrugore “. Planifikuar të hartohet në bazë të ligjit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit nëpërmjet bashkëpunimit të Ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe Ministrisë përgjegjëse për transportin. Afati nuk është përcaktuar ende.

Direktiva nuk është transpozuar dhe duke qenë se nuk ka asnjë detyrim për të transpozuar Rregulloren, gjatë hartimit të Vendimit duhen marrë në konsideratë kërkesat teknike dhe administrative

Direktiva 2000/25 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2000 mbi veprimet që duhet ndërmarrë kundër shkarkimeve të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët e destinuar për të fuqizuar traktorët bujqësorë ose pyjorë dhe amendon Direktivën e Këshillit 74/150 / EEC. **Shfuqizuar nga Direktiva** (BE) nr. 167/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 shkurt 2013 për miratimin dhe mbikëqyrjen e tregut të automjeteve bujqësore dhe pyjore (duke shfuqizuar Direktivën 77/537/EEC mbi shkarkimet e tymit nga motorët me naftë për përdorim në traktorë bujqësorë apo pyjorë e datës 31 dhjetor 2015).

Përgatitja nuk ka filluar akoma.

Direktiva nuk është transpozuar; Rregulloret nuk duhet të jenë pjesë e procesit të Përafrimit, megjithatë gjatë hartimit të legjislacionit kombëtar duhet të mbahen parasysh masat teknike dhe administrative.

**Direktiva për ndotësit e gaztë nga furnizimi me benzinë dhe naftë automjeteve.**

Direktiva 2005/55/EC e Këshillit dhe e Parlamentit Evropian e datës 28 shtator 2005 mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimeve të ndotësve të gaztë dhe

Përgatitja nuk ka filluar akoma.

Vendim “Për masat që do të ndërmerren kundër shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion dhe motorët me ndezje pozitive që dëgjin gaz natyral apo të lëngshëm për përdorim në automjete “.

Direktiva nuk është transpozuar; Rregulloret nuk duhet të jenë pjesë e procesit të Përafrimit, megjithatë gjatë hartimit të legjislacionit kombëtar duhet të mbahen parasysh masat teknike dhe administrative.



lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion dhe motorët me ndezje pozitive që djegin gaz natyral apo të lëngshëm për përdorim në automjete, e ndryshuar nga Direktiva e 2006/51 / EC e 6 qershor 2006 e ndryshuar, për qëllimet e përshtatjes me progresin teknik, aneksi I i Direktivës 2005/55 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit dhe Aneksat IV dhe V të Direktivës 2005/78 / EC në lidhje me kërkesat për sistemin e monitorimit të kontrollit të shkarkimit për përdorim në automjete dhe përjashtimet për motorët me gaz. Direktiva 2005/55/EC është shfuqizuar nga Rregullorja (EC) 595/2009 e datës 31 Dhjetor 2013

Planifikuar të hartohet në bazë të ligjit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit nëpërmjet bashkëpunimit të Ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe Ministrisë përgjegjëse për transportin. Afati nuk është përcaktuar ende.

Rregullorja (EC) 715/2007 e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës e datës 20 qershor 2007 mbi aprovimin e tipit të motorëve të automjeteve në lidhje me shkarkimet nga automjetet për pasagjer dhe tregtar (euro 5 dhe euro 6) dhe mbi aksesin për riparimin e automjeteve dhe mirëmbajtjen e informacionit.

Përgatitja nuk ka filluar akoma.

Nuk është përafuar akoma

#### Cilësia e lëndës djegëse

Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe naftë.

Direktiva 98/70 / EC në lidhje me cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe naftë që amendon Direktivën e Këshillit 93/12 / EEC, e ndryshuar nga Direktiva 2000/71 / EC53, Direktiva 2003/17 / EC54 dhe Rregulloren (EC) Nr 1882 / 2003.

Përafuar (pjesërisht) me anë të:

- VKM-së nr. 147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”.
- VKM-së nr. datë 30.7.2008 “Për cilësinë e naftës së prodhuar përmes rafinimit të naftës së brendshme bruto”.

Standardet për prodhimin dhe rafinimin në vend të naftës ende nuk janë në përputhje me ato të përcaktuara nga Direktiva<sup>4</sup>.

#### Direktiva për përmbajtjen e squfurit në lëndët djegëse të lëngshme

Direktiva e Këshillit 1999/32/EC e datës 26 prill 1999 në lidhje me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në disa lëndë djegëse të lëngshme dhe amendon Direktivën 93/12/EC siç amendohet nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 219/2009 dhe Direktivat 2005/33/EC dhe 2009/30/EC. Direktiva (BE) 2016/802 e parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 Maj 2016 që lidhet me një reduktim të

VKM-së nr.781, datë 14.11.2012 “ Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor).

Hartimi i një VKM-je të re, me iniciativë të MIE-s.

Referencat e bëra tek Direktiva duhet të konsiderohen si të bëra tek Direktiva (BE) 2016/802 e parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 Maj 2016 që lidhet me një reduktim të përmbajtjes së squfurit në disa lëndë djegëse të lëngshme, e cila ka kodifikuar dhe shfuqizuar Direktivën 1999/32

<sup>4</sup> VKM nr. 52, datë 14.1.2009, DCM no.52, “Mbi cilësinë e lëndës djegëse gasoil të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë dhe tregtuar për automjetet rrugore dhe gjeneratorët”, është shfuqizuar me vendim nr. 24 të Gjykatës Kushtetuese, datë 24.07.2009, sepse konsiderohej jo në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.





përmbajtjes se squfurit në disa lende djegëse të lëngshme, e cila ka kodifikuar dhe shfuqizuar Direktivën 1999/32.

Direktiva 2009/28/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 Prill 2009 mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme dhe që amendon dhe rrjedhimisht shfuqizon Direktivën 2001/77/BE dhe 2003/30/BE për promovimin e përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme për transport.

ligji nr. 138/2013 “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, i miratuar më dt. 2.5.2013;

Është plotësisht i përafuar

Direktiva 2009/30 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 prill 2009 që amendon Direktivën 98/70 / EC në lidhje me specifikimin e benzinës, naftës dhe gazoililit dhe futjen e një mekanizmi për të monitoruar dhe për të reduktuar shkarkimet e gazit dhe amendimin e Direktivës 1999/32 / EC në lidhje me specifikimin e karburantit të përdorur nga anijet që lundrojnë në brendësi dhe shfuqizon Direktivën 93/12 / EEC.

Përgatitja nuk ka filluar akoma.

Nuk është përafuar

#### **Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)**

Direktiva për shkarkimet VOC-ve që rezultojnë nga magazinimi dhe shpërndarja e benzinës.

Direktiva 94/63 / KE e Parlamenti Evropian dhe e Këshillit mbi kontrollin e përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezultojnë nga magazinimi i benzinës dhe shpërndarjes së saj nga terminallet në stacionet e shërbimit, e ndryshuar me Rregulloren (KE) nr. 1882/2003.

VKM-ja nr. 1075, datë 23.12.2015 “Për masat për kontrollin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC), që rezultojnë nga magazinimi dhe shpërndarja e benzinës nga terminallet në stacionet e shitjes së karburanteve”.



#### 1.4 Informimi dhe komunikimi i planit

Përhapja e informacionit midis qytetarëve dhe aktorëve të ndryshëm, është thelbësore jo vetëm për të lehtësuar të kuptuarit e objektivave dhe propozimeve për çdo veprim të përfshirë në Plan, por edhe për të motivuar individët për të marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e konsolidimit.

Është e nevojshme që komunikimi të këtë për qëllim promovimin e rëndësisë së veprimeve të planit me anë të rritjes së ndërgjegjësimit me fokus në aktivitetet më ndotëse, në mënyrë që të mundësojë të gjithë qytetarët, që të kontribuojnë dhe të marrin pjesë në procesin e reduktimit të shkarkimeve të ndotësve, duke siguruar atyre informacion lehtësisht të përdorshëm.

Për më tepër, taksat e qytetarëve do të përdoren për të financuar implementimin e Planit për Përmirësimin e Cilësisë së Ajrit, prandaj është e rëndësishme informimi i tyre mbi përfitimet që lidhen me zbatimin e planit në lidhje me koston e zbatimit të tij (analiza kosto-përfitim - CBA).

Në këtë kuptim, ministria përgjegjëse për mjedisin do të fillojë fushata informuese dhe takime tematike, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e shtypit lokal, në mënyrë që, jo vetëm të shpërndajë informacionin për natyrën, burimet dhe shpërhapjen e ndotësve, përmbajtjes dhe objektivat e Planit dhe masave të planifikuara, por edhe për të rritur ndërgjegjësimin dhe trajnimin e popullsisë mbi nevojën për të zbatuar ndryshimet në mënyrën e jetesës së përditshme në drejtim të lëvizshmërisë, konsumit të energjisë dhe përputhjes me burimet e disponueshme, duke theksuar aftësitë e individëve për të kryer një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë të ajrit.

Gjithashtu, është e rëndësishme dhënia e informacionit për publikun mbi cilësinë e ajrit, analizën, dhe ndërhyrjet e nevojshme për të reduktuar shkarkimet. ministria përgjegjëse për Mjedisin në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, si dhe agjencitë e përfshira vë në dispozicion të publikut, të dhënat e përditësuara mbi cilësinë e ajrit, duke i publikuar në internet, nivelet e përqendrimit të ndotësve në atmosferë.

#### 2. Karakteristikat dhe ndikimet e ajrit të ndotur

Megjithëse ka shumë vite hulumtimi, jemi bërë më të vetëdijshëm se ndotja e tepërt e ajrit shkakton ndikime të pafavorshme në shëndetin e

njeriut dhe në mjedis, shumë pak dihet për shtrirjen e ndikimeve negative. Si rregull, njerëzit sa më afër trafikut të jenë, aq më shumë ndotje ata thithin. Nivelet e ndotjes në “pika të nxehta”, siç janë rrugët shumë të zëna, mund të jenë shumë më të larta se mesatarja urbane. Shkarkimet nga tymi i shkarkimit të automjeteve motorike, janë të njohura botërisht si të dëmshme për shëndetin e njeriut. Këto shkarkime mund të shkaktojnë vdekje të hershme në mesin e njerëzve që janë më në rrezik, sidomos foshnjat me kapacitet të kufizuar të mushkërive, atyre që tashmë kanë probleme zemre ose frymëmarrjeje, dhe të moshuarve dhe të sëmurëve. Ndotja e tillë mund të shkaktojë sëmundjet e frymëmarrjes të cilat më pas, mund të zhvillohen në sëmundje kronike me përkeqësime të simptomave. Cilësia e dobët e ajrit ndikon në cilësinë e përgjithshme të jetës, nëpërmjet irritimeve të vogla, si kollitjet, ftohjet dhe dhimbjet e fytyrës. Kështu, ka potencial të shkaktojë humbjen e mijëra ditëve të punës përmes sëmundjes, ose humbjen e vështirësive të përqendrimit dhe të produktivitetit në mjediset arsimore dhe të punës.

Cilësia e ajrit është një ndër çështjet më kritike mjedisore me interes për popullatën. Deri disa vite më parë, në fakt, ndotja e ajrit mund të konsiderohej një problem i kufizuar në qendrat me të mëdha urbane, ndërsa tani, nga banorët e qyteteve të mëdha, duket të perceptohet si një problem i përhapur, për shkak të nivelit të lartë të ndotësve që ndodhin si gjatë muajve të dimrit (grimcat e imta, oksidet e azotit...) dhe niveleve të larta të ozonit, veçanërisht në verë, kur reagentet atmosferike janë katalizuar në mënyrë më efikase.

Modelet e ajrit, që përfshijnë shpejtësinë e erës dhe treguesit e drejtimit (trëndafilat e erës), përdoren për të ilustruar se si shkarkimet ndotëse të ajrit, nga një zonë në një zonë tjetër, të ndikuar nga shpejtësia dhe drejtimi i erës që mbizotëron, mund të kenë një ndikim katastrofik. Kjo ishte veçanërisht e dukshme në Pyllin e Zi, ku radikalët acidë (në formën e shiut acid) shkatërruan gjysmën e pemëve, si dhe vegetacionin dhe faunën e lindur nga viti 1960 deri në vitin 1990. Në fillim të viteve 1970 hulumtimi tregoi se liqenet dhe pyjet skandinave acidifikohen me shpejtësi (me ndikime të dëmshme shoqëruese në florën, faunën dhe biodiversitetin e tyre) nga radikalët e acidit të mbartur në ajër.

Ndikimet e pafavorshme ndërkuftare të



ndotësve të ajrit po bëhen gjithnjë e më të dukshëm, në lidhje me lëshimin dhe formimin e gazrave serrë dhe ndikimin që rezulton në ndryshimet klimatike.

Prania e ndotësve të caktuar në atmosferë është rezultat i bashkëveprimit të aktiviteteve natyrore dhe njerëzore, përfshirë shkarkimet e brendshme, industriale, bujqësore, të transportit dhe natyrore. Shpërndarja dhe transformimet kimike të cilat ndodhin në atmosferë, me kalimin e kohës, shtojnë kompleksitetin e ndikimeve të ndotësve të ajrit. Prandaj, është shumë e rëndësishme të mos ngatërrohen shkarkimet e ndotësve (treguesve të presionit), me përqendrimit (treguesit e statusit) që janë shprehur për shembull në njësinë matëse- $\mu\text{g}/\text{m}^3$ , dhe që karakterizojnë cilësinë e “ajrit që thithim”.

Për këtë arsye, njohja e shkarkimeve (dhe burimeve të tyre) është e domosdoshme për monitorimin e cilësisë së ajrit, pasi ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë proporcionaliteti midis këtyre dy elementeve dhe identifikimit të vazhdueshëm të politikës më të përshtatshme të përmirësimit të cilësisë së ajrit. Hulumtimi i vazhdueshëm mbi natyrën dhe ndikimin e ndotësve të mbartur nga ajri, përfshin modele parashikuese, për të treguar ndikimet e mundshme në të ardhmen. Në shumë vende të mëdha të industrializuara ka një rritje të shpejtë të shkarkimeve nga transporti (kryesisht për shkak të rritjes së numrit të automjeteve), nga prodhimi i energjisë (kryesisht për shkak të rritjes së kërkesës për të plotësuar nevojat e rritjes industriale në vendet në zhvillim dhe nxitur nga përdorimi i lëndëve djegëse fosile më të lira) dhe në sektorin e brendshëm për ngrohje, ujë të ngrohtë dhe ajër të kondicionuar për të përmbushur kërkesat më të pasura të një popullsie në rritje globale. Për më tepër, për shumë aktivitete të mëdha industriale dhe impiante energjie, në mbarë botën, nuk përdoren teknologjitë më të mira në dispozicion për uljen e shkarkimeve.

### 2.1 Cilat janë burimet e ndotjes në Shqipëri?

Burimet e shkarkimeve janë të ndara në burime pikësore dhe të shpërndara, që mund të jenë kryesisht të lokalizuara. Burimet pikësore të ndotjes janë burime stacionare të shkarkimeve të ajrit, si fabrika, termocentrale, fonderi, rafineri dhe impiante kimike. Ndikimet e tyre janë kryesisht të lokalizuara, edhe pse varen nga shpejtësia, forca

dhe drejtimi i erës, ndikimet negative të tyre mund të zbulohen në distanca të mëdha nga pikat e tyre të origjinës, siç u diskutua në nënparagrafin e mësipërm. Burimet pikësore përfshijnë të gjitha ato burime, për të cilat është e dobishme dhe kur është e mundur, të përcaktohen në mënyrë individuale koordinatat gjeografike dhe parametrat e shkarkimeve të oxhaqeve. Burim i lokalizuar është çdo burim i vetëm i identifikueshëm i ndotjes nga impiantet e mëdha të palëvizshme, të tilla si: impiantet e djegies së lëndëve djegëse fosile (termocentrale), furnaltat, kaldajat industriale, rafineritë e naftës dhe ndërmarrjet e prodhimit. Shkarkimet e shpërndara në ajër ndodhin nga burime të ndryshme të shpërndara, të tilla si: mjetet e transportit rrugor, aviacioni, ngrohja e banesave, bujqësia dhe biznesi i vogël. Ndotja nga burimet e shpërndara ndodh në zona të mëdha dhe në mënyrë individuale nuk mund të jetë shqetësuese, por në kombinim me burime të tjera të shpërndara, mund të ketë ndikim në mjedis. Ndotësit e shpërndarë që lëshohen në ajër, përfshijnë oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>), oksidet e squfurit (SO<sub>x</sub>), monoksidit të karbonit (CO), amoniakut (NH<sub>3</sub>) dhe grimcat (PM<sub>10</sub>). Megjithëse shkarkimet e transportit përgjithësisht referohen si burime “të shpërndara”, për shkak të lëvizjes së automjeteve, shumica e shkarkimeve nga sektori i transportit janë nga burimet pikësore (shkarkimet e automjeteve), me një sasi të vogël nga avullimi i naftës / gazit dhe rrjedhjeve, gomave dhe konsumit të frenave dhe rrugor dhe hekurudhor.

Kjo do të thotë se, ndryshe nga ndotësit e ajrit të shpërndarë nga bujqësia, shumica e ndotjes së shpërndarë nga transporti mund të trajtohet në të njëjtën mënyrë, si burimet pikësore nga industritë stacionare dhe impiantet energjetike, domethënë duke reduktuar shkarkimet nga njësitë individuale (autovetura, autobus, kamion, tren, aeroplan, anije) në burim. Meqenëse lëvizja më e madhe e trafikut ndodh në zonat e ndërtuara (qytete, aglomerate), ndikimet më të rënda të ndotjes së shpërndarë nga sektori i transportit, janë gjithashtu të lokalizuara.

Shkarkimet nga sektori i brendshëm (domethënë nga oxhaqet e shtëpive dhe blloqeve të apartamenteve) janë gjithashtu, përgjithësisht të referuara si burime të shpërndara, sepse banesat e tilla konsiderohen kolektivisht, pasi nuk është e mundur dhe praktike që të monitorohen shkarkimet nga çdo oxhak. Megjithatë, njësitë



(shtëpia, blloku i apartamenteve, zyra, dyqani, punishtet) që shkaktojnë ndotjen kolektive të shpërndarjes, janë gjithashtu burime stacionare pikësore dhe ashpërsia kolektive e ndikimeve të tyre negative në cilësinë e ajrit mund të reduktohen më së miri, duke kufizuar shkarkimet nga çdo burim individual pikësor. Kjo mund të arrihet me disa metoda, p.sh. izolim më të mirë që rezulton me më pak energji të shpenzuar për ngrohje, ujë të ngrohtë dhe ajër të kondicionuar; përdorimin e sistemeve më efikase të djegies së karburantit, aplikimin e burimeve alternative të energjisë, si p.sh. gjeotermale, era ose panelet diellore.

Efektet sinergjike dhe shtuese të ndotësve nga impiantet e energjisë, ndërmarjet industriale, shtëpitë, aglomeratet e banimit, zyrat, qeveria dhe departamentet shtetërore, shkollat, universitetet, industritë e shërbimit (parukeritë, lavanderitë etj.), farmacitë, përdorimi i autoveturave dhe servisit të automjeteve kontribuojnë në impaktet negative të lokalizuara të ndotësve të ajrit, në qytete dhe zona të tjera me densitet të lartë të popullsisë. Ndikimet negative të kombinuara në cilësinë e ajrit në qytete, vijnë nga efektet antropogjene të njerëzve që jetojnë, udhëtojnë, punojnë dhe civilizohen në këto zona me densitet të lartë të popullsisë.

Siç është përmendur më parë, ende ekziston një mungesë e theksuar e njohurive në lidhje me natyrën, shkallën dhe ndikimin e shkarkimeve ndotëse (veçanërisht ata ndotës të absorbuar ose të absorbuar nga grimcat e imëta të cilat janë të ngjashme me burimet të çastit të karbonit aktiv, me një kapacitet të lartë për absorbimin dhe absorbimin). Mënyra më e mirë për të trajtuar problemet e shkarkimeve që lidhen me ndikimet antropogjene të jetesës, udhëtimet, punën dhe civilizimin në të njëjtin qytet, është trajtimi i të gjitha çështjeve antropogjene që shkaktojnë ndikimin në unison.

Megjithëse çështja e shqyrtimit të ndikimit të kombinuar të burimeve pikësore dhe të shpërndara të ndotjes në qytete dhe në zonat e banuara është diskutuar gjerësisht gjatë dekadës së fundit, çështjet kohët e fundit kanë marrë më shumë vëmendje, përmes Planit të Veprimit të 7-të, që përfshin

zhvillimin e qëndrueshëm si objektivi kyç deri në vitin 2020.

### 2.1.1 Burimet pikësore

Shkarkimet e lokalizuara nuk janë aq të rëndësishme, sa tri dekada më parë në Shqipëri, kur një sasi e madhe e ndotësve shkarkoheshin nga oxhaqet e kompanive industriale dhe ndërtesave komunale, pa ndonjë teknikë paraprake për zvogëlimin e tyre. E vetmja teknike e përdorur ishte hollimi i ndotësve në një masë të pranueshme, nëpërmjet oxhaqeve të larta dhe distancave të largëta prej tyre, me ndërtesat komunale fqinje.

Ndotësit kryesorë ishin veprimtaria e çimentos në Krujë, Elbasan, Tiranë dhe Shkodër, kombinatet metalurgjike në Elbasan, Kukës, Laç dhe Rubik, si dhe nxjerrja dhe përpunimi i aktiviteteve të naftës në rrethet Fier, Berat dhe Vlorë. Djegia e druve dhe djegia e qymyrit ishin gjithashtu, aktivitete të rëndësishme ndotëse në qytetet kryesore të vendit gjatë kohës së dimrit.

Koeficientët e shkarkimeve janë shumë më të ulët se më parë për industrinë e prodhimit të çimentos dhe uzinave metalurgjike, për shkak të nivelit më të mirë të teknologjisë së përdorur dhe teknikave më të mira të filtrimit. E njëjta gjë vlen edhe për aktivitetet e nxjerrjes së naftës, por jo për impiantet e përpunimit të naftës, ku teknologjia e përdorur është e vjetër.

Pjesa më e madhe e informacionit në lidhje me burimet pikësore, që është vlerësuar si i dobishëm, të merret në konsideratë në mënyrë individuale, për shkak të rëndësisë së këtyre shkarkimeve janë mbledhur çdo vit nga formati i PRTR-së, nga AKM-ja, në të cilin janë të përfshira në përgjithësi, për çdo burim, disa nga këto të dhëna: përshkrim sintetik i procesit të prodhimit, të dhënat e shkarkimeve nga oxhaqet dhe sistemet e zvogëlimit të shkarkimeve dhe informacionin karakteristik (aktiviteti, kapaciteti i prodhimit, lëndët e para të përdorura, konsumin e karburantit).

Më poshtë është lista e instalimeve, të cilat janë vlerësuar si më të rëndësishmet në aspektin e shkarkimeve, dhe për këtë arsye konsiderohen individualisht:



Qarku	Bashkia	Njësia bashkiake	Emri i instalimit	Aktiviteti
Durrës	Krujë	Thumanë	Antea Cement	Prodhim çimento
Durrës	Krujë	Fushë-Krujë	Cement Factory Fushë-Krujë	Prodhim çimento
Fier	Mallakastër	Ballsh	ARMO	Rafineri nafte
Fier	Fier	Fier	ARMO	Rafineri nafte
Fier	Patos	Patos	AlbPetrol	Nxjerrje nafte
Fier	Roskovec	Kuman	Bankers Petroleum	Nxjerrje nafte
Elbasan	Elbasan	Bradashesh	ACR	Prodhim ferro-kromi
Elbasan	Elbasan	Bradashesh	Kurum	Prodhim çeliku

### 2.1.2 Burimet difuze

Shkarkimet e shpërndara janë të gjitha ato, që nuk mbulohen nga kategoritë e përcaktuara më lartë, dhe llogaritja e të cilave kërkon përdorimin e parametrave statistikore; në këto kategori bëjnë pjesë: shkarkimet nga burimet pikësore që nuk tejkalojnë kufijtë e shkarkimeve të përcaktuar më sipër, shkarkimet nga burimet natyrore (p.sh. që vijnë nga zjarret në pyje), ose ato të lidhura kryesisht me trafikun.

Transporti publik dhe potenciali për çiklizëm të sigurt duhet të përmirësohet, për të kompensuar rritjen e numrit të automjeteve.

Është e rëndësishme të theksohet se kufizimet për përdorimin e automjeteve private do të shkaktojë rezistencë, pasi individët nuk do të jenë gati të heqin dorë nga përdorimi i automjeteve të tyre personale, pa një alternativë e cila punon në mënyrë efikase, dhe që ka në të njëjtën kohë, ndikim minimal në ndotjen e ajrit.

Një reformë në transportin publik është e nevojshme dhe duhet të përfshijë zëvendësimin e të gjithë autobusëve nën euro III, dhe të sigurohet një freskim i vazhdueshëm i flotës me standardet minimale të zbatueshme në Direktivat Evropiane dhe rregulloret.

Masat rregullatore të taksave mbi “tarifat efikase dhe stimuj për rinovimin e flotës”, të parashikuara në Planin e Transportit të Qëndrueshëm (STP), janë të përshtatshme, për të inkurajuar alternativat zëvendësimit të automjeteve të vjetra.

#### **4.1.2 Përmirësimi i kontrollit të cilësisë së lëndës djegëse**

Është një domosdoshmëri e madhe kontrolli, monitorimi dhe zbatimi i standardeve më të mira

të cilësisë së karburantit në Shqipëri, për shkak të faktit se ka shumë ankesa për cilësinë e karburanteve në treg. Argumenti kryesor i shitësve të makinave është se nuk ka karburant, sipas specifikimeve të reja EURO, për makinat moderne të fundit të importuara nga ana e tyre në tregun shqiptar. Si pasojë, një kontroll i rregullt i cilësisë së lëndës djegëse, si dhe përgatitja e raportimit kombëtar vjetor mbi të dhënat e cilësisë së karburanteve, në përputhje me një format të përbashkët për dorëzimin e përmbledhjeve të të dhënave kombëtare të cilësisë së karburanteve në përputhje me ato të BE-së (2002 vendimi / 159 / EC), është një domosdoshmëri e madhe. Standardet për shkarkimet e automjeteve të kombinuara me lëndë djegëse të pastra, me përmbajtje të ulët squfuri, do të jetë një hap i madh, drejt përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe reduktimit të ndikimeve shëndetësore. Standardet e automjeteve nuk do të jenë aq efektive, pa standarde po aq të rrepta të cilësisë së karburantit.



Tabela 10: Masat për reduktimin e shkarkimeve nga trafiku

Masat	Veprimi	Territori i aplikimit	Përgjegjësitë	Data e zbatimit
Inkurajimi i kalimit nga përdorimi i automjeteve private drejt llojeve të tjera të udhëtimit dhe nxitjen e përdorimit të transportit publik për të reduktuar shkarkimet e automjeteve dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Promovimi dhe inkurajimi i lehtësirave në çiklizëm brenda zonave të banuara, për të mundësuar rrugë të sigurta çiklizmi nga shkollat lokale dhe dyqanet. Theksi do të jetë në inkurajimin e përdorimit të çiklizmit që do të zvogëlojë volumin e makinave private që udhëtojnë gjatë periudhës së pikut të trafikut në mëngjes.</li> <li>o Përgatitja dhe zbatimi i planit të transportit për një rrjet strategjike të rrugëve të biçikletave dhe rrugëve të çlodhjes. Ky plan duhet të përfshijë kushte më të sigurta për biçikletat, përmirësime në parkim të biçikletave dhe komunikim të përshtatshëm mes çiklizmit dhe mënyrave të tjera të udhëtimit. Ky plan duhet gjithashtu, të japë vëmendjen e duhur masave të përshtatshme për qetësimin e trafikut, në zonat e banuara, në afërsi të rrugës, për të parandaluar një përkeqësim në cilësinë e ajrit.</li> <li>o Promovimi dhe inkurajimi i rrugëve të sigurta dhe të përshtatshme për të ecur nga shkollat dhe dyqanet në zonat e banuara me theks të veçantë në sigurimin e rrugëve alternative 'të sigurta' për udhëtime të shkurtra, zakonisht më pak se 1-2 km gjatësi.</li> <li>o Mbështetje dhe inkurajim në zbatimin e shpejtë të korridoreve cilësore të autobusëve dhe masave të tjera prioritare për autobusët, përgjatë rrugëve kryesore të trafikut.</li> <li>o Sigurimi i lehtësirave të shërbimit të autobusëve ndërrurban dhe shërbimeve hekurudhore periferike, për të lehtësuar lëvizjen për në/ dhe nga puna.</li> <li>o Futja e politikave me fokus tarifit e përdorimit të rrugëve për automjetet private.</li> </ul>	Zona A dhe B	bashkitë njësitë bashkiake <b>ministra përgjegjëse për transportin</b>	2019-2025
Menaxhimi dhe kontrolli i rrjedhës së trafikut në mënyrë që të shmanget bllokimi i automjeteve dhe qëndrimi i zgjatur në kryqëzimet e rrugëve dhe në zonat urbane, duke përmirësuar cilësinë e ajrit në këto vende.	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Adresimi i propozimeve mbi masat e qetësimin të trafikut, për të kufizuar volumin e trafikut që kalon përmes zonave të banuara ose në afërsi, ose si një mjet për të shmangur kryqëzime të mëdha rrugore.</li> <li>o Promovimin e planeve për futjen e qelizave mjedisore të trafikut (ETC) në qendrat urbane. Monitorimi i fluksit të trafikut në zonat e afërta për të siguruar se nuk ka ndikim negativ</li> </ul>	Zona A dhe B	bashkitë njësitë bashkiake <b>ministra përgjegjëse për transportin</b> <b>Policia e Shtetit</b>	2019-2022



	<p>në cilësinë e ajrit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Vlerësimi i futjes së strategjive të menaxhimit të trafikut, si një mjet për të parandaluar një përkeqësim të mëtejshëm në cilësinë e ajrit në "pikat e nxehta".</li> <li>○ Promovimi i përmirësimit të kulturës së trafikut do të jetë për arsye shëndetësore dhe sigurie. Policia është pala më e rëndësishme e interesuar, në lidhje me sigurinë e trafikut.</li> <li>○ Shkelje të rënda të ligjeve të trafikut, sidomos në lidhje me sigurinë për përdoruesit e rrugëve të lehta, do të ndëshkohen me gjobë dhe / ose kufizime.</li> </ul>			
Rregullimi dhe kufizimi i shkarkimeve nga të gjitha mjetet motorike.	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Forcimi i kontrolleve vjetore të detyrueshme të shkarkimeve të gazta në të gjithë vendin, për të gjitha automjetet në pronësi të drejtuesve (motoçikleta / makina - private / publike).</li> <li>○ Ndalimi i qarkullimit për të gjitha automjetet private dhe publike që nuk janë në gjendje të mirë, ose që tejkalojnë vlerën e përcaktuar të kufirit të shkarkimeve.</li> <li>○ Pajisja e inspektorëve me mjete më të mira dhe pajisje për testimin e shkarkimeve.</li> <li>○ Rritja e numrit të kontrolleve në rrugë.</li> </ul>	Të gjitha zonat	<p>ministra përgjegjëse e Transportit</p> <p>Inspektorati Shtetëror I Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave</p>	2025
Promovimi i përdorimit të automjeteve me ndikim të ulët.	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Të nxitet blerja e automjeteve elektrike.</li> <li>○ Krijimi i rrjetit shpërndarës për karikimin elektrik.</li> <li>○ Lehtësimi në rritjen e shpërndarjes së stacioneve të mbushjes me ndikim të ulët (GLN dhe metan).</li> <li>○ Sigurimi i karburantit me përmbajtje të ulët të squfurit dhe me cilësi të lartë (në nivel me MS-të) të përdoret në të gjitha mjetet e transportit.</li> </ul>	Të gjitha zonat	<p>- Ministria e Financës dhe Ekonomisë, nëpërmjet politikave lehtësuese të taksimit;</p> <p>- Pushteti vendor/Bashkitë/Iniciativë Private</p> <p>MIE, si ministria përgjegjëse e Transportit</p> <p>- MIE, dhe MFE/Doganat/Inspektorati përgjegjës për kontrollin e karburanteve</p>	Pas 2022
Kontrolli dhe reduktimi i shkarkimeve nga automjetet e shërbimit publik.	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Verifikimi i rregullt i testimit të shkarkimeve të automjetit, autobusëve dhe flotës së automjeteve, për të kufizuar dhe për të reduktuar shkarkimet e grimcave dhe ndotësve të tjerë të ajrit.</li> <li>○ Mbështetje për zëvendësimin e stokut të vjetër të automjeteve, taxi, autobusëve dhe kamionëve.</li> <li>○ Inkurajimi i programeve për</li> </ul>	Zona A dhe B	<p>MIE, Bashkitë, njësitë bashkiake Koncesionarët e shërbimeve publike</p>	Pas 2022



	<p>konvertimin e motorit ekzistues në automjete, në autobusë dhe kamion për GLN-ë ose metan.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o Përtëritja e flotës së automjeteve të përdorura nga organet publike, koncesionarët e shërbimeve publike dhe kompanive komunale/ shërbimeve (operatorët e transportit, grumbullimit të mbeturinave, pastrimit të rrugëve, operatorët e rrjetit të energjisë, burimeve ujore, autobus shkolla) me automjete me ndikim të ulët / zero në mjedis.</li> </ul>			
Hartimi i një strategjie afatshkurtër të menaxhimit për automjetet komerciale.	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Kufizimet për automjetet më ndotëse në qendrat urbane të njëjësive bashkiake, gjatë ditëve të javës (kufizimet mbulojnë automjetet e klasifikuara euro1 dhe euro2).</li> <li>o Zhvillimi i zonave “vetëm për ecje / çiklizëm”, në qytetet kryesore të Zonave A dhe B.</li> <li>o Përgatitja e propozimeve për të rregulluar lëvizjen e automjeteve të rënda që transportojnë mallra nëpër zonat e banuara dhe zonat e shitjes me pakicë.</li> <li>o Përcaktimi i rrugëve prioritare për automjete të tilla që udhëtojnë për në/ dhe nga portet.</li> <li>o Kufizimi, aty ku shihet e nevojshme, i vendeve dhe periudhave gjatë ditëve të javës, se kur do të lejohet ngarkimi/shkarkimi për të reduktuar bllokimet e trafikut në qendrat urbane.</li> </ul>	Zona A dhe B	Bashkitë Njësitë bashkiake	2022-2023
Kufizimi dhe zvogëlimi i nivelit të parkimit në rrugë dhe jashtë rrugës, në qendrat urbane, për të reduktuar volumet e trafikut dhe shkarkimet e automjeteve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Promovimi i parkimeve të kufizuara në qendër të bashkisë, për të reduktuar ngjeshjen e shkaktuar nga automjetet private dhe shkarkimet e automjeteve. Masat e propozuara mund të përfshijnë ngritjen tarifës së parkimit në rrugë, zbatimin e rregulloreve për parkimet e kufizuara, në zona larg qendrës së bashkisë, dhe dekurajimi i parkimit në rrugë, gjatë gjithë ditës.</li> <li>o Ulja e numrit të parkimeve 'pa pagesë' në rrugë, në qendër të bashkisë dhe në zonat e afërta.</li> <li>o Futja e një sistemi për të promovuar zonat e parkimit privat.</li> <li>o Futja e tarifës së parkimit me një përqindje të caktuar e cila do të shkojë drejt investimeve të mëtejshme për përmirësimin e parkimit.</li> <li>o Caktimi i terminalëve të autobusëve jashtë qendrës së qytetit për udhëtarët.</li> </ul>	Zona A	Bashkitë Njësitë bashkiake	2023
Ndërtimi i hapësirave të gjelbëruara përgjatë	o Ndërtimi i zonave me gjelbërim të përjetshëm me një përthithje të lartë	Të gjitha zonat	MIE, si ministria përgjegjëse e Transportit, NjQV	2024





rrugëve kryesore të trafikut	përgjatë rrugëve kryesore të trafikut			
<p>Tarifat bazë efikase dhe stimujt për rinovimin e flotës (Plani i Qëndrueshëm i Transportit)</p>	<p>Rishikimi i sistemit aktual të taksave të automjeteve në Shqipëri si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o Aplikimi i taksës për të gjitha automjetet në mënyrë të pavarur nga mosha, por në mënyrë proporcionale në nivelin e teknologjisë dhe nivelin e shkarkime të vetë automjetit.</li> <li>o Rritja e taksave në proporcion me cilindrat/ madhësinë e motorit.</li> <li>o Gradualisht përjashtimi nga taksat i automjeteve të reja me ndotje të ulët (si Euro VI dhe V ose automjetet hibride / elektrike).</li> </ul>	Të gjitha zonat	MIE, si ministria përgjegjëse e Transportit ministria përgjegjëse e mjedisit ministria përgjegjëse e financës	
<p>Sigurimi i inspektimit dhe zbatimi i legjislacionit që lidhet me cilësinë e karburanteve të jetë sa më efikas.</p>	<p>Baza e të dhënave për cilësinë e karburantit e zhvilluar dhe e përditësuar çdo vit; inspektime dhe kontrole në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– vendet e tregimit, vendet industriale dhe të ruajtjes dhe subjektet që ngarkojnë, shkarkojnë, mbushin, transportojnë dhe përdorin vajra të lëngshme në të cilat kanë tanket e magazinimit;</li> <li>– të naftës;</li> <li>– stacionet e benzinës;</li> <li>– kamionet-me depozitë/tanke.</li> </ul> <p>Kontrolli përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Kontrolli i deklarimit të disponueshmërisë</li> <li>– Dokumentet e regjistrimit të kompanisë</li> <li>– Të mostrave përfaqësuese</li> <li>– Dorëzimi i mostrave në laboratore të akredituara</li> <li>– Vlerësimi i rëndësisë për cilësinë e karburanteve</li> </ul>	Të gjitha zonat	<p>ministria përgjegjëse e energjisë dhe industrisë</p> <p>Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial</p>	2019-2024

#### 4.1.3 Reduktimi i shkarkimeve nga zhvillimi urban dhe ndërtimi

Aktivitetet e ndërtimit janë zhvilluar në nivele shumë të rëndësishme, në dekadën e fundit, në të gjithë Shqipërinë, dhe veçanërisht në qytetet e mëdha. Përfitimet nga ky zhvillim janë shumë të rëndësishme, por niveli i shqetësimit të vazhdueshëm të publikut në lidhje me problemet e cilësisë së ajrit me këtë sektor, nuk mund të injorohet. Sektori i ndërtimit vazhdon të jetë një burim i madh i ndotjes së ajrit, siç janë ndërtimet shumë dinamike dhe aktivitetet e ndërtimit në Tiranë dhe në bashkitë e tjera kryesore të Shqipërisë, duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në përqendrimet të larta të PM-së në qytetet e mëdha.

Nuk ka dyshim se industria e ndërtimit kontribuon me shkarkime të larta të PM-së dhe, në qoftë se shkarkimet nuk ulen, rizevullimi i grimcave të ngurta të imta mund të kontribuojë në përqendrimet të larta të niveleve të matura të PM<sub>10</sub>-s dhe PM<sub>2.5</sub>.

Në të gjitha bashkitë e mëdha të Shqipërisë duhet të ketë një konsistencë nëpërmjet:

- Kërkesave për zhvilluesit që të hartojnë një plan të dokumentuar, për të reduktuar pluhurin dhe shkarkimet në ajër, gjatë ndërtimit dhe gjatë shkatërrimeve
- Ndikimit në dhënien e punëve publike, kompanive që përdorin mënyra/mjete miqësore me mjedisin.

Shkarkimet nga industria e ndërtimit janë një kërcënim për cilësinë e ajrit në Zonat A dhe B. Strategjitë specifike në linjë me këto shkarkime, janë të përfshira në këtë plan, si masa prioritare me kohë të caktuar zbatimi.

Një çështje dytësore në lidhje me ndërtimin e ndërtesave të reja dhe rinovimin e ndërtesave të vjetra, është dhe futja e një sistemi efektiv izolimi, i cili në shkallë të parë do të rezultojë në një reduktim të përdorimit të energjisë, veçanërisht për ngrohjen dhe ujin e nxehtë, dhe si pasojë kjo do të shoqërohet me uljen e shkarkimeve ndotëse në ajër. Sigurimi I materialeve promovuese, këshilla ve, stimujve dhe granteve, do të ndihmojë në këtë proces.

Nxjtja e përdorimit të burimeve të qëndrueshme, të ripërtëritshme të energjisë {turbinat me erë, panelet diellore, sistemet e energjisë gjeotermale, për të gjitha ndërtesat e reja dhe të rinovuara, private dhe publike (shtëpi, apartamente, hotele, spitale, zyra, shkolla etj.)}.

Promovimi dhe dhënia e granteve, konsiderohet e nevojshme, për përdorimi e instalimeve më efikase dhe më eficiente të shtëpisë, zyrës, hotelit etj., siç janë sobat me djegie me energji më të efektshme, djegia e vajit dhe gazit, ngrohje të ujit me panele dhe rrethorë të përshtatshëm të lidhur me kursimet e energjisë.

Tabela 11: Masat për reduktimin e shkarkimeve nga zhvillimi urban dhe ndërtimi

Masat	Veprimet	Territori i aplikimit	Autoritetet kompetente	Data e zbatimit
Përmirësimi i planifikimit urban.	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Inkurajimi për zhvillimin e rezidencave publike dhe private afër rrugëve të transportit publik, për të reduktuar varësinë nga makinat private për të shkuar dhe ardhur nga puna.</li> <li>o Inkurajimi i veprimtarive ekonomike 'home-based', ku për shkak të natyrës dhe shkallës së tyre, ato mund të vendosen lehtësisht, pa dëmtuar zonat e banuara.</li> <li>o Inkurajimi i zhvendosjes së godinave të bizneseve që janë në zonat e banuara dhe që seriozisht pengojnë arritjen e objektivave të cilësisë së ajrit në këto zona banimi.</li> </ul>	Zonat A dhe B	MIE, si ministria përgjegjëse e transportit dhe infrastrukturës bashkitë	Nga viti 2023
Kërkesat për zhvilluesit që të hartojnë një plan të dokumentuar për të reduktuar pluhurin dhe shkarkimet në ajër, gjatë ndërtimit dhe rrënitit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Shqyrtimi i të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimet e reja të mëdha, për të siguruar që çdo shkarkim në atmosferë nga zhvillimi, nuk rezulton me ndryshimin e cilësisë së ajrit, si dhe nuk tejkalon vlerat e synuara të përcaktuara në planin e menaxhimit.</li> <li>o Te kërkohet që propozimet e planifikimit, për</li> </ul>	Zonat A dhe B	mie, si ministria përgjegjëse e transportit dhe infrastrukturës bashkitë Mb/IKMT	Pas vitit 2022



	<p>zhvillimin e vendeve periferike, apo fushave të gjelbërta, që kërkojnë një deklaratë të ndikimit në mjedis, të adresojnë ndikimin lokal të ndryshimeve, të fluksit të trafikut, në cilësinë e ajrit.</p> <p>o Te kërkohej që informacioni i përshtatshëm mbi ndikimin në cilësinë e ajrit, të zhvillimeve të reja, të paraqitet si pjesë e procedurës së vlerësimit të mjedisit, sipas dispozitave të legjislacionit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe në përputhje me procedurat e lejeve të ndërtimit.</p> <p>o Marrja e masave që konsiderohen të përshtatshme, për të parandaluar një shqetësim të krijuar nga shkarkimet e pluhurit, që ndodhin gjatë aktiviteteve të ndërtimit / apo prishjeve në zonën e tyre funksionale.</p>			
Ndikimi në dhënie e punëve publike, kompanive që përdorin menyra/mjete ekologjikisht miqësore.	Te kërkohej, kur është e nevojshme, që një plan i dokumentuar është dorëzuar, duke treguar masat për parandalimin dhe reduktimin e shkarkimeve paraprake të pluhurit dhe grimcave në ajër, për kryerjen e aktiviteteve që mund të rezultojnë në bezdisje.	Të gjitha zonat	ministra e përgjegjëse infrastrukturës bashkitë	2020
Ndalimi I djegies në natyrë, në veçanti në fushat e ndërtimit të materialeve të mbetura.	Të Intensifikohet kontrolli nga sektori mbi ndalimin e djegies në natyrë të mbetjeve.	Të gjitha zonat	ministra e përgjegjëse bujqësisë ministra e përgjegjëse infrastrukturës Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave bashkitë	2022

#### 4.1.4 Reduktimi i shkarkimeve nga bujqësia

Katër aktivitetet kryesore bujqësore janë të lidhura me prodhimin e gazeve serrë. Këto përfshijnë: menaxhimin e tokës, fermentimin enterik në fermat me kafshë, menaxhimin e plehut organik dhe konsumin e karburantit fosil, për funksionimin e makinerive bujqësore.

Metani (CH<sub>4</sub>), amoniaku (NH<sub>3</sub>) dhe oksidi i azotit (N<sub>2</sub>O) janë tre gazet kryesore, që shkarkohen nga aktiviteti bujqësor. Metani prodhohet kryesisht nga fermentimi enterik dhe menaxhimi i plehut, ndërsa menaxhimi i tokës, nëpërmjet proceseve të tilla si plehërimi, është burimi më i madh i oksidit të azotit. Përveç metanit dhe oksidit të azotit, aktivitetet bujqësore kanë qenë të lidhura me shkarkimet e gazrave dhe ndotësve të tjerë të rrezikshëm. Këta përfshijnë: amoniakun, sulfid hidrogjenin dhe grimcat e ngurta.

Ndalimi i djegies së pakontrolluar i mbetjeve në bujqësi, duhet të jetë prioritet. Kufizimi i aktiviteteve të djegies së gjineshtrës, kashtës, drithërave dhe plastikës, në tokat bujqësore- ku ka të ngjarë të kemi shqetësime- është gjithashtu një prioritet.

Masat për kontrollin e amoniakut nga burimet bujqësore janë të lidhura me zbatimin e Kodit (manualit) të praktikave të mira bujqësore, duke kufizuar përdorimin e plehrave karbonate të amonit dhe aplikimi i teknikave me pleh të lëngët me shkarkime të ulëta.

Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e Kodit të praktikave të mira bujqësore, i fokusuar veçanërisht në Shqipëri, do të përfshijë dispozita për: menaxhimin e azotit, duke marrë parasysh të gjithë ciklin e azotit; strategjitë e të ushqyerit të blegtorisë; teknika të përhapjes së plehut me shkarkime të ulëta; sisteme të ruajtjes së plehut me shkarkime të ulëta; sisteme të strehimit të kafshëve me shkarkime të ulëta; dhe mundësive për kufizimin e shkarkimeve të amoniakut nga përdorimi i plehrave minerale.

#### 4.1.5 “Reduktimi i shkarkimeve dhe menaxhimi i plehut në fermat blegtorale”.

Masat për reduktimin e shkarkimeve nga blegtoria në lidhje me praktikën e mira të kompostimit të plehut organik dhe ndalimin e evaporizimit të amoniakut në atmosferë, me përmbajtje si më poshtë:



1. Masat parandaluese për mbrojtjen e mjedisit përfshijnë:

a) sigurimi i largimit, të përpunimit, të trajtimit dhe të përdorimit të përshtatshëm të mbetjeve të lëngshme dhe të ngurta.

b) sigurimin e depozitimit të përshtatshëm të mbetjeve të lëngshme dhe të ngurta.

c) trajtimin higjienik të jashtëqitjeve dhe mbetjeve të lëngshme.

c) pakësimin e rreziqeve të infeksionit duke përcaktuar kushte sanitaro-veterinare të përshtatshme në stalla dhe mjedise si mikroklimë, ulje e nivelit të amoniakut, depozitim mbetjesh dhe jashtëqitjesh, pastrim dhe dezinfektim.

d) parandalimin e ndotjes së ujrave nga shkaktarët biologjike.

Dh) masa të tjera sipas përcaktimit të legjislacionit mjedisor në fuqi.

2. Masat parandaluese të përcaktuara në pikën 1 më sipër, merren nga personat juridike dhe fizikë që ushtrojnë veprimtaritë:

a) mbarshkrimin e kafshëve.

b) përdorim, transport, tregtim kafshësh.

#### 4.1.6 Reduktimi i shkarkimeve nga djegia e druve të zjarrit

Shumica e konsumatorëve të druve të zjarrit nuk dinë ose nuk janë të interesuar të njihen, se si të përfitojnë në mënyrë efikase, nga përdorimi i druve të zjarrit, ose nuk e konsiderojnë atë një fushë prioritare. Disa nuk kanë pajisjet e nevojshme (p.sh. soba efikase, vende të përshtatshme për ruajtjen e druve të zjarrit etj.), ndërsa të tjerët nuk kanë njohuritë e duhura për këtë çështje. Përmirësimi i efikasitetit të energjisë që rrjedhë nga drutë e zjarrit, është I rëndësishëm. Për këtë arsye, një fushatë ndërgjegjësimi publik është propozuar së bashku me disa projekte pilot, demonstruese të praktikës së mirë. Për familjet që përdorin dru zjarri, veçanërisht për ngrohjen dhe prodhimin e ujit të ngrohtë, si dhe me ndërtimin e ndërtesave të reja dhe rinovimin e ndërtesave të vjetra, është e nevojshme të futet një sistem më efektiv i izolimit, i cili në shkallë të parë do të rezultojë në një reduktim të përdorimit të energjisë, sidomos për ngrohjen dhe ujin e nxehtë, dhe si pasojë zvogëlon shkarkimet ndotëse të lidhura me ajrin. Është e domosdoshme që ministria përkatëse të sigurojë materiale promocionale, këshilla, stimuj dhe grante, të cilat të jenë të zbatueshme. Përveç kësaj, në bashkëpunim me industrinë e ndërtimit është e nevojshme të nxitet përdorimi i burimeve të qëndrueshme, të ripërtëritshme të energjisë {turbinat me erë, panelet diellore, sistemet e energjisë gjeotermale, për të gjitha ndërtesat e reja dhe të rinovuara, private dhe publike (shtëpi, apartamente, hotele, spitalet, zyra, shkollat etj.)} Përsëri, është e domosdoshme që ministria përkatëse të sigurojë materiale promovuese, këshilla, stimuj dhe grante, të cilat të jenë të zbatueshme.

Në konsultim me industrinë e ndërtimit dhe Ministrinë përgjegjëse për Energjinë, duhet të ketë një promovim pro-aktiv të përfitimeve, si dhe aplikimin e ndihmës për grante, sikurse konsiderohet e nevojshme për të nxitur instalime shtëpiake më efikase dhe më eficiente, të tilla si: soba me djegie më efikase të drurit, soba të naftës dhe gazit, ngrohës të ujit (nxehësit e zhytjes), si dhe aparatura më efikase për kursimin e energjisë (makinalarëse, lavastovilje, frigoriferë, televizorë, soba, llamba etj.)

Tabela 12: Masat për reduktimin e shkarkimeve nga bujqësia

Masat	Veprimet	Territori i aplikimit	Autoritetet kompetente	Data e zbatimit
Ndalimi i djegies në natyrë i materialeve të mbetura.	Te Intensifikohet kontrolli mbi ndalimin e djegies në natyrë të mbetjeve.	Të gjitha zonat	ministra përgjegjëse e bujqësisë ministra përgjegjëse e transportit dhe infrastrukturës Inspektorati Shtetëror I Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave	2022
Kufizimi i aktiviteteteve të	o Të kërkohet, kur është e nevojshme që një plan për qëllimin e kryerjes së djegies në natyrë në tokat	Të gjitha zonat	ministra përgjegjëse e	2022-2023



djegies së gjineshrës, kashtës dhe drithërave në tokat bujqësore, ku ka të ngjarë të kemi shqetësime.	bujqësore është paraqitur paraprakisht në seksionin e mjedisit, për djegjen e gjineshrës, kashtës dhe drithërave të tjera për të parandaluar tymin e gjeneruar nga këto aktivitete, duke krijuar një shqetësim të komunitetit lokal, ose një rrezik për përdoruesit e rrugës. Duhet të jepen madhësia e zonës për t'u djegur, masa për të kontrolluar djegjen dhe masat e sigurisë nga zjarri, si dhe orari i propozuar për djegjen. o Të kërkohet që pas përfundimit të djegies së kashtës dhe drithërave, hiri i mbetur duhet të futet në tokë, për të parandaluar një shqetësim lokal nga pluhuri. o Të promovohet realizimi i instalimeve për rikuperimin dhe ripërdorimin e biogazit nga fermat blegtorale.		bujqësisë bashkitë	
Realizimi i instalimeve për rikuperimin dhe ripërdorimin e biogazit nga bagëtitë.	o Të sigurojë stimuj për fermerët që realizojnë instalime për ripërdorimin e biogazit nga bagëtitë.	Të gjitha zonat	ministra përgjegjëse e bujqësisë ministra përgjegjëse e financës	2023
Vendosja/Ngritja e Kodit të praktikave të mira bujqësore.	o Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e Kodit të praktikave të mira bujqësore. o Trajnimin e fermerëve në zbatim të Kodit të praktikave të mira bujqësore.		ministra përgjegjëse e bujqësisë	2023
Reduktimi i emetimeve nga drutë e zjarrit.	o Fushatë për ndërgjegjësimin e publikut me disa projekte pilot, për zbatimin e praktikave më të mira.	Të gjitha zonat	ministra përgjegjëse e mjedisit ministra përgjegjëse e energjisë	2020

#### 4.1.7 Reduktimi i shkarkimeve nga burimet difuze industriale

Masat e reduktimit zbatohen për pajisje shumë të vogla të trajtuara si individuale, në mënyrë tipike për instalimet me leje të tipit B dhe C, duke përfshirë: objekte të vogla industriale dhe aktivitete tregtare; prodhimin e tullave, prodhimin e çimentos, prodhimin e betonit, fonderitë me ngjyra, ushqim, pije dhe prodhuesit e duhanit, galvanizimin (veshje e objekteve metalike me zink), fonderitë me ngjyra, fabrikat e prodhimit të bitumit, guroret, lëndët e drurit dhe objektet/pajisjet e përpunimit të drurit.

Tabela 13: Masat për reduktimin e shkarkimeve nga burimet difuze industriale

Masat	Veprimet	Territori i aplikimit	Autoritetet kompetente	Data e zbatimit
Promovimin e përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme me qëllim përmbyshjen e kërkesave të energjisë për ngrohje, ajër të kondicionuar, ndriçim dhe prodhimin e ujit të nxehtë.	- Promovimi i iniciativave për përdorimin e instalimeve të koogjenerimit (në veçanti në objektet publike dhe zonave të reja të zhvillimit të ndërtimit). - Nxitja për eksperimentimin dhe përdorimin e sistemeve fotokatalitike për pakësim të ndotësve.	Të gjitha zonat	ministra përgjegjëse e mjedisit ministra përgjegjëse e infrastrukturës dhe energjisë	2019-2022
Përgatitja e një fushate për matjet, me pajisje portative të monitorimit për vlerësimin e shkarkimeve.	Futja e kontrolleve të rregullta dhe periodike të gazrave nga të gjithë fabrikat.	Të gjitha zonat	ministra përgjegjëse e mjedisit ministra përgjegjëse e infrastrukturës	Pas vitit 2022



			dhe energjisë	
Përgatitja e një inventari për të gjitha ndërmarjet e vogla dhe të mesme të regjistruara.	- Futja e legjislacionit për të kërkuar nga të gjitha ndërmarrjet tregtare të vogla dhe të mesme që të raportojnë për përdorimin e tyre të energjisë dhe llojin e lëndës djegëse që përdoret për të bërë të mundur kryerjen e një vlerësimi për shkarkimet ndotëse.	Të gjitha zonat	ministra përgjegjëse e mjedisit ministra përgjegjëse e energjisë dhe industrisë	Pas vitit 2022

#### 4.2 Reduktimi i shkarkimeve nga burimet pikësore

Për qëllim të këtij plani, burime pikësore të ndotjes janë të gjitha ato burime që janë të mundura dhe të dobishme të merren në konsideratë në mënyrë individuale, të lokalizuara me anë të koordinatave gjeografike dhe parametrave të shkarkimeve të oxhaqeve, dhe të përcaktuara si shkarkime me më shumë se 90 -100 t / vit, ose me gjenerime të fuqisë së ngrohjes së barabartë me 50 MË, për proceset e djegies.

Është e nevojshme përshtatja e masave që synojnë reduktimin maksimal të mundshëm të ndotësve, nga aplikimi i teknologjive më të mira në dispozicion dhe / ose kërkesat e duhura / kufizimet që verifikojnë paraprakisht se shkarkimet e reja nuk kontribuojnë në rritje të ndjeshme në nivelet e përqendrimit të përgjithshëm të territorit.

Tabela 14: Masat për reduktimin e shkarkimeve nga burimet pikësore

Masat	Veprimet	Territori i aplikimit	Autoritetet kompetente	Data e zbatimit
Vendosja e lartësisë minimale nga toka për oxhaqet dhe shtëllungat në të gjitha instalimet me leje të tipit A.	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Përcaktimi i teknikave më të mira të mundshme TMM (TMM) për kategoritë e aktiviteteve të tipit A, ose për një instalim të veçantë.</li> <li>o Përcaktimi dhe zbatimi i një programi vjetor të kontrollit të shkarkimeve nga impiantet industriale subjekt të lejes së tipit A.</li> <li>o Verifikimi dhe kontrolli i të gjitha instalimeve industriale të tipit A.</li> </ul>	Të gjitha zonat	ministra përgjegjëse e mjedisit Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave	2019-2022
Rishikimi i kushteve të lejes për instalimet ekzistuese të tipit A ose B.	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Verifikimi nëse të gjithë operatorët e një instalimi ekzistues të tipit A ose B, kanë dorëzuar kërkesën për rishikimin e kushteve të licencës ekzistuese në AKM-ë përmes QKB-së.</li> <li>o Rishikimi e kushteve për të gjitha lejet e Tipit A dhe B.</li> </ul>		ministra përgjegjëse e mjedisit dhe institucionet e saj të varësisë	2020-2022
Ndihmesa e biznesit (a) për të minimizuar ndikimin negativ në mjedis nga operacionet e tyre që shkaktojnë ndotje në ajër, ujë ose tokë); (b) për të qenë në përputhje me ligjet e aplikueshme, rregulloret dhe kërkesat e tjera të orientuara për mjedisin, dhe (c) për t'u përmirësuar vazhdimisht sa më sipër.	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Promovimi për pajisjen me certifikatën e cilësisë së mjedisit ISO 1400 midis komunitetit të biznesit.</li> <li>o Iniciativa për zbatimin e të gjitha zgjidhjeve të mundshme për të reduktuar shkarkimet nga oxhaqet.</li> </ul>	Të gjitha zonat	ministra përgjegjëse e energjisë dhe industrisë ministra përgjegjëse e mjedisit ministra përgjegjëse e financës	2020-2025



### 4.3 Forcimi i inspektimit dhe kapaciteteve monitoruese

Ka pasur pak progres në monitorimin e cilësisë së ajrit në të gjithë vendin, vitet e fundit. Përdorimi i rrjetit të monitorimit të ajrit dhe futja e mënyrave më të sofistikuara të monitorimit për një gamë të gjerë të ndotësve, ka përmirësuar njohuritë e cilësisë së ajrit. Megjithatë mbetet shumë punë për t'u bërë. Natyra dhe shtrirja e programit të monitorimit është shkurtuar kryesisht, nga mungesa e burimeve adekuate.

Sistemet e monitorimit të ajrit të ambientit përbëjnë një shtyllë të programit të menaxhimit të cilësisë së ajrit të vendit. Monitorimi i ajrit të ambientit, do të përdoret për një shumëllojshmëri të gjerë të qëllimeve në menaxhimin e cilësisë së ajrit. Menaxhimi i cilësisë së ajrit përfshin një cikël në vendosjen e standardeve dhe objektivave, hartimin dhe zbatimin e strategjive të kontrollit, duke vlerësuar rezultatet e këtyre strategjive të kontrollit dhe matjen e progresit.

Të dhënat e monitorimit të mjedisit kanë shumë përdorime në të gjithë këtë proces, siç është përcaktimi i përputhshmërisë me standardet e cilësisë së ajrit të mjedisit; karakterizojnë cilësinë e ajrit dhe tendencat; vlerësimi i rreziqeve shëndetësore dhe ndikimet e ekosistemit; zhvillimi dhe vlerësimi i strategjive të kontrollit të shkarkimeve; vlerësimi i marrëdhënieve burim-receptor; sigurimi i të dhënave për kontributin në drejtimin dhe vlerësimin e modeleve; matja e progresit të përgjithshëm të programeve të kontrollit të ndotjes së ajrit. Të dhënat e monitorimit të ajrit të ambientit sigurojnë llogaridhënien për progresin e strategjisë së shkarkimeve, nëpërmjet ndjekjes së trendeve afatgjata të ndotësve. Të dhënat gjithashtu, formojnë bazën për parashikimin e cilësisë së ajrit dhe raporte të tjera të cilësisë së ajrit për publikun. Ato gjithashtu, mund të sigurojnë informacion të vlefshëm për ndikimet më të gjera të ekosistemit.

Një element kyç i këtij plani kombëtar është të sigurojë që sistemet e monitorimit të ajrit të mjedisit të bëhen një pjesë e rëndësishme e programit të menaxhimit të cilësisë së ajrit të vendit.

Duke pasur parasysh këtë sfond, objektivat e Qeverisë shqiptare për monitorim të ajrit janë:

1. Të sigurojë që rrjetet ekzistuese të monitorimit të jenë të rikonfiguruar, për të qenë në përputhje me nevojat themelore mjedisore dhe programatike, për menaxhimin e tanishëm të mjedisit;
2. Të kërkojë mënyra për të integruar rrjetet e ndryshme monitoruese ku ekzistojnë mundësi për integrim, dhe të rrisin mbikëqyrjen nga AKM-ja të këtyre rrjeteve;
3. Të përmirësojë kompetencën shkencore dhe teknike të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për të siguruar të dhëna të cilësisë së lartë;
4. Të zgjerojë ruajtjen e të dhënave, shpërndarjen, dhe analizën, në mënyrë që agjencitë qeveritare, studiuesit dhe publiku i gjerë të kenë një qasje të përmirësuar në të dhënat e monitorimit të mjedisit, si në aspektin e plotësisë dhe afatet kohore.

Objektivi i menjëhershëm i këtij plani është:

- Sigurimi i cilësisë më të mirë dhe me më shumë të dhëna përfaqësuese në cilësinë e ajrit, me modernizimin dhe përmirësimin e rrjeteve të monitorimit;
- Zbatimi i Sistemit të Monitorimit të shkarkimeve industriale, me qëllim përditësimin e vazhdueshëm të RTSHN-së dhe kadastrës kombëtare të shkarkimeve;
- Përpilimi i Inventarit Kombëtar të Shkarkimeve, sipas Konventës LRTAP, me qëllim përcaktimin e taveve kombëtare të shkarkimeve për disa ndotës atmosferikë, që rrjedhin nga të gjitha burimet e ndotësve, që rezultojnë nga aktivitetet e njeriut, në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Forcimi i kapaciteteve në Inspektoratin Shtetëror, për të kryer matjen e shkarkimeve nga burimet e palëvizshme, si dhe forcimin e organizatave që veprojnë në këtë fushë.



Tabela 15: Masat për forcimin e inspektimit dhe kapaciteteve monitoruese

Masat	Veprimet	Territori i aplikimit	Autoritetet kompetente	Data e zbatimit
Modernizimi dhe përmirësimi i rrjetit të monitorimit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Rritja e numrit të stacioneve të monitorimit automatik me të paktën blerjen e 10 stacioneve të reja, gjetjen e pajisjeve për vendet e reja, pikat e nxehta që nuk monitorohen aktualisht.</li> <li>○ Rishikimi dhe përshtatja e rrjetit të monitorimit të tanishëm.</li> <li>○ Zbatimi i procedurave të kalibrimit me furnizimin e një kalibratori portativ (tub depërtimi dhe hollimi).</li> <li>○ Ofrimi i kurseve të trajnimit teknik, për të përmirësuar kalibrimin dhe mirëmbajtjen për stafin e AKM-së.</li> <li>○ Ofrimi i trajnimeve për stafin e AKM-së në analizimin, raportimin dhe prezantimin e të dhënave.</li> <li>○ Shqyrtimi dhe rregullimi I klasifikimit të zonave kritike të territorit në baza vjetore.</li> <li>○ Përgatitja dhe publikimi i parashikimeve afatshkurtra (24-48 orë) të përqendrimeve të ndotësve kryesorë, përmes modeleve të simulimit.</li> </ul>	Zonat A dhe B	ministra përgjegjëse e mjedisit Agjencia Kombëtare e Mjedisit	2021- 2026
Krijimi i Sistemit të Inventarit Kombëtar të Shkarkimeve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Përcaktimi i procesit të përgatitjes së inventarit; baza për vlerësimin e shkarkimeve; mbledhja e të dhënave; përgatitja e të dhënave dhe llogaritjen e shkarkimeve; raportimi dhe arkivimi.</li> <li>○ Vendosja e taveve të shkarkimeve për sektorët qendrorë (të energjisë, industrisë, transportit, bujqësisë dhe strehimit) për ndotësit e mëposhtëm: (SO<sub>2</sub>), oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>), komponimet organike të avullueshme (VOC) dhe amoniakut (NH<sub>3</sub>).</li> <li>○ Krijimi i kapaciteteve për raportim të rregullt të shkarkimeve hapësinore, siç kërkohet, sipas Udhëzimit të Raportimit të Emetimeve për Palët në Konventën LRTAP.</li> </ul>	Të gjitha zonat	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	2021- 2023
	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Hartimi i programeve për reduktimin progresiv të shkarkimeve të ndotësve kombëtare.</li> </ul>	Të gjitha zonat	ministra përgjegjëse e mjedisit	Pas vitit 2022
Sigurimi që inspektimi dhe zbatimi i legjislacionit, që lidhet me cilësinë e ajrit, është proporcional dhe efikas.	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Intensifikimi i forcimit të inspektimeve periodike të tymit të të gjitha sistemeve të ngrohjes civile (sistemet e ngrohjes, tubat dhe oxhaqet etj.).</li> <li>○ Sigurimi i inspektorëve me pajisjet matëse portative.</li> </ul>	Zonat A dhe B	ministra përgjegjëse e mjedisit Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave	2019- 2024





#### 4.4 Përmirësimi i ndërgjegjësimit të publikut

Disa aktivitete edukative për të shpërndarë informacion mbi cilësinë e ajrit, janë zbatuar në të kaluarën, megjithatë ato janë me fushë të kufizuar.

Arsimi publik dhe programet e ndërgjegjësimit janë të rëndësishme në informimin e publikut për përgjegjësitë e tyre për një ajër më të pastër, dhe përpjekjet e bëra në komunitetin e tyre për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Është politika e qeverisë qendrore dhe lokale, së bashku me organizata të tjera qeveritare, akademike, organizatat private dhe vullnetare, që promovojnë programe arsimore për çështjet që lidhen me kontrollin dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër, për të përmirësuar cilësinë e ajrit.

Për këtë qëllim, mbështetja e vazhdueshme duhet të sigurohet për trajnime, aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe nismave për mbrojtjen e mjedisit.

Iniciativa të reja arsimore dhe trajnime duhet të lançohen, me qëllim që të përdoren teknika arsimore dhe teknologji informative më të fundit, për të shpërndarë informacion mbi ndotjen e ajrit.

Ndër prioritetet është zhvillimi i një fushate për informimin e publik, mbi rreziqet shëndetësore dhe mjedisore, që lidhen me djegjen e mbeturinave. Djegia e pakontrolluar e mbeturinave shtëpiake përbën një burim të rëndësishëm të të gjitha shkarkimeve të dyoksinave. Ky problem vazhdon të rritet, për shkak se pjesa më e varfër e popullsisë beson se djegia në oborrin e shtëpisë është një metodë e pranueshme e arsimimit të mbetjeve.

Tabela 16: Masat për përmirësimin e ndërgjegjësimit të publikut

Masat	Veprimet	Territori i aplikimit	Autoritetet kompetente	Data e zbatimit
Promovimi i programeve arsimore mbi çështjet që lidhen me kontrollin dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër për të përmirësuar cilësinë e ajrit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Ndërmarrja e programeve promovuese dhe edukative që synojnë individët dhe shkollat. Rolet e tyre në ndihmën për të përmirësuar cilësinë e ajrit të ambientit brenda fushës së Planit, do të theksohen përmes përdorimit të fletushkave informative dhe emisioneve në radio dhe televizion. Çështje të cilat do të mbulojnë në programe të tilla, do të përfshijnë ndryshimin nga lëndë djegëse të ngurta- në lëndë djegëse të pastra, që shkaktojnë ndotje të ulët, ruajtjen e energjisë në shtëpi, përdorimin e metodave alternative të transportit në vend të makinave private, fushata për të nxitur ruajtjen më të mirë të makinave dhe miratimin e teknikave më të mira lëvizëse, për të reduktuar shkarkimet e automjeteve.</li> <li>○ Publikimi i të dhënave të monitorimit të ndotjes së ajrit nga rrjetet e tyre respektive, për të qenë në dispozicion të publikut të gjerë, përmes mediave dhe internetit. Në rast të cilësisë së dobët të ajrit të rajonit, informacioni do të jetë në dispozicion si lajm i rregullt, i përditësuar, në shërbimet e radiove lokale.</li> <li>○ Promovimi i fushatave lokale në zonat e banuara për të reduktuar varësinë nga makina, si një mjet për të udhëtuar për në shkollë, dhe për të inkurajuar çiklizmin dhe ecjen, si mënyra alternative të transportit.</li> <li>○ Inkurajimi dhe promovimi i iniciativave lokale dhe partneriteteve për të përmirësuar cilësinë e ajrit në komunën e tyre.</li> </ul>	Të gjitha zonat	ministria përgjegjëse e mjedisit ministria përgjegjëse e arsimit bashkitë	Nga 2022-2025
Lançimi i një fushate të informimit të publikut mbi rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Ndërmarrja e programeve promovuese dhe edukative që synojnë paralajmërimin individual, që djegia e mbeturinave sjellë implikime serioze të</li> </ul>	Të gjitha zonat	ministria përgjegjëse e bujqësisë	2023-2025



shëndetësore dhe mjedisore që lidhen me djegien në oborrin e shtëpisë.	shëndetit të publikut, për shkak të çlirimit të toksinave.		ministra përgjegjëse e arsimit	
Vlerësimi i efekteve në shëndet dhe në mjedis nga ndotja e ajrit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Kryerja e vlerësimit të efekteve shëndetësore nga ndotja e ajrit</li> <li>○ Kryerja e vlerësimit të efekteve mjedisore nga ndotja e ajrit</li> </ul>	Zona A	ministra përgjegjëse e shëndetësisë ministra përgjegjëse e mjedisit	2022

#### 4.5 Vlerësimi i masave të propozuara për cilësinë e ajrit

Tabela e mëposhtme u jep një prioritet masave të propozuara, për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe një vlerësim të efektivitetit të tyre, bazuar në provat e identifikuara në një shqyrtim të literaturës.

Tabela 17: Prioriteti dhe vlerësimi i masave të propozuara

Masat	Prioriteti	Komente
Menaxhimi dhe kontrolli i rrjedhës së trafikut, në mënyrë që të shmanget bllokimi i automjeteve dhe qëndrimi i zgjatur në kryqëzimet e rrugëve dhe në zonat urbane, duke përmirësuar cilësinë e ajrit në këto vende.	I lartë	Është shumë efektive si në reduktimin direkt të problemit ose në mënjanimin e burimit të ndotjes së ajrit, sidomos në zonën A dhe B. Megjithatë, ato mund të kenë kosto të lartë për t'u zbatuar politikisht dhe jopopullore, në qoftë se nuk trajtohen me ndjeshmërinë e duhur.
Inkurajimi i kalimit nga përdorimi i automjeteve private drejt llojeve të tjera të udhëtimit dhe nxitjen e përdorimit të transportit publik, për të reduktuar shkarkimet e automjeteve dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit.	I lartë	Është shumë efektive si në reduktimin direkt të problemit, ose në mënjanimin e burimit të ndotjes së ajrit. Megjithatë, ato mund të kenë kosto të lartë për t'u zbatuar politikisht dhe jopopullore, në qoftë se nuk trajtohen me ndjeshmërinë e duhur.
Rregullimi dhe kufizimi i shkarkimeve nga të gjitha mjetet motorike.	I mesëm	Kjo sigurohet duke përshpejtuar futjen e klasës Euro 6 për automjete të lehta (makina dhe furgona) dhe klasën Euro VI për automjete të rënda (kamionë, trajnerë dhe autobusë), në zonat më të prekura nga ndotja e ajrit
Promovimi i përdorimit të automjeteve me ndikim të ulët	I mesëm	Gjeneron shkarkime të rëndësishme dhe përfitimet e cilësisë së ajrit, nëse prurjet e tyre rriten ndjeshëm, dhe mund të japin përfitime më të gjera ekonomike, përmes zhvillimit, prodhimit dhe shërbimit të teknologjive të reja të automjeteve, megjithatë, ato nuk janë gjithmonë aq efektive sa pritet, për shkak të hyrjes së ulët, mund të jetë e kushtueshme, dhe nuk ofrojnë përfitime lokale, të tilla si reduktimi i kongestionit ose nivelet në rritje të aktivitetit fizik.
Kontrolli dhe reduktimi i shkarkimeve nga automjetet e shërbimit publik.	I mesëm	Objektivi është krijimi i flotës së gjelbër të taksive, veçanërisht për operim në zonat e nxehta, në të cilat ndotja vjen duke u rritur, si dhe futja e mjeteve motorike hibride. Për autobusët në veçanti, motorët hibridë, duhet të jenë optimizuar për NOX dhe CO2 për ciklin urban.
Hartimi i një strategjie afatshkurtër të menaxhimit për automjetet komerciale.	I ulët	Përdorimi i mekanizmave të çmimeve që ndikojnë në zgjedhjen e blerjes së automjeteve dhe përdorimin e tyre, është konsideruar si një masë me kosto shumë efektive, pasi ato përdorin një sistem ekzistues tatarimor për tatimin e automjeteve dhe taksa e karburantit. Zhvendosja e tatimeve në favor të automjeteve me shkarkim të ulët të NOX, veçanërisht për kompanitë e shitjes së automjeteve, të cilat përfaqësojnë mbi 50% të të gjitha shitjeve të automjeteve të reja, do të duket një masë me kosto shumë efektive.
Kufizimi dhe zvogëlimi i nivelit të parkimit në rrugë dhe jashtë rrugës, parashikuar në qendrën urbane, për të reduktuar volumet e	I mesëm	Është shumë efektive në reduktimin direkt të burimit të ndotjes së ajrit. Megjithatë, ajo mund të jetë politikisht jopopullore për t'u zbatuar.



trafikut dhe shkarkimet e automjeteve.		
Ndërtimi i hapësirave me gjelbërim të përhershëm përgjatë rrugëve kryesore të trafikut.	I ulët	Është shumë efektive dhe me kosto të lartë për t'u zbatuar.
Përmirësimi i planifikimit urban.	I ulët	Gjeneron përfitime të cilësisë së ajrit, në qoftë se marrja e djeshme e tyre, mund të japë përfitime më të gjera ekonomike, përmes përmirësimit të standardeve të jetesës së qytetarëve, sidomos të atyre që jetojnë në zona A dhe B.
Ndalimi I djegies në natyrë, në veçanti në fushat e ndërtimit të materialeve të mbetura/mbetjeve.	I lartë	Është shumë efektive në reduktimin direkt të burimit të ndotjes së ajrit. Ka kosto të kufizuara të zbatimit.
Ndalimi I djegies në natyrë të materialeve të mbetura/mbetjeve	I lartë	Mund të jetë shumë efektive në reduktimin direkt të burimit të ndotjes së ajrit. Ka kosto të kufizuara të zbatimit.
Kufizimi I aktiviteteve të djegies së gjineshtrës, kashtës dhe drithërave në tokat bujqësore, ku mund të kemi shqetësime.	I lartë	Është shumë efektive në reduktimin direkt të burimit të ndotjes së ajrit. Ka kosto të kufizuara të zbatimit.
Realizimi i instalimeve për rikuperimin dhe ripërdorimin e biogazit nga bagëtitë.	I ulët	Gjeneron përfitime të rëndësishme të shkarkimeve dhe të cilësisë së ajrit. Megjithatë, mund të jenë të shtrenjta për t'u zbatuar dhe politikisht jopopullore, në qoftë se nuk trajtohen me ndjeshmërinë e duhur.
Vendosja e Kodit të praktikave më të mira bujqësore.	I mesëm	Është një nga detyrimet e Direktivës për Nitratet, të cilat janë shumë efektive në kontributin për të zvogëluar burimin e ndotjes së ajrit, duke përmirësuar praktikat bujqësore.
Promovimin e përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme, me qëllim përbushjen e kërkesave të energjisë për ngrohje, ajër të kondicionuar, ndriçim dhe prodhimin të ujit të nxehtë.	I mesëm	Gjenerojnë përfitime të rëndësishme të shkarkimeve dhe të cilësisë së ajrit dhe japin përfitime më të gjera ekonomike përmes zhvillimit, prodhimit dhe shërbimit e teknologjive të reja të prodhimit të energjisë. Megjithatë, mund të jenë mjaft të kushtueshme për t'u zbatuar dhe politikisht jopopullore, në qoftë se nuk trajtohen me ndjeshmërinë e duhur
Përgatitja e një fushate për matjet, me pajisje portative të monitorimit për vlerësimin e shkarkimeve.	I lartë	Verifikimi dhe kontrolli i shkarkimeve të të gjitha instalimeve industriale do të zvogëlojë rastet e vlerave të paautorizuara të shkarkimeve.
Vendosja e lartësisë minimale nga toka për oxhaqet dhe shtëllungat në të gjitha instalimet me leje të tipit A.	I ulët	Përmirëson shpërndarjen e ndotësve dhe si pasojë uljen e përqendrimeve në tokë. Megjithatë kjo mund të jetë e shtrenjtë për t'u zbatuar dhe për të dekurajuar bizneset.
Rishikimi i kushteve të lejes Class A ose B për instalimet ekzistuese.	I lartë	Lëshimi i lejeve të klasës A dhe B që synojnë reduktimin maksimal të mundshëm të ndotësve nga aplikimi i teknologjive më të mira në dispozicion dhe / ose kërkesat / kufizimet e duhura, do të kontribuojë në përfitime të ndjeshme të cilësisë së ajrit. Megjithatë kjo mund të hasë kundërshtimin nga komuniteti i biznesit.
Ndihmesa e biznesit (a) për të minimizuar ndikimin negativ në mjedis nga operacionet e tyre (proceset etj.), që shkaktojnë ndotje në ajër, ujë ose tokë); (b) për të qenë në përputhje me ligjet e aplikueshme, rregulloret dhe kërkesat e tjera të orientuara për mjedisin, dhe (c) për t'u përmirësuar vazhdimisht sa më sipër.	I ulët	Promovimi i certifikatës së cilësisë së mjedisit, përmes veprimeve sensibilizuese me komunitetin e bizneseve, do të gjenerojë përfitime të rëndësishme të shkarkimeve dhe të cilësisë së ajrit. Megjithatë, ato nuk janë gjithmonë aq efektive sa pritet, për shkak të hyrjeve të ulëta.
Modernizimi dhe përmirësimi i rrjetit të monitorimit	I lartë	Do të rrisë nivelin e informacionit të njohurive bazë të cilësisë së ajrit në vend dhe ndihmon në vlerësimin e efekteve të politikave specifike mbi përqendrimit e ndotësve.
Krijimi i sistemit për Inventarin kombëtar të shkarkimeve.	I mesëm	Do të përmirësojë futjen e një sistemi të integruar të modelimit për të mbështetur vlerësimin e cilësisë së ajrit në vend.
Sigurimi sa të jetë e mundur që inspektimet që lidhen me cilësinë e ajrit të jenë	I mesëm	Do të përmirësojë kushtet e marrjes së lejeve nga ana e mbajtësit të lejes.



proporcionale dhe efikase.		
Promovimi i programeve arsimore në çështjet që lidhen me kontrollin dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër për të përmirësuar cilësinë e tij.	I mesëm	Promovimi i fushatave informuese, informimit dhe edukimit mjedisor, natyrë, burimi, përhapja e ndotësve dhe gjendja e cilësisë së ajrit të mjedisit, do të përmirësojë vetëdijen e popullatës.
Lançimi i një fushate të informimit të publikut mbi rreziqet shëndetësore dhe mjedisore që lidhen me djegien në oborrin e shtëpisë.	I lartë	Do të sjellë ndryshime të sjelljes së popullsisë dhe ndihmon në kufizimin e shkarkimeve të paautorizuara.
Fuqizimi i transportit publik	I Lartë	Mbulimi me transport publik, i të gjithë territorit, do të ulte përdorimin e automjeteve personale
Nxitja e transporteve alternativ	I mesëm	Shtimi i korsive të biçikletave, dhe dhënia prioritet e këtij transporti do të ndihmonte në uljen ndjeshëm të përdorimit të automjeteve, veçanërisht në qytet e vogla.
Planifikimi eficient i territorit	I lartë	Densifikimi i zonave dhe mosshpërhapja e ndërtimeve, në atë që quhet “Urban sprawl”, do të ishte një masë shumë efiçente, duke përqendruar ndërtimin dhe mundësuar në krijimin e sa më shumë hapësirave të gjelbra.
Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra në qytet	I Mesëm	Shtimi i parqeve brenda qytetit si dhe ripyllëzimet e hapësirave të gjelbra në periferi, do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së ajrit
Hartimi dhe zbatimi i Programeve të ndërgjegjësimit të publikut	I Mesëm	Përtej ofrimit të transporteve alternative, është e rëndësishme që qytetarët të njihen me problematikat e kësaj çështje, të kuptojnë rrezikshmërinë e saj, si dhe të kuptoj rëndësinë që ka cilësia e ajrit në jetën e tyre
Eliminimi 100% i vendeve të paligjshme aktuale të hedhjes së mbeturinave	I mesëm	Hedhja pa kriter i mbetjeve dhe djegia e tyre, janë një nga ndotësit kryesor të qyteteve tona.
Përcaktimi i zonave Industriale me teknologji të lartë	I lartë	Emetimi i gazeve të tyre është në sasi të ulët, në krahasim me zonat e tjera industriale
Punimet ndërtimore të kryhen me deklaratë paraprake punimesh dhe shfrytëzimi i lejeve zhvillimore nga autoritete të specializuara.	I lartë	Sigurohet mbrojtja e trashëgimisë mjedisore duke iu përmbajtur legjislacionit dhe kufizimeve që ai sugjeron në funksion të saj.
Përcaktimi i distancave dhe intensitetit ndërtimor sipas standardeve mjedisore.	I lartë	Kësaj rregullore i referohet edhe rregullojra e planit, gjithashtu PPV i parashikon këto parametra sipas ndikimit mjedisor.
Krijimi i një Forumi për Bashkërendimin e planifikimit në nivel qendror.	I mesëm	Forumi përbëhet nga përfaqësues të cilët trajtojnë çështje që ndikojnë direkt në planifikimin e territorit, ndër të cilat edhe mjedisi, dhe ndihmojnë në zgjidhjen e shmangien problematikave.
Hartimi i rregullave për rolin e sektorit mjedisor në territor.	I lartë	Ndihmon në përmirësimin e masave mbrojtëse në aspektin mjedisor.
Urbanizimi i kontrolluar i qendrave të banuara në harmoni me burimet natyrore, tokën, ujin dhe ajrin.	I lartë	Shmanget ndryshimi i vlerave të biodiversitetit lokal dhe efekti negativ në shëndetin e njeriut.

### 5. Kostot dhe përfitimet e zbatimit të planit

Shpenzimet e kontrollit të ndotjes së ajrit në përgjithësi, janë më të ulëta se kostot e dëmtimit të shëndetit dhe mjedisit. Në shumë vende, ndikimi neto i masave të pakësimit të ndotjes në të ardhurat kombëtare dhe në punësim do të jetë neutral, sepse prodhimi i teknologjive të kërkuara do të krijojë punësim.

Gjetjet kryesore të vlerësimit të cilësisë së ajrit dhe të analizës së shkarkimeve të paraqitura në Kapitullin 2, kanë formuar bazën për identifikimin dhe vendosjen mbi implementimin dhe zbatimin e veprimeve të nevojshme në të ardhmen.

Ato veprime, të cilat do të mundësojnë përmirësimin e cilësisë së ajrit, janë vlerësuar në aspektin e shpenzimeve. Rezultatet e kostos janë paraqitur më poshtë. Metoda e ndërmarrë me kostot dhe disa supozime të përgjithshme të ndërmarrë, janë përshkruar në seksionet e mëposhtme.

### 5.1 Kostot

Në vitet e fundit Qeveria shqiptare ka bërë disa investime në zonat që, direkt apo indirekt, kanë sjellë dhe reflektojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Ndër këto vlen të përmenden investimet e programuara për ripërtëritjen e transportit publik, urban dhe ekstraurban; ndërhyrjet për realizimin e parkingut, korsi për biçikleta etj.

Megjithatë, janë të nevojshme masat e jashtëzakonshme për zbatimin e politikave mjedisore dhe legjislacionin që synon reduktimin e shkarkimeve të ndotësve, forcimin e rrjeteve të monitorimit dhe zbatimin e veprimeve detyruese për zvogëlimin dhe kontrollin e ndotjes së ajrit.

Në tabelat e mëposhtme është paraqitur një analizë e shpenzimeve të programuara në lidhje me planin e masave dhe veprimeve për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Në secilën prej ndërhyrjeve të propozuara ndikimi mund të jetë:

- Direkte: Shpenzime që ndikojnë direkt në kushtet e cilësisë së ajrit
- Indirekte: Shpenzime që në mënyrë indirekte ndikojnë në kushtet e cilësisë së ajrit
- Potenciale: Shpenzime që mund të ndikojnë vetëm pak në kushtet e cilësisë së ajrit

Shpenzimet janë agreguar në këto fusha tematike: reduktimi i shkarkimeve difuze dhe burimeve pikësore (nga trafiku, ndërtimi dhe zhvillimin urban, bujqësia dhe instalimet industriale), forcimin e inspektimit dhe kapaciteteve monitoruese, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit dhe trajnimit.

Vlerësimi i kostove është i bazuar kryesisht në të ashtuquajturën qasje nga lart-poshtë, ku kostot e investimeve dhe kostot operative janë vlerësuar në bazë të të dhënave të agreguara, në nivel të sektorëve dhe nënsektorëve të vëzhguar. Kjo qasje është e pranueshme për analizën e përdorur, për të identifikuar shkallën e shpenzimeve, pa detajuar veprimet individuale. Disa të dhëna janë marrë direkt nga sektori privat apo qeveritë lokale, me vlerësimet e kostos, për programet që janë duke u zbatuar dhe / ose janë zbatuar.

Tabela 18: Shpenzimet në lidhje me përmirësimin e cilësisë së ajrit

Zona	Masat	Impakti/ndikimi	Kostot e vlerësuara (€)	Komentet
Reduktimi i shkarkimeve	Menaxhimi dhe kontrolli i rrjedhës së trafikut në mënyrë që të shmanget bllokimi i automjeteve dhe qëndrimi i zgjatur në kryqëzimet e rrugëve dhe në zonat urbane, duke përmirësuar cilësinë e ajrit në këto vende.	Indirekt	50,000,000	Bashkia e Tiranës ka ngritur një qendër për kontrollin e trafikut, i financuar nga një kredi e marrë nga BERZH-I. Kostoja e projektit është 8.2 milionë €. Projekte pilot mund të zbatohen në disa bashki të mëdha me një kosto totale prej rreth 50 milionë €.
	Inkurajimi i kalimit nga përdorimi i makinave private drejt llojeve të tjera të udhëtimit dhe nxitjen e përdorimit të transportit publik, për të reduktuar shkarkimet e automjeteve dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit.	Direkt	41,500,000	Qeveria mund të vendosë një skemë taks për rrugën, duke detyruar drejtuesit të reflektojnë mbi përdorimin e makinave, ku përdoruesit e shpeshtë të automjeteve do të paguajnë më shumë se përdoruesit më të rrallë. Normalisht, skemat janë përdorur për të inkurajuar shoferët të përdorin rrugët më pak të ngarkuara, apo të përdorin sa më pak kohë me makinë. Futja e një skeme të taksave është e kushtueshme kryesisht, për shkak të kostove për sigurimin e alternativave të transportit, trajnimit dhe stafit dhe shërbimeve të klientit. Sipas literaturës vlerësimet e kostos janë 41 milionë €. Megjithatë shpenzimet janë të balancuara zakonisht me të ardhurat e arkëtuara.
	Rregullimi dhe kufizimi i shkarkimeve nga të gjitha mjetet motorike.	Direkt	15,000,000	Qeveria mund të subvencionojë programe për të rritur blerjen e automjeteve me nivel të ulët të shkarkimeve. Numri i përfituesve mund të jetë deri në 15 mijë njerëz në varësi të skemës.



Promovimi dhe dhënia e ndihmës për përdorim të automjeteve me ndikim të ulët.	Direkt	20,000,000	Qeveria mund të drejtojë një program pilot, për heqjen e automjeteve më ndotëse, duke inkurajuar blerjen e automjeteve me nivel të ulët të shkarkimeve dhe / ose një tjetër program për të hequr nga përdorimi makinat e prodhuar para vitit 1995. Qeveria duhet të ndajë një fond prej të paktën 20 milionë euro, për të filluar programet për një periudhë prej 3–5 vjet. Numri i përfituesve mund të arrijë deri në 20 mijë ose rreth 6% e njerëzve dhe / ose kompanitë që zotërojnë një makinë.
Kontrolli dhe reduktimi shkarkimeve nga automjetet e shërbimit publik.	Direkt	13,750,000	Është supozuar për të eliminuar totalisht automjetet euro 0, euro 1 dhe euro 2 nga flota e automjeteve në bashkitë e Tiranës, Elbasanit dhe Fierit. Numri i vlerësuar i autobusëve të rinj është 55. Kostoja treguese për një autobus hibrid 41 vendesh konsiderohet të ishte 250,000 €.
Hartimi i një strategjie afatshkurtër të menaxhimit për automjetet komerciale.	Indirekt	350,000	Projekti i TA-it harton një strategji për automjetet komerciale.
Kufizimi dhe zvogëlimi I nivelit të parkimit në rrugë dhe jashtë rrugës, parashikuar në qendrën urbane, për të reduktuar volumet e trafikut dhe shkarkimet e automjeteve.	Direkt	250,000	Projekti TA.
Ndërtimi i hapësirave me gjelbërim të përhershëm përgjatë rrugëve kryesore të trafikut.	Indirekt	20,000,000	Supozohet 800 km të rrugëve.
Përmirësimin e planifikimit urban.	E mundshme	500,000	Pajisje të tjera dhe trajnim për stafin.
Ndalimi i djegies në natyrë, në veçanti në fushat e ndërtimit të materialeve të mbetura/mbetjeve.	Direkt	10,000	Aktet nënligjore të përgatitura dhe të hartuara.
Ndalimi i djegies në natyrë materialeve të mbetura/mbetjeve	Direkt	10,000	Aktet nënligjore të përgatitura dhe të hartuara.
Kufizimi i aktiviteteve të djegies së gjineshrës, kashtës dhe drithërave në tokat bujqësore, ku ka të ngjarë të kemi shqetësime.	Direkt	150,000	Pajisje të tjera dhe trajnim për stafin.
Realizimi i instalimeve për rikuperimin dhe ripërdorimin e biogazit nga bagëtitë.	Direkt	675,000	Ndihma mesatare për fermë është € 1500. Bashkitë me ndotjen e ajrit të lartë nga burime të ngrohjes duhet të përfitojnë nga ndihma në formë të subvencioneve.
Vendosja e Kodit të praktikave më të mira bujqësore.	Indirekt	300,000	Projekti TA për hartimin e Kodit të praktikave më të mira bujqësore.
Promovimi dhe dhënia e ndihmës për përdorim të burimeve të energjisë së rinovueshme, me qëllim përmbushjen e kërkesave të energjisë për ngrohje, ajër të kondicionuar, ndriçim dhe prodhimin e ujit të nxehtë.	Indirekt	125,000,000	Ndihma mesatare për familjet është € 500. Bashkitë me ndotje të lartë të ajrit nga pluhuri nga burimet bujqësore duhet të përfitojnë nga ndihma në formë të subvencioneve.
Përgatitja e një fushate për	E	1,000,000	Pajisje të tjera dhe trajnim për stafin.



	matje, me pajisje portative të monitorimit për vlerësimin e shkarkimeve.	mundshme		
	Vendosja e lartësisë minimale nga toka për oxhaqet dhe shtëllungat në të gjitha instalimet me leje të tipit A.	Direkt	500,000	Projekti TA dhe trajnime shtesë të stafit.
	Rishikimi i kushteve të lejes Class A ose B për instalimet ekzistuese.	Indirekt	1,500,000	Projekti TA dhe trajnime shtesë të stafit.
	Ndihmesa e biznesit (a) për të minimizuar ndikimin negativ në mjedis nga operacionet e tyre (proceset etj.), që shkaktojnë ndotje në ajër, ujë ose tokë); (b) për të qenë në përputhje me ligjet e aplikueshme, rregulloret dhe kërkesat e tjera të orientuara për mjedisin, dhe (c) për t'u përmirësuar vazhdimisht sa më sipër.	E mundshme	10,000,000	Projekti TA, pajisjet shtesë dhe trajnim të stafit.
Fuqizimi i kapaciteteve inspektuese dhe monitoruese	Modernizimi dhe përmirësimi i rrjetit të monitorimit.	Indirekt	4,500,000	Pajisje të tjera, duke përfshirë edhe 10 stacione të reja të monitorimit.
	Krijimi i Sistemi për Inventarin Kombëtar të shkarkimeve.	Indirekt	250,000	Projekti i asistencës teknike dhe trajnim për stafin.
	Sigurimi sa të jetë e mundur që inspektimet që lidhen me cilësinë e ajrit të jenë proporcionale dhe efikase.	E mundshme	1,000,000	Pajisje të tjera dhe trajnim për stafin
Ndërgjegjësi mi dhe trajnimi	Promovimi i programeve arsimore mbi çështjet që lidhen me kontrollin dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër për të përmirësuar cilësinë e ajrit	E mundshme	7,500,000	Tre vjet program përmes mediave.
	Lançimi i një fushate të informimit të publikut mbi rreziqet shëndetësore dhe mjedisore që lidhen me djegien në oborrin e shtëpisë.	E mundshme	4,500,000	Tre vjet program.

## BURIMET FINANCIARE

Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit është një dokument pa afat dhe përfshin masa që do të zbatohen në periudhën deri në vitin 2022 dhe 2022–2026. Për të mbështetur zbatimin e tij është parashikuar kostoja për secilin masë, veprimtari dhe nënveprimtari.

Masat e parashikuara deri në vitin 2022 janë të mbuluara nga PBA-të e institucioneve qendrore përgjegjëse për fushat si: transporti, eficienta energjisë, zhvillimi urban etj. Masat që shtrihen përtej 2022 e deri më 2026-n, përfshijnë masa të cilat janë kostuar por ose nuk janë mbuluar nga Programet buxhetore përkatëse, si në rastin e Ministrisë së Bujqësisë, ose përfshijnë masa të

cilat detajohen dhe specifikohen më tej në planet lokale të cilësisë së ajrit. detyrimi i njëjësive të vetëqeverisjes vendore, për hartimi e planeve lokale të cilësisë së ajrit, parashikohet të fillojë pas vitit 2022.

Kostoja totale e zbatimit të masave të planifikuara, llogaritet në 51.753.956.000 lekë nga të cilat 43.362.359.000 lekë mbulohen nga PBA-të e institucioneve përkatëse për vitet 2020–2022. Vetëm një pjesë e vogël e këtyre masave nuk financohet nga buxheti shtetit, duke përbërë një hendek prej vetëm 8.391.597.000 lekë. Hendeku më i madh, lidhet me sistemet e monitorimit të cilat kanë edhe kostot më të mëdha. Për rrjedhojë, në masat e planit janë parashikuar ndërtimi i vetëm 2 stacioneve të tilla me buxhet



shteti dhe pjesa tjetër me donator, gapi financiar për të cilat fillon nga 2026.

Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit ka specifikuar burimet e financimit të cilat janë:

1. *Financimin nga buxheti* (buxheti i ministrive të linjës dhe buxheti i institucioneve që financohen nga buxheti i shtetit) për masat që kanë si objekt të drejtpërdrejtë veprimtarinë e këtyre institucioneve.

2. *Financimi nga donatorët* për ato veprimtari kostot e të cilave mbulohen nga fonde të donatorëve, pavarësisht nëse kanalizohet përmes buxhetit ose jo.

3. *Financime të tjera* (buxheti i NjQV dhe nga investimet e biznesit)

4. *Nevojat për fonde*, për ato aktivitete që nuk janë të buxhetuara në buxhetin afatmesëm.

## 5.2 Strategjia e financimit

Qëllimi i këtij seksioni është që të shohim se si kostot e identifikuar në seksionin e mëparshëm mund të financohen në vitet e ardhshme. Megjithatë, sikurse nuk ka produkte të qarta specifike në buxhetin afatmesëm, që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë së ajrit, kjo pjesë ka vetëm karakteristika të përgjithshme.

Burimet kryesore të mundshme të financimit janë:

- Tarifat e paguara nga ndotësit, makinat, kamionët, industritë etj.

- Buxhetet e shtetit apo bashkiake

- Grantet nga instrumentet e paraanëtarësimit IPA, nga Bashkimi Evropian

- Grantet nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF) - postanëtarësimit

- Grantet nga donatorë të tjerë ndërkombëtarë

- Kreditë nga institucionet ndërkombëtare të financimit (IFN)

- Kreditë nga institucionet bilaterale të financimit

- Kredi nga bankat komerciale

- Detyrimet e lëshuara nga organet e qeverisjes qendrore ose lokale

- Kapitali private (përmes marrëveshjeve parimore ndotësi-paguan).

Burime të ndryshme të financimit janë konsideruar më poshtë.

Pagesat e bëra nga ndotësit (p.sh. pronarët e makinave)

Pagesat e bëra nga ndotësit mund të përfshijnë:

- Taksa për importimin e automjeteve të përdorura.

- Taksa e karbonit për benzinën, naftën dhe gazoilin. Kjo taksë zbatohet si për karburantet e importuara dhe ato të prodhuara në vend.

Ligji 2002-it për cilësinë e ajrit thotë se taksa e mjedisit duhet të paguhet për shkarkimin e ndotësve të ajrit. Neni 18, taksat e shkarkimit në ajër thotë: Për ndotjen e ajrit, operatorët e burimit të ndotjes paguajnë taksë shkarkimesh, sipas sasisë dhe tipit të ndotësve të shkarkuar, sipas përcaktimeve në legjislacionin për taksat kombëtare. Taksa për shkarkimet e ndotjes së ajrit nuk është zbatuar.

### Buxhetet shtetërore apo bashkiake

Pagat (përfshirë kostot indirekte të lidhura me personelin) e stafit të ri të punësuar për të përmbushur detyrimet e tjera, dhe të gjithave kostove të vazhdueshme operative, do të duhet të plotësohen nga MM-ja apo agjenci të tjera të qeverisë në fjalë

### Instrumenti për asistencën e Paraanëtarësimit

Instrumenti për Asistencën e Parahyrjes është mekanizmi kryesor i Bashkimit Evropian, për ofrimin e asistencës financiare, për investimet e lidhura me përputhshmërinë për vendet kandidate dhe ato që kanë hyrë.

Autoritetet duhet të kërkojnë për të marrë shpenzimet që kanë të bëjnë me asistencën teknike, trajnimin, sende të vogla të pajisjeve dhe blerjen e kompjuterëve hardware dhe software të financuar nga ky instrument.

Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal (ERDF) dhe Fondi i Koezisionit

Këto janë burime potenciale të financimit pas-pranimit. Ata japin financime grant në veçanti për shumë tipa projektesh, duke përfshirë infrastrukturën dhe mjedisin, deri në 50% të vlerës së projektit. Nuk dihet se sa do të vihet në dispozicion nga ERDF-ja për Shqipërinë, dhe është e mundur që do të jenë bërë ndryshime në këtë Fond, derisa Shqipëria të jetë bërë anëtare, megjithatë këto fonde janë të rëndësishme në aspektin e implementimit të *acquis* mjedisore.

### Donatorë të tjerë bilaterale dhe multilaterale

Qeveria duhet të përpiqet për të siguruar, sa më shumë të jetë e mundur, ndihma nga të huajt në mënyrë që Shqipëria të përmbushë detyrimet





e veta të pranimit. Financime të tilla ka shumë mundësi të zvogëlohen pas hyrjes së Shqipërisë në BE.

#### Huatë nga institucionet ndërkombëtare të financimit (IFIs)

Institucionet ndërkombëtare të financimit janë banka zhvillimore, si Banka Botërore, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Banka Europiane e Investimit (EIB) që ofrojnë hua me norma relativisht të ulëta të interesit, për investimet që kanë si qëllim krijimin ose përmirësimin e infrastrukturës mjedisore.

#### Kredi nga bankat komerciale

Pro Credit Bank është banka e parë në Shqipëri, që ka lançuar programin që mbështet efikasitetin e energjisë. Kredia për Eficiencë të Energjisë promovon investimet në shtëpitë private dhe apartamente, me qëllim zvogëlimin e përdorimit të energjisë dhe shpenzimet e energjisë. Banka i jep të gjitha familjeve dhe bizneseve mundësi, për të investuar në teknologji të reja, për të kursyer energji dhe për të ulur shkarkimet e CO<sub>2</sub>.

#### Kapitali privat

Kostot e pagueshme nga ndotësit përfshijnë:

- Kostot lidhur me zbatimin e masave të drejtpërdrejta për reduktimin e shkarkimeve, siç është paraparë sipas Direktivës për Impiantet e Mëdha të Djegjes.

- Kostot që lidhen me zbatimin e aktiviteteve të vetë monitorimit, siç parashikohet në Direktivën IPPC.

- Shpenzimet që lidhen me kufijtë e ardhshëm të shkarkimeve nga automjetet.

- Reduktimi i shkarkimeve nga automjetet, për shkak të rinovimit të flotës së automjeteve në të ardhmen.

### **5.3 Përfitimet**

Ekspozimi ndaj ndotësve të ajrit të mjedisit është kryesisht jashtë kontrollit të individëve dhe kërkon veprime nga autoritetet publike në nivel kombëtar, rajonal dhe madje, edhe ndërkombëtar.

Qëllimi i planit është për të shmangur, parandaluar ose reduktuar shkarkimet e ndotësve të dëmshëm të ajrit, dhe për të arritur kufijtë e përqendrimit për cilësinë e ajrit të mjedisit të dhënë në legjislacion, duke marrë parasysh standardet, udhëzimet dhe programet përkatëse kombëtare.

Pasojat shëndetësore të ekspozimit në ajrin e ndotur janë të konsiderueshme dhe përfshijnë një gamë të gjerë të problemeve nga kollitjet dhe bronkitet, deri tek sëmundjet e zemrës dhe kancerit të mushkërive. Grupet e cenueshme janë foshnjat, të moshuarit dhe ata që vuajnë nga sëmundje kronike të frymëmarrjes, duke përfshirë astma, bronkit ose emfizemë.

Zbatimi i këtij plani do të rezultojë në një ulje të theksuar të numrit të njerëzve në qytetet e Shqipërisë që vuajnë nga infeksionet respiratore, sëmundjeve të zemrës dhe kancerit të mushkërive. Do të jetë gjithashtu, një reduktim i përgjithshëm në ndikimet mjedisore që rezultojnë nga ndotësit në ajër (acidifikimit, procesit të eutrofikimit, reduktimit të kulturave bujqësore, degradimi i pyjeve etj.).

#### Strategjia për pjesëmarrjen e publikut

Një planifikim i duhur mjedisit dhe, në veçanti, një menaxhimi modern i mjedisit, nuk mund të shmangë ndarjen me aktorë të ndryshëm të përcaktimit të objektivave, për të racionalizuar mbrojtjen e territorit dhe zbatimin të masave më efektive, si dhe për t'i ndjekur ato.

Për këtë qëllim, pasi tashmë është vënë në dukje në hyrje, Plani Kombëtar i menaxhimit të cilësisë së ajrit është përgatitur nga ministria përgjegjëse për mjedisit me asistencën teknike të projektit IBECA-s të financuar nga BE-ja, në partneritet me aktorët kryesorë, institucionale dhe privat, të interesuar në çështjen e ndotjes / cilësisë së ajrit.

Për të siguruar pjesëmarrjen e publikut, në vijim është propozuar:

- Drafti i parë është shpërndarë nga ministria përgjegjëse për mjedisin për autoritetet përgjegjëse për kontrollin / menaxhimin për konsultimin / vlerësimin e cilësisë së ajrit; në këtë fazë çdokush mund të dërgojë komentet e tyre brenda një periudhë të caktuar kohore nga data e shpërndarjes.

- Drafti i dytë është përgatitur në bazë të komenteve dhe është vënë në dispozicion për konsultim publik, duke e publikuar në faqen *web* të Ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

Integrimi i këtyre dy procedurave tregon një fazë të përbashkët të konsultimeve dhe reklamimit të planit, i cili siguron pjesëmarrjen aktive, jo vetëm të organeve dhe shoqatave lokale të përfshira drejtpërdrejt në masat e planit, por



edhe të qytetarëve individual. Në fakt, edhe ata konsiderohen protagonistët, dhe ata janë në rolin e dyfishtë të njerëzve të ekspozuar ndaj ndotjes dhe të shkarkuesve të ndotësve, përmes aktiviteteve dhe jetesës së tyre.

Takime tematike mund të organizohen nga ministria përgjegjëse për mjedisin në çdo bashki, me pjesëmarrjen e shtypit lokal, si për të shpërndarë informacionin mbi përmbajtjen e Planit, ashtu edhe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnimin e popullsisë mbi nevojën, për të zbatuar ndryshimet e sjelljes dhe rutinës, sa i përket lëvizshmërisë, konsumimit të energjisë, duke respektuar burimet në dispozicion dhe mundësitë për individët, për të kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

#### Monitorimi dhe verifikimi i planit

Për të siguruar që plani është zbatuar në përputhje me objektivat e përcaktuara dhe të ndjekë evolucionin dhe kontekstin e terrenit, më poshtë janë përcaktuar mekanizmat e monitorimit dhe verifikimit, të dobishme për të vënë në lëvizje çdo masë të planifikuar në kohën e duhur.

#### 5.4 Monitorimi i Planit

Mekanizmi i monitorimit ka për qëllim të japë informacion për të vlerësuar funksionalitetin dhe efikasitetin e planit dhe, për këtë arsye, ofron një analizë të zbatimit të Planit të masave dhe vlerësimin e gjendjes së cilësisë së ajrit.

ministria përgjegjëse për mjedisin do të krijojë Komitetin Drejtues, me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve përkatëse të linjës dhe qeverisjen lokale, me përgjegjësi për zbatimin e planit. Komiteti Drejtues mund të ketë nevojë për të krijuar grupe të punës dhe t'u caktojë atyre detyrën e hartimit të planeve specifike të punës.

Për këtë qëllim, ministria përgjegjëse për mjedisin, në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe me mbështetjen e AKM-së, përgatit një raport vjetor të monitorimit, që përmban informacion për çdo veprim/ masë të Planit mbi:

- Shkallën e statusit të zbatimit.

- Çdo pengesë administrative, financiare apo teknike.

- Veprime korigjuese të marra ose që do të merren.

- Vendosija e indikatorëve të referencës.

Raporti gjithashtu, duhet të përmbajë një vlerësim të gjendjes së cilësisë së ajrit, në bazë të masave kombëtare të kontrollit të rrejtit, dhe një përmbledhje të problematikës kryesore të shfaqur.

#### 5.5 Verifikimi i Planit

Verifikimi i këtij plani ka për qëllim vlerësimin e efektivitetit të reduktimit të shkarkimeve, në krahasim me atë të planifikuar, dhe efektivitetin e reduktimit të shkarkimeve, mbi nivelet e përqendrimit, dhe në këtë mënyrë respektimin e objektivave / rezultateve.

Për këtë qëllim, është shumë e rëndësishme: forcimi i strukturave përkatëse në AKM-ë, për të krijuar një qendër reference kombëtare të cilësisë së ajrit në gjendje për të trajtuar, përveç rrejtit të monitorimit, dhe sistemin e integruar të modelimit për vlerësimin e cilësisë së ajrit.

Siç u përmend më lart, ky plan vuan nga:

- a) mungesa e informacionit të detajuar në lidhje me monitorimin e cilësisë së ajrit;

- b) njohuri të reduktuara të statusit të shkarkimeve në ajër.

Me qëllim që të harmonizojmë praktikën aktuale të monitorimit me kërkesat e BE-së, do të jetë një prioritet i AKM-së, për të zbatuar procedurat QA/QC të të dhënave të monitorimit. Sigurimi i cilësisë është i nevojshëm, nëse të dhënat do të konsiderohen të besueshme dhe do të përdoren për të krijuar informacionin e nevojshëm, për menaxhimin e cilësisë së ajrit. Përpjekjet urgjente janë të nevojshme për të zhvilluar një sistem të konsoliduar të monitorimit dhe informimit të pajisur siç duhet, dhe të shqyrtojë informacionin e përfshirë në plan.

Procesit të monitorimit dhe verifikimit të masave të identifikuara në këtë dokument, i shërbejnë edhe të dhënat më poshtë\*:

Emërtimi i indikatorit: Shkarkimet e ndotësve urban të ajrit (PM, SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub>, CO<sub>2</sub>, HC)

Klasifikimi Trysnia

Përkufizimi dhe arsyetimi



Ndotësit fotokimikë janë burimi kryesor i ndrojtjes së ajrit në zonat urbane, të shkaktuara kryesisht nga transporti dhe prodhimi i energjisë (ngrohja). Këta indikatorë janë përgatitur kryesisht për të dhënë informacion lidhur me performancën e reduktimit të shkarkimeve në ajër. Në kontekstin e BE-së, ato përshkruhen në Direktivën 2008/50/BE. Monitorimi ka të bëjë me regjistrimin e parametrave të mëposhtëm:

- Përqendrimi mesatar çdo orë/ditor/vjetor (g/m<sup>3</sup>);
- Numri mesatar i ditëve që tejkalojnë kufirin.

Kuadri i politikave dhe synimet      NDOTJA E AJRIT  
Metodologjia

Matja e ndotësve (infektuesve) duhet të bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë 24 orëve. Koha e përgjigjes së analizuesve automatikë është në rendin e një minute, p.sh: çdo analist jep një vlerë pothuajse çdo minutë. Me një mikroprocesor dhe/ose regjistruer i cili do të vendoset në çdo stacion të lidhur, analizuesit automatikë llogarisin në çdo kohë vlerën mesatare në orë për ndotjen.

Mikrogramet (mg) e ndotësve për metër kub për PM<sub>2.5</sub>, PM<sub>10</sub>, O<sub>3</sub>, NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub>.

Vlerat e mbledhura transferohen në serverin e bazës së të dhënave nga një modem, duke lejuar në këtë mënyrë regjistrimin e vazhdueshëm për nivelet e ndotjes së ajrit në një zonë urbane. Në përgjithësi metodat e përdorura në stacionet automatike janë:

-NDIR (CO) kimiluminishencë (NOX), IR thithje (O<sub>3</sub>), Fluorometrik (SO<sub>2</sub>), b rrezatim ose gravi-metrik (PM), gaz kromatografi (HC).

Stacionet e monitorimit të mbikëqyrjes mund të përdoren gjithashtu për të regjistruar, ndotjen e ajrit në më shumë zona për të siguruar të dhëna për të kuptuar më mirë modelet hapësinore të ndotjes (zona urbane më të vogla, pyje, zona rurale afër akseve të mëdha të transportit ose zonave industriale).

#### Frekuenca e matjeve

Vazhdueshëm në qytete, kampionime në 'zona të kërkimit'

Afërsisht 110 stacione të monitorimit të mbikëqyrjes në vit duhet të mbulojnë 4 fushata të kampionimit.

#### Mbulimi gjeografik-zhvillimi

Qendrat e mëdha urbane/zona të tjera

#### Indikatorët shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:

- Tejkalimi i vlerave limit të cilësisë së ajrit në zonat urbane.

#### - Autoriteti përgjegjës

Sot ekziston një përgjegjësi e përbashkët midis AKM dhe Institutit të Shëndetit Publik. propozohet unifikimi i përgjegjësisë nën një autoritet (AKM).

Pasiguritë

-

\*Burimi: Botim i GEF, Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP: Vlerësimi i kapaciteteve kombëtare për monitorimin e indikatorëve mjedisor.



### 5.6 Rishikimi i Planit

Plani do të përditësohet vazhdimisht, në varësi të përmirësimit të njohurive mbi gjendjen e cilësisë së ajrit dhe proceset e lidhura me të; përditësimet dhe ndryshimet në legjislacion, si dhe çdo ndryshim thelbësor që mund të ndodhin në territorin, në bazë të të cilave ministria përgjegjëse për mjedisin do të ndërhyjë për të gjetur ndonjë zgjidhje të përshtatshme me menaxhimin e duhur të cilësisë së ajrit, në përputhje me objektivin e përgjithshëm të mbrojtjes së shëndetit publik dhe të ekuilibrit të ekosistemeve.

Masat dhe veprimet e planit janë bërë për një skenar deri më 2022-in, prandaj është e përshtatshme që plani aktual të rishikohet, pas periudhës prej tre vjetësh.

#### Aneksi A: Të dhënat e monitorimit 2002–2017

Në tabelat e mëposhtme është treguar përmbajtja e disa ndotësve të ajrit, në bashkitë kryesore të Shqipërisë, gjatë periudhës 2002–2015. Burimi i këtij informacioni është Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Siç mund të vërehet, të dhënat nuk janë dhënë për të gjitha vitet dhe të gjitha parametrat. Kjo, për shkak të numrit të mangësive si më poshtë:

- Në Tiranë të dhënat në SO<sub>2</sub>, për periudhën 2011–2013, janë të humbura, se pajisja nuk funksiononte, ndërsa për LNP-në nuk kishte asnjë pajisje, dhe monitorimi është realizuar me stacione automatike.

- Stacioni i monitorimit në Shkodër, në vitin 2013, ka pasur probleme në transmetimin e të dhënave.

- Stacioni i monitorimit në Durrës, në vitin 2013, ka pasur probleme të furnizimit me energji elektrike.

- Në Elbasan pajisjet janë dëmtuar.

- Monitorimi në Fier ka qenë i kryer nga Instituti i Shëndetit Publik me pajisje manuale, i cili është kontraktuar nga AKM-ja. Për periudhën 2013–2015, ISHP-ja është kontraktuar, për shkak të kufizimeve buxhetore, vetëm në vitin 2014 për PM-në.

- Në periudhën 2008–2009, monitorimi në Vlorë nuk është kryer, pasi AKM-ja nuk e ka nënshkruar kontratën me ISHP-në, ndërsa në vitin 2012 stacioni nuk ishte instaluar. Në tetor të vitit 2011, 4 stacione të reja automatike janë dorëzuar, por stacioni në Vlorë nuk ishte instaluar.

- Në Korçë gjatë vitit 2008–2009, nuk ka kontratë me ISHP-në, për shkak të kufizimeve buxhetore.

Ndotësit e ajrit	Vitet/njësi	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
		Tiranë													
SO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	18,00	17,00	16,00	20,00	24,00	20,00	12,50	13,04	12,72	7,61	6,3	-	15,52	10,46
NO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	35,00	35,00	35,00	36,00	34,00	38,00	34,26	33,52	32,47	39,94	23,83	27,30	35,01	42,38
Lead	µg/m <sup>3</sup>	1,10	1,10	1,10	0,00	0,32	0,35	0,06	0,05	0,055	-	-	-	0,01	0,007
O <sub>3</sub>	µg/m <sup>3</sup>	59,00	79,00	99,00	100,00	100,00	97,00	41,80	50,00	56,98	38,98	55,79	51,03	32,64	33,34
PM <sub>10</sub>	µg/m <sup>3</sup>	152,00	159,50	167,00	172,00	163,00	160,00	68,44	33,50	72,81	82,56	35,44	32,56	54,06	57,34
PM <sub>2,5</sub>	µg/m <sup>3</sup>	-	-	-	-	-	-	-	-	30,95	32,805	19,24	16,45	-	-
CO	mg/m <sup>3</sup>	-	-	-	-	-	-	-	-	0,356	0,4665	0,559	0,43	-	0,85
Benzen	µg/m <sup>3</sup>	-	-	-	-	-	-	-	-	0,9215	0,5065	1,773	3,95	-	2,76

Ndotësit e ajrit	Vitet/njësi	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
		Shkodër													
SO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	20,00	14,50	9,00	12,00	18,00	11,00	16,00	15,00	17,00	12,40	3,11	-	5,52	13,91
NO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	33,00	23,50	14,00	18,00	21,00	22,00	28,00	24,00	26,50	25,50	6,7	-	12,5	9,94
Lead	µg/m <sup>3</sup>	0,38	0,42	0,46	0,30	0,28	0,28	0,24	0,25	0,22	0,22	-	-	-	-
O <sub>3</sub>	µg/m <sup>3</sup>	91,00	93,00	95,00	90,00	90,00	93,00	68,00	68,00	70,60	73,80	61,52	-	71,54	71,1
PM <sub>10</sub>	µg/m <sup>3</sup>	101,00	102,00	103,00	107,00	100,00	101,00	108,00	112,00	86,00	93,90	40,2	-	21,84	20,67
PM <sub>2,5</sub>	µg/m <sup>3</sup>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	19,19	-	11,64
CO	mg/m <sup>3</sup>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0,28	-	0,51



Benzen	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,7	-	1,59	2,91
--------	--------------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	-----	---	------	------

Ndotësit e ajrit	Vitet/njësi	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
		<b>Durrës</b>													
SO <sub>2</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	27,00	19,50	12,00	16,00	19,00	15,00	18,00	18,00	20,10	15,132,8	5,2	-	9,12	11,77
NO <sub>2</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	27,00	22,50	18,00	22,00	24,00	23,00	35,00	28,00	28,10	32,80	20,5	-	24,52	26,54
Lead	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	0,47	0,405	0,34	0,29	0,28	0,26	0,27	0,27	0,25	0,24	-	-	-	-
O <sub>3</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	66,00	82,50	99,00	98,00	98,00	99,00	64,00	72,00	67,40	79,00	65,8	-	50,37	52,86
PM <sub>10</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	124,00	109,50	95,00	91,00	93,00	100,00	116,00	121,00	91,00	104,00	32,9	-	13,97	18,07
PM <sub>2,5</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	14,31	-	8,45	12,74
CO	$\text{mg}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0,38	-	0,48	0,43
Benzenë	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,54	-	1,94	2,68

Ndotësit e ajrit	Vitet/njësi	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
		<b>Elbasan</b>													
SO <sub>2</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	38,00	29,00	20,00	27,00	22,00	19,00	8,67	14,41	18,40	-	15,5	-	16,92	6,9
NO <sub>2</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	33,00	29,00	25,00	33,00	22,00	24,00	22,25	23,98	29,39	-	22,6	-	32,67	24,08
V	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	0,16	0,24	0,32	0,00	0,27	0,31	0,06	0,05	-	-	-	-	0,89	0,019
O <sub>3</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	57,00	76,50	96,00	26,00	26,00	95,00	46,24	-	-	-	72	-	18,76	32,98
PM <sub>10</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	175,00	147,00	119,00	120,00	90,00	103,00	57,16	51,39	116,44	97,24	89,7	-	46,25	45,09
PM <sub>2,5</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
CO	$\text{mg}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0,66	0,68
Benzen	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	0,413	-	-	-	-	0,25	0,76

Ndotësit e ajrit	Vitet/njësi	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
		<b>Fier</b>													
SO <sub>2</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	21,00	19,75	18,50	18,00	24,00	25,00	32,00	33,00	26,70	19,60	20,00	-	-	-
NO <sub>2</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	21,00	18,00	15,00	23,00	25,00	24,00	33,00	27,00	31,00	31,50	25,00	-	-	-
Lead	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	0,23	0,21	0,19	0,25	0,29	0,25	0,32	0,25	0,24	0,23	-	-	-	-
O <sub>3</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	51,00	73,50	96,00	100,00	100,00	98,00	70,00	74,00	62,60	76,00	74,00	-	-	-
PM <sub>10</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	109,00	92,00	75,00	93,00	106,00	102,00	112,00	110,00	93,00	89,00	97,00	-	-	-
PM <sub>2,5</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	41,54	-
CO	$\text{mg}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Benzen	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Ndotësit e ajrit	Vitet/njësi	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
		<b>Vlorë</b>													
SO <sub>2</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	23,00	16,50	10,00	12,00	16,00	14,00	-	-	21,80	11,40	-	-	8,05	7,7
NO <sub>2</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	21,00	19,00	17,00	18,00	23,00	23,00	-	-	26,00	25,70	-	7,25	10,41	13,71
Lead	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	0,24	0,335	0,43	0,25	0,24	0,23	-	-	0,21	0,19	-	-	-	-
O <sub>3</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	60,00	81,50	103,00	103,00	103,00	100,00	-	-	68,10	70,40	-	75,25	63,65	68,28
PM <sub>10</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	70,00	69,50	69,00	72,00	86,00	89,00	-	-	80,00	83,70	-	34,37	15,29	18,72
PM <sub>2,5</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	16,11	10,55	8,39
CO	$\text{mg}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0,37	0,42
Benzen	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0,91	1,75

Ndotësit e ajrit	Vitet/njësi	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
		<b>Korçë</b>													
SO <sub>2</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	14,00	11,00	8,00	10,00	17,00	11,00	-	-	19,90	11,30	2,4	5,83	6,95	4,31
NO <sub>2</sub>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	21,00	16,00	11,00	12,00	20,00	15,00	-	-	24,60	16,90	7,9	5,06	13,66	13,9
Lead	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	0,16	0,19	0,21	0,12	0,20	0,16	-	-	0,22	0,19	-	-	-	-



O <sub>3</sub>	µg/m <sup>3</sup>	59,00	74,50	90,00	86,00	86,00	85,00	-	-	62,30	67,40	57,3	66,2	54,87	49,46
PM <sub>10</sub>	µg/m <sup>3</sup>	70,00	63,00	56,00	63,00	82,00	91,00	-	-	85,00	84,40	44,49	27,52	38,28	44,85
PM <sub>2,5</sub>	µg/m <sup>3</sup>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	28,81	-	-	29,14
CO	mg/m <sup>3</sup>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0,67	-	1,18	1,13
Benzen	µg/m <sup>3</sup>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2,91	-	3,48	6,21

Ndotësit e ajrit	Vitet/njësi	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
		Mesatarja e përgjithshme													
SO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	23,00	18,18	13,36	16,43	20,00	16,43	17,43	18,69	19,52	12,46	8,75	5,83	10,35	8,36
NO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	27,29	23,29	19,29	23,14	24,14	24,14	30,50	27,30	28,29	28,72	17,75	13,20	21,46	23,76
Lead	µg/m <sup>3</sup>	0,39	0,41	0,44	0,17	0,27	0,26	0,19	0,17	0,20	0,21	-	-	0,45	0,013
O <sub>3</sub>	µg/m <sup>3</sup>	63,29	80,07	96,86	86,14	86,14	95,29	58,01	66,00	64,66	67,60	64,40	64,16	48,64	51,34
PM <sub>10</sub>	µg/m <sup>3</sup>	114,43	106,07	97,71	102,57	102,86	106,57	92,32	85,57	89,18	90,69	56,62	31,48	31,62	37,44
PM <sub>2,5</sub>	µg/m <sup>3</sup>	-	-	-	-	-	-	-	-	30,95	32,81	20,38	16,28	18,05	16,12
CO	mg/m <sup>3</sup>	-	-	-	-	-	-	-	0,356	0,4665	0,56	0,44	-	0,68	0,74
Benzen	µg/m <sup>3</sup>	-	-	-	-	-	-	-	0,667	0,5065	1,77	2,52	-	1,82	2,87

Referuar Raportit të Gjendjes së Mjedisit, për vitin 2016, nga monitorimi i cilësisë së ajrit, konstatohet se: ndotësit kryesorë të cilësisë së ajrit urban janë pluhurat me diametër 10 dhe 2.5 mikrometër (PM<sub>10</sub>/PM<sub>2,5</sub>) në stacionet e Tiranës dhe Elbasanit si dhe në stacionin e Korçës në periudhën e dimrit Burimi kryesor i ndotjes nga PM<sub>10</sub> në stacionin e Elbasanit dhe Tiranës është shkarkimi i automjeteve pasi dhe stacionet janë instaluar buzë rrugëve me trafik të rënduar ndërsa në stacionin e Korçës burimi kryesor i ndotjes nga PM<sub>10/2,5</sub> është përdorimi lëndës së djegshme për ngrohjen e banesave.

Një nga treguesit kryesorë të cilësisë së ajrit urban për PM<sub>10</sub> është dhe numri i ditëve që tejkalon normën ditore të BE-së prej 50 µg/m<sup>3</sup> nga numri i ditëve të lejuara në një vit që është 35 ditë. Bazuar në të dhënat statistikore për numrin e ditëve që tejkalojnë normën ditore të PM<sub>10</sub> vërejmë se kemi tejkallim në stacionin e Korçës ku kemi tejkallim 65 ditë në vit dhe Tirana AKM ku kemi tejkallim 76 në vit nga 35 ditë që numri i ditëve të lejuar në një vit. Kemi përafrim të numrit të ditëve të lejuar në vit për stacionin e Durrësit dhe Elbasanit. Ndërsa në stacionin e Shkodrës, Vlorës dhe Tirana ATSH numri i ditëve që tejkalojnë normën ditore të BE është i ulët.

(Burimi: [http://www.akm.gov.al/assets/web\\_raporti-mjedisit\\_17.pdf](http://www.akm.gov.al/assets/web_raporti-mjedisit_17.pdf))

Referuar Raportit të Gjendjes së Mjedisit, për vitin 2017, monitorimi nuk është kryer i plotë për arsye të mungesës së fondeve të monitorimit dhe llogaritja e mesatareve është bërë bazuar në vlerat për periudhën e monitoruar. Në raport nuk është paraqitur trendi në vite për arsye se nuk mund të bëhet krahasimi i vlerave vjetore me periudhën e monitoruar gjatë këtij viti. Vlerësimi i cilësisë së ajrit, është bërë bazuar në krahasimin e vlerave faktike me ato të përcaktuara në legjislacionin Shqiptar dhe në direktivat e BE-së për ajrin urban. Referuar vlerave ditore të periudhës së monitoruar rezulton se ka tejkallim të normës ditore prej 50 µg/m<sup>3</sup> në stacionin e Korçës, Tirana BT dhe Tirana AKM. Numri i ditëve që tejkalojnë normën ditore të PM<sub>10</sub> në stacionin e Tirana BT është 64 ditë nga 107 ditë të monitoruar, në stacionin e AKM 70 ditë nga 155 ditë të monitoruara dhe në stacionin e Korçës 40 ditë nga 239 ditë të monitoruara. Numri i ditëve të lejuara që tejkalojnë normën ditore të PM<sub>10</sub> është 35 ditë në një vit.

[http://akm.gov.al/assets/raporti-akm-2017\\_preview\\_09052018.pdf-ardhur-nga-shtepia-botuese.pdf](http://akm.gov.al/assets/raporti-akm-2017_preview_09052018.pdf-ardhur-nga-shtepia-botuese.pdf)



## Aneksi B: Buxheti sipas veprimeve dhe masave

## PLANI KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT

## I. Masat për reduktimin e shkarkimeve nga trafiku

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse	Afati	Treguesit/Synimet	Kosto (në mijë lekë)	Burimi i financimit (në mijë lekë)			
						Institucionet shtetërore	Të tjerë (biznesi, NJVQV)	Donatorët	Nevoja për fonde
<i>I.1 Inkurajimi i kalimit nga përdorimi i makinave private drejt llojeve të tjera të udhëtimit dhe nxjerrja e përdorimit të transportit publik për të reduktuar shkarkimet e automjeteve dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit</i>									
I.1.1	Promovimi dhe inkurajimi i lehtësirave në ciklizëm brenda zonave të banuara, për të mundësuar rrugë të sigurta ciklizmi nga shkollat lokale dhe dyqanet. Theksi do të jetë në inkurajimin e përdorimit të ciklizmit që do të zvogëlojë volumnin e makinave private që udhëtojnë gjatë periudhës së pikut të trafikut në mëngjes	NJQV (Zona A dhe B) <sup>7</sup>	2019	Vlerat e PM <sub>2.5</sub> , PM <sub>10</sub> , O <sub>3</sub> , NO <sub>x</sub> , SO <sub>x</sub> në zonat urbane brenda standardeve.	12,320	12,320			
I.1.2	Përgatitja dhe zbatimi i planit të transportit për një rrjet strategjik të rrugëve të biçikletave dhe rrugëve të çlodhjes. Ky plan duhet të përfshijë kushte më të sigurta për biçikletat, përmirësime në parkim të biçikletave dhe komunikim të përshtatshëm mes ciklizmit dhe mënyrave të tjera të udhëtimit. Ky plan duhet gjithashtu, të japë vëmendjen e duhur masave të përshtatshme për qetësimin e trafikut, në zonat e banuara, në afërsi të rrugës, për të parandaluar një përkeqësim në cilësinë e ajrit	NJQV (Zona A dhe B)	Nga 2023 e në vazhdim	Vlerat e PM <sub>2.5</sub> , PM <sub>10</sub> , O <sub>3</sub> , NO <sub>x</sub> , SO <sub>x</sub> në zonat urbane brenda standardeve.	250,000	250,000			
I.1.3	Promovimi dhe inkurajimi i rrugëve të sigurta dhe të përshtatshme për të ecur nga shkollat dhe dyqanet në zonat e banuara me theks të veçantë në sigurimin e rrugëve alternative 'të sigurta' për udhëtime të shkurtra, zakonisht më pak se 1-2 km gjatësi.	NJQV (Zona A dhe B)	Nga 2025 e në vazhdim	Vlerat e PM <sub>2.5</sub> , PM <sub>10</sub> , O <sub>3</sub> , NO <sub>x</sub> , SO <sub>x</sub> në zonat urbane brenda standardeve.	220,000	220,000			
I.1.4	Mbështetje dhe inkurajim në zbatimin e shpejtë të korridoreve cilësore të autobusëve dhe masave të tjera prioritare për autobusët, përgjatë rrugëve kryesore të trafikut	NJQV (Zona A dhe B)	Nga 2024 e në vazhdim	Vlerat e PM <sub>2.5</sub> , PM <sub>10</sub> , O <sub>3</sub> , NO <sub>x</sub> , SO <sub>x</sub> në zonat urbane brenda standardeve.	910,000				
I.1.5	Sigurimi i lehtësirave të shërbimit të autobusëve ndërrurban dhe shërbimeve hekurudhore periferike,	NJQV (Zona A dhe B)	Nga 2024 e në vazhdim	Vlerat e PM <sub>2.5</sub> , PM <sub>10</sub> , O <sub>3</sub> , NO <sub>x</sub> , SO <sub>x</sub> në zonat urbane brenda standardeve.	3,500,000		3,500,000		

<sup>7</sup> Zona A (Tiranës dhe Elbasani); Zona B (Fierit, Durrësit, Vlorës, Shkodrës, Korçës, Patosit, Ballshit, Kamzës dhe Paskuqanit)



	për të lehtësuar lëvizjen për në/ dhe nga puna								
I.1.6	Futja e poliutkave të çmimeve të rrugëve për makinat private	<b>ministra përgjegjëse për transportin</b>	Nga 2023 e në vazhdim	Vlerat e PM <sub>2.5</sub> , PM <sub>10</sub> , O <sub>3</sub> , NO <sub>x</sub> , SO <sub>x</sub> në zonat urbane brenda standardeve.	875,000				

Masat e parashikuara në pikat 1.1.1 deri në 1.1.6 më sipër, synojnë uljen e shkarkimit të ndotësve të ajrit (PM<sub>2.5</sub>, PM<sub>10</sub>, O<sub>3</sub>, NO<sub>x</sub>, SO<sub>x</sub>) në zonat urbane. Vlerat standarde të treguesve janë të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi: VKM nr. 594, datë 10.9.2014 'Për miratimin e strategjisë kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit' dhe VKM nr. 352, datë 29.4.2015 'Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të'. Indikatorët e përcaktuar në këtë plan janë në përputhje me SKZHI 2015-2020, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), si dhe indikatorët e përmirësimit të cilësisë së ajrit në PBA.

Masat e parashikuara në pikat 1.1.1 deri në 1.1.6 më sipër, do të jenë të integruara edhe në planet lokale të cilësisë së ajrit për zonat A dhe B, që do të hartohen nga NJQV.

MIE dhe NJQV	II.1 Përmirësimi i planifikimit urban	Inkurajimi për zhvillimin e rezidencave publike dhe private afër rrugëve të transportit publik, për të reduktuar varësinë nga makinat private për të shkuar dhe ardhur nga puna. Inkurajimi i veprimtarive ekonomike "home-based" ku për shkak të natyrës dhe shkallës së tyre, ato mund të vendosen lehtësisht, pa dëmtuar zonat e banuara Inkurajimi i zhvendosjes së godinave të bizneseve që janë në zonat e banuara dhe që seriozisht pengojnë arrijen e objektivave të cilësisë së ajrit në këto zona banimi.	Produktet specifike do të përcaktohen dhe koston në Planet e Përgjithshme vendore			65,000	65,000	65,000	65,000									65,000			
Sub total	65,000					65,000	65,000	65,000	65,000									65,000			
NJQV	II.2 Kërkesat për zhvilluesit që të hartojnë një plan të dokumentuar për të reduktuar pluhurin dhe	Shqyrtimi i të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimet e reja të mëdha, për të siguruar që çdo shkarkim në atmosferë nga zhvillimi, nuk rezultojnë me ndryshimin e cilësisë së ajrit, si dhe nuk tejkalon vlerat e synuara të përcaktuara në planin e menaxhimit Te kërkohet që propozimet e planifikimit, për zhvillimin e vendeve	Produktet do të specifikohen dhe koston në Planet lokale të Veprimt për																		



	shkarkimet në ajër, ndërtimit rërim	në gjatë dhe	poriferike, apo fushave të gjelbërta, që kërkojnë një deklaratë të ndikimit në mjedis, të adresojnë ndikimin lokal të ndryshimeve, të fluksit të trafikut, në cilësinë e ajrit.	Cilesine e Ajrit																
			Te kërkohej që informacioni i përshtatshëm mbi ndikimin në cilësinë e ajrit, të zhvillimeve të reja, të paraqitet si pjesë e procedurës së Vlerësimit të mjedisit, sipas dispozitave të legjislatonit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe në përputhje me procedurat e lejave të ndërtimit																	
			Marrja e masave që konsiderohen të përshtatshme, për të parandaluar një shqetësim të krijuar nga shkarkimet e pluhurit, që ndodhin gjatë aktiviteteve të ndërtimit / apo prishjeve në zonën e tyre funksionale																	
	Sub total	0																		
	NJQV	II.3 Ndikimi në dhënie e punëve publike, kompanive që përdorin menyra/mjete ekologjiksht miqësore	Te kërkohej, kur është e nevojshme, që një plan i dokumentuar është dorëzuar, duke treguar masat për parandalimin dhe reduktimin e shkarkimeve paraprahe të pluhurit dhe grimcave në ajër, për kryerjen e aktiviteteve që mund të rezultojnë në bezdisje																	
	Sub total	0																		
	MBZHR/M IE/ISHMP	II.4 Ndalimi i djegies në natyrë, në veçanti në fushat e ndërtimit të materialeve të mbetura	Të Intensifikohet kontrolli nga sektori mbi ndalimin e djegies në natyrë të mbetjeve.		1,300	1,300	1,300	1,300							1,300					
	Sub total	1,300													1,300					
	Total Masa II	66,300													1,300					
	III. Masat për reduktimin e shkarkimeve nga bujqësia																			
	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	III.1 Ndalimi i djegies në natyrë i materialeve të mbetura	Të Intensifikohet kontrolli mbi ndalimin e djegies në natyrë të mbetjeve	Parashikuar në Aktivitetin II.4																
	Sub total	0																		
	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	III.2 Kufizimi i aktivitetëve të djegies së gjineshrës, kashtrës dhe drithërave në tokat bujqësore, ku ka të ngjarë të kemi shqetësime	Të kërkohej, kur është e nevojshme që një plan për qëllimin e kryerjes së djegies në natyrë në tokat bujqësore është paraqitur paraprakisht në seksionin e mjedisit, për djegjen e gjineshrës, kashtrës dhe drithërave të tjera për të parandaluar tymin e gjeneruar nga këto aktivite, duke krijuar një shqetësim të komunitetit lokal, ose një rrezik për përdoruesit e rrugës. Duhet të jepet madhësia e zonës për t'u djegur, masa për të kontrolluar djegjen dhe masat e sigurisë nga zjarri, si dhe orari i propozuar për djegjen		2,275	2,275	2,275	2,275							2,275					
			Të kërkohej që pas përfundimit të djegies së kashtrës dhe drithërave, hiri i mbetur duhet të futet në tokë, për të parandaluar një shqetësim lokal nga pluhuri		2,275	2,275	2,275	2,275							2,275					
			Të promovohet realizimi i instalimeve për rikuperimin dhe ripërdorimin e biogazit nga fermat blegtorale		14,950	14,950	14,950	14,950							14,950					
	Subtotal	19,500													19,500					
	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe MIE	III.3 Realizimi i instalimeve për rikuperimin dhe ripërdorimin e biogazit nga bagëtitë	Të sigurojë stimuj për fermerët që realizojnë instalime për ripërdorimin e biogazit nga bagëtitë		87,750	87,750	87,750	87,750							87,750					
	Subtotal	87,750													87,750					
	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	III.4 Vendosja/Ngritja e Kodit praktikave të mira bujqësore	Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e Kodit të praktikave të mira bujqësore		19,500	19,500	19,500	19,500							19,500					
			Trajnimin e fermerëve në zbatim të Kodit të praktikave të mira bujqësore		19,500	19,500	19,500	19,500						19,500	19,500					
	Subtotal	39,000													39,000					
	MTM, MIE	III.5 Reduktimi i emetimeve nga drutët e zjarrit	Fushatë për ndërgjegjësimin e publikut me disa projekte pilot, për zbatimin e praktikave më të mira	Fushatë ndërgjegjësimi	1,120	1,120	1,120	1,120												
	Subtotal	1,120																		
	Ministria e Bujqësisë dhe	III.6 Reduktimi i shkarkimeve nga blegtoria	Masat për reduktimin e shkarkimeve nga blegtoria në lidhje me praktikën e mira të kompostimit të plehut organik dhe ndalimin e evaporizimit të amoniakut në atmosferë.	Produktet do të përcaktohen në Planet Lokale për Cilesinë e																



Zhvillimit Rural	Subtotal	0																		
Total Masa III	147,370																			
<b>IV. Masat për reduktimin e shkarkimeve nga burimet difuze industrial</b>																				
MIE	IV.1 Promovimin e përdorimit të burimeve të energjisë së rinoveshmeme qëllim përbushjen e kërkesave të energjisë për ngrohje, ajër të kondicionuar, ndriçim dhe prodhimin e ujit të nxehtë	Promovimi i iniciativave për përdorimin e instalimeve të koogjenierimit (në veçanti në objektet publike dhe zonave të reja të zhvillimit të ndërtimit)	Projektet ide dhe studim fisibiliteti i sistemit të ngrohjes së Korçës duke përjashtuar lenden drusore (projekt I r)	15,031,200	15,031,200	15,263,200	15,031,200													
			Standardet e ndriçimit Urban dhe Rrugor në Republikën e Shqipërisë	20,000	20,000		20,000													
			Auditimi energjetik i stokut të ndëtesave Publike	212,000	212,000		212,000													
			Nxitja për eksperimentimin dhe përdorimin e sistemeve fotokatalitike për pakësim të ndotësve	44,000	44,000	44,000	44,000													
Subtotal	15,307,200			15,307,200	15,307,200	15,307,200	15,307,200													
MTM	IV.2 Përgatitja e një fushate për matjet, me pajisje portative të monitorimit për vlerësimin e shkarkimeve	Futja e kontroleve të rregullta dhe periodike të gazrave nga të gjithë fabrikat.		130,000	130,000	130,000	130,000													
Subtotal	130,000			130,000	130,000	130,000	130,000													
MTM, MIE	IV.3 Përgatitja e një inventari për të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme regjistruara	Futja e legjislatcionit për të kërkuar nga të gjitha ndërmarrjet tregtare të vogla dhe të mesme që të raportojnë për përdorimin e tyre të energjisë dhe llojin e lëndës djegëse që përdoret për të bërë të mundur kryerjen e një vlerësimi për shkarkimet ndotëse	Pas 2022																	
Subtotal	0																			
Total Masa IV	15,437,200			15,437,200	15,437,200	15,437,200	15,437,200													
<b>V. Masat për reduktimin e shkarkimeve nga burimet pikësore</b>																				
MTM	V.1 Vendosja e lartësisë minimale nga toka për oxhaqet dhe shtëllungat në të gjitha instalimet me leje të tipit A	Përcaktimi i teknikave më të mira të mundshme TMM (TMM) për kategoritë e aktivitetëve të tipit A, ose për një instalim të veçantë		24,722	24,722	24,722	24,722													
MTM, ISHMP		Përcaktimi dhe zbatimi i një programi vjetor të kontrollit të shkarkimeve nga impiantet industriale subjekti të lejes së tipit A		16,267	16,267	16,267	16,267													
MTM/ISHMP MP		Verifikimi dhe kontrolli i të gjitha instalimeve industriale të tipit A.		24,011	24,011	24,011	24,011													
Subtotal	65,000			65,000	65,000	65,000	65,000													
MTM/AKM	V.2 Rishikimi i kushteve të lejes për instalimet ekzistuese të tipit A ose B	Verifikimi nëse të gjithë operatorët e një instalimi ekzistues të tipit A ose B, kanë dorëzuar kërkesën për rishikimin e kushteve të licencës ekzistuese në AKM-ë përmes QKB-së		46,195	46,195	46,195	46,195													
		Rishikimi e kushteve për të gjitha lejet e Tipit A dhe B	Produktet do të specifikohen dhe kostohen në Planet lokale të Vëprimit për Cilesinë e Ajrit nga NJQV	148,805	148,805	148,805	148,805													
Subtotal	195,000			195,000	195,000	195,000	195,000	0	0	195,000	0	13,400	30,560	34,000	34,600	26,535	27,000	28,905		
MIE/MTM/MFE	V.3 Ndihmesa e biznesit (a) për të minimizuar ndikimin negativ në miedis nga operacionet e tyre që shkaktojnë ndotje në ajër, ujë	Promovimi për pajisjen me certifikatën e cilësisë së mjedisit ISO 14000 midis komunitetit të biznesit		195,000	195,000	195,000	195,000													
		Iniciativa për zbatimin e të gjitha zgjidhjeve të mundshme për të reduktuar shkarkimet nga oxhaqet	Produktet do të specifikohen në Planet Lokale	1,105,000	1,105,000	1,105,000	1,105,000													



		ose tokë); (b) për të qenë në përputhje me ligjet e aplikueshme, rregulloret dhe kërkesat e tjera të orientuara për njeësin, dhe (c) për t'u përmirësuar vazhdimisht sa më sipër.																			
	Subtotal	1,300,000				1,300,000	1,300,000	1,300,000	1,300,000	-	-	1,300,000	-	-	52,000	57,900	61,000	67,000	158,100	904,000	
	Total Masa V	1,560,000						260,000			1,300,000										
		VI. Masat për forcimin e inspeksionit dhe kapaciteteve monitoruese																			
MTM, AKM	VI.1 Modernizimi dhe përmirësimi i rrjetit monitorimit	VI.1 Modernizimi dhe përmirësimi i rrjetit monitorimit	Rrjeta e numrit të stacioneve të monitorimit automatik me të paktën blerjen e 10 stacioneve të reja, gjetjen e pajisjeve për vendet e reja, pikat e nxehta që nuk monitorohen aktualisht	Numri i stacioneve të monitorimit të situara, do të përcaktohet pas Planeve Lokale të Ajrit për secilin nga Zonat		527,609	527,609	105,522	105,522		316,565	316,565							105,522	105,522	316,565
			Rishikimi dhe përshtatja e rrjetit të monitorimit të tanishëm			3,900	3,900	3,900	3,900			3,900							3,900		
			Zbatimi i procedurave të kalibrimit me furnizimin e një kalibratori portativ (tub dopërimi dhe hollimi)			11,700	11,700	11,700	11,700						3,500	4,200	5,000	7,400		100	00
			Ofrimi i kurseve të trajnimit teknik, për të përmirësuar kalibrimin dhe mirëmbajtjen për stafin e AKM-së					4,186	4,186			4,186	4,186				2,000	2,186			
			Ofrimi i trajnimeve për stafin e AKM-së në analizimin, raportimin dhe prezantimin e të dhënave					13,585	3,585		10,000	10,000					3,585	5,000	5,000		
			Shqyrtimi dhe rregullimi i klasifikimit të zonave kritike të territorit në baza vjetore			12,010	12,010	12,010	12,010								2,500	3,500	3,800		2,210
			Përgatitja dhe publikimi i parashikimeve afatshkurtra (24-48 orë) të përqendrimeve të ndotësve kryesorë, përmes modeleve të simulimit			12,010	12,010	12,010	12,010								2,800	3,000	3,500		2,710
	Subtotal	603,400					585,000	149,328	148,727	-	330,751	334,651	-	-	3,500	15,085	18,686	129,122	120,442	316,565	
MTM/AKM	VI.2 Krijimi i Sistemit të Inventarit Kombëtar të Shkarkimeve	VI.2 Krijimi i Sistemit të Inventarit Kombëtar të Shkarkimeve	Percaktimi i procesit të përgatitjes së inventarit; baza për vlerësimin e shkarkimeve; mbledhja e të dhënave; përgatitja e të dhënave dhe logaritmi dhe shkarkimeve; raportimi dhe arkivimi			11,700	11,700	11,700	11,700								5,600	6,100			
			Vendosja e tavaneve të shkarkimeve për sektorët qëndrorë (në energjisë, industrisë, transportit, bujqësisë dhe strehimit) për ndotësit e mëposhtëm: (SO <sub>2</sub> ), oksidet e azotit (NO <sub>x</sub> ), komponimet organike të avullueshme (VOC) dhe amoniakut (NH <sub>3</sub> )			11,700	11,700	11,700	11,700						2,000	3,600	6,100				
			Krijimi i kapaciteteve për raportim të rregullt të shkarkimeve hapësinore, siç kërkohet, sipas Udhëzimit të Raportimit të Emeltimeve për Palatë në Konventën LRTAP			9,100	9,100	9,100	9,100						2,100	2,500	3,000	1,500			
			Hartimi i programeve për reduktimin progresiv të shkarkimeve të ndotësve kombëtare.																		
	Subtotal	32,500				32,500	32,500	32,500	32,500	-	-	-	-	-	4,100	11,700	15,200	1,500	-	-	
MTM dhe ISHMP	VI.3 Sigurimi që inspeksioni dhe zbatimi i legjislacionit, që lidhet me cilësinë e ajrit, është proporcional dhe efikas	VI.3 Sigurimi që inspeksioni dhe zbatimi i legjislacionit, që lidhet me cilësinë e ajrit, është proporcional dhe efikas	Intensifikimi i forcimit të inspeksioneve periodike të tymit të të gjitha sistemeve të ngrohjes civile (sistemet e ngrohjes, tubat dhe oqazet, etj)			84,073	84,073	84,073	84,073					2,000	12,600	22,800	23,200	23,473			
MTM dhe ISHMP			Sigurimi i inspektorëve me pajisjet matëse portative			45,927	45,927	45,927	45,927							10,000	15,000	17,000	3,927		
	Subtotal	130,000				130,000	130,000	130,000	130,000	-	-	-	-	2,000	12,600	32,800	38,200	40,473	3,927	-	
	total masa VI	765,900										334,651									
<b>VII. Masat për përmirësimin e ndërgjegjësisimit të publikut</b>																					
MTM, MASR, NJQV	VII.1 Promovimi i programeve arsimore nbi çështjet që lidhen me kontrollin dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër për të përmirësuar cilësinë e ajrit	VII.1 Promovimi i programeve arsimore nbi çështjet që lidhen me kontrollin dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër për të përmirësuar cilësinë e ajrit	Ndërmarrja e programeve promovuese dhe edukative që synojnë individët dhe shkollat. Rolet e tyre në ndihmën për të përmirësuar cilësinë e ajrit të ambientit brenda fushës së Planetit, do të theksohen përmes përdorimit të fletushkave informative dhe emisioneve në radio dhe televizion. Çështje të cilat do të mbulojnë në programe të tilla, do të përfshijnë ndryshimin nga lëndë djegëse të ngurta- në lëndë djegëse të pastra, që shkaktojnë ndotje të ulët, ruajtjen e energjisë në shtëpi, përdorimin e metodave alternative të transportit në vend të makinave private, fushata për të nxitur ruajtjen më të mirë të makinave dhe miratimin e teknikave më të mira lëvizëse, për të reduktuar shkarkimet e autoriteteve	Programe promovuese dhe edukative të ndërmarrja (do të përcaktohen nga NJQV në planet e tyre të cilësisë së ajrit)																	
			Publikimi i të dhënave të monitorimit të ndotjes së ajrit nga rrjetet e tyre respektive, për të qenë në dispozicion të publikut të gjerë, përmes mediave dhe internetit. Në rast të cilësisë së dobët të ajrit të	Të dhëna të publikuara		17,844	17,844	17,844	17,844								7,000	10,844			





**VENDIM**

Nr. 421, datë 26.6.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 175, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE MËSIMORË DHE TË PUNONJËSVE TË TJERË JOMËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në lidhjen nr. 1, “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar”, që përmendet në pikën 2, të vendimit nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në rreshtat me numrat rendorë 13 dhe 14, fjalët “... ciklin e ulët ...” zëvendësohen me “... arsimin fillor ...”.

2. Rreshti me numrin rendor 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2019.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

**Erion Braçe**

15	Mësues në arsimin fillor në shkollat 9-vjeçare	3	2% e PG	5% e PG 10% e PG 15% e PG	34.000
	Instruktor i praktikës profesionale				

**VENDIM**

Nr. 423, datë 26.6.2019

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 5.3.2019, PËR ÇËSHTJEN “RINALDO MYRTAJ DHE TË TJERËT KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR KËRKESËN NR. 62907/16)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e

vitit 2019”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 5.3.2019, për çështjen “Rinaldo Myrtaj dhe të tjerët kundër Shqipërisë”, në shumën 39 000 (tridhjetë e nëntë mijë) euro për kërkuesin Rinaldo Myrtaj; 39 000 (tridhjetë e nëntë mijë) euro për kërkuesen Mamude Myrtaj; 15 600 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro për kërkuesin Ilmi Deda; dhe 10 000 (dhjetë mijë) euro për kërkuesen Alma Rredhi.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku depozitohen shumat, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesve Rinaldo



Myrtaj, Mamude Myrtaj, Ilmi Deda dhe Alma Rredhi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 5.3.2019, për çështjen “Rinaldo Myrtaj dhe të tjerët kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 62907/16.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të kërkuësve Rinaldo Myrtaj, Mamude Myrtaj, Ilmi Deda dhe Alma Rredhi të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit.

5. Mbi shumën e mësipërme, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, duke filluar nga data 28.6.2019 deri në datën e ekzekutimit të këtij vendimi, të paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

**VENDIM**  
Nr. 425, datë 26.6.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES  
PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË  
PRIVATE, QË PREKEN NGA  
REALIZIMI I PROJEKTIT  
“RIKONSTRUKSION DHE ASFALTIM I  
RRUGËS MARQINET-1 DHE LAGJJA  
“LLANAJ””, NË BASHKINË E VORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Marqinet-1 dhe Lagjja “Llanaj””, në Bashkinë e Vorës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “tokë bujqësore”, me sipërfaqe 719.2 m<sup>2</sup>, me vlerë të përgjithshme prej 322 201 (treqind e njëzet e dy mijë e dyqind e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 322 201 (treqind e njëzet e dy mijë e dyqind e një) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Vorë, planifikuar në buxhetin e saj me vendim të këshillit bashkiak.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë dhe të përfundojë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi pasi të kenë paraqitur pranë Bashkisë Vorë certifikatën e pronësisë, hartën treguese të regjistrimit si dhe kartelën e pasurisë.

8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Vorë të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vorë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Vorë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.



11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR  
Erion Braçe**

**Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit: “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Marqinet-1 dhe Lagjja Llanaj”  
Bashkia Vorë**

Nr.	Emri, Mbiemri (Pronari që shpronësohet)	Zona Kadastrale	Lloji i pasurisë	Numri kadastral	Sipërfaqja që shpronësohet/m <sup>2</sup>	Çmimi i tokës bujqësore/ lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e përgjithshme e shpronësimit	Shënime
1	Rexhep Islam Ismaili	2605	"tokë bujqësore"	310/15	465	448	208320	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Fadil Ymer Ismaili	2605	"tokë bujqësore"	308/6	73.2	448	32793	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Ismail Ramazan Ismaili	2605	"tokë bujqësore"	311/45	181	448	81088	Konfirmuar nga ZVRPP
	<b>Shuma</b>				<b>719.2</b>		<b>322 201</b>	

**VENDIM  
Nr. 426, datë 26.6.2019**

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT, TË FUNKSIONIMIT, SI DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KOMITETEVE SEKTORIALE DHE MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 11, të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Komitetet sektoriale, të krijuara me ligjin nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, të ndryshuar, organizohen në formën e grupeve teknike për çdo sektor, jo më shumë se 10 komitete, me përbërje jo më shumë se 10 (dhjetë) anëtarë, përfaqësues të sektorit publik e privat, si më poshtë vijon:

a) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;

b) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional;

c) Një përfaqësues nga ministria/të përgjegjëse për sektorin/ët përkatës të veprimtarive ekonomike;

ç) Një përfaqësues nga shoqatat e punëdhënësve të sektorit përkatës, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;

d) Një përfaqësues nga shoqatat e punëmarrësve të sektorit përkatës, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;

dh) Një përfaqësues nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional (AFP) të sektorit përkatës, me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve në sektorin përkatës;

e) Një përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin përkatës;

ë) Një deri në tre ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të komitetit sektorial janë, si më poshtë vijon:

a) Anëtarët e komitetit sektorial, përfaqësues sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “dh”, të pikës



1, të këtij vendimi, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i. Të jenë njohës të mirë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në vijim KSHK;

ii. Të kenë përvojë të provuar për zhvillimin dhe zbatimin e KSHK-së;

iii. Të jenë njohës të mirë të sektorit përkatës.

b) Anëtarët e komitetit sektorial, përfaqësues sipas shkronjave “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij vendimi, përveç kriterëve të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, duhet të kenë eksperiencë të provuar, të paktën 3 (tre) vjet në sektorin përkatës.

3. Anëtarët e komiteteve sektoriale zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje dhe në rast zëvendësimi, anëtari vazhdon mandatin e paraardhësit.

4. Përzgjedhja e anëtarëve të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij vendimi, bëhet nga ministria përgjegjëse respektive, bazuar në plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.

5. Përzgjedhja e anëtarëve të parashikuar në shkronjat “ç”, “d”, “e” dhe “ë”, të pikës 1, të këtij vendimi, për anëtar të Komitetit Sektorial, kryhet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në vijim AKAFPK. Kjo e fundit, në përzgjedhjen e kandidatit bazohet në plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, si dhe meritës, sipas dokumentacionit të depozituar pranë saj nga kandidatët.

6. Në rast nevoje, në komitetin sektorial mund të përfshihen më shumë se një ekspert, të parashikuar në shkronjën “ë”, të pikës 1, të këtij vendimi, pa tejkalluar në çdo rast numrin prej 10 (dhjetë) anëtarësh të komitetit sektorial.

7. Në mbledhjet e komitetit sektorial mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, të institucioneve të arsimit të lartë etj. Pjesëmarrja në këto takime mund të bëhet në kuadrin e ftesës së bërë për këtë qëllim dhe/apo interesit të shprehur me shkrim nga ana e institucioneve të interesuara.

8. Komiteti funksionon në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale shtetërore dhe enteve publike” dhe në bazë të rregullores së miratuar me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës

për arsimin dhe formimin profesional, e cila miratohet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga ngritja e komitetit sektorial përkatës, me propozim nga ky i fundit.

9. Kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të komitetit dhe, si rregull, duhet të jetë anëtari me më shumë eksperiencë në çështjet që trajton ky komitet dhe në zhvillimin e zbatimin e KSHK-së.

10. Veprimtaria e komitetit sektorial ushtrohet pranë AKAFPK-së dhe mbështetet nga sekretariati teknik, i cili përbëhet nga punonjës të AKAFPK-së, të përcaktuar me urdhër të titullarit të institucionit.

11. Sekretariati Teknik i Komiteteve Sektoriale është përgjegjës për mbështetjen administrative dhe organizative të komiteteve sektoriale, për mundësimin e ekspertizës së nevojshme për çështje të caktuara, si dhe lehtësimin e komunikimit të komiteteve sektoriale ndërmjet tyre dhe me institucionet e tjera. Rregullorja e funksionimit të sekretariatit teknik miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

12. Komiteti mblidhet rregullisht, të paktën 1 (një) herë në 3 (tre) muaj.

13. Ngritja dhe përbërja e komiteteve sektoriale miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe të ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional. AKAFPK-ja propozon sektorin/ët ekonomik/ë për të cilin/ët ngrihen komitetet sektoriale, në bazë të një analize të thelluar të zhvilluar për këtë qëllim dhe në bashkëpunim me partnerët socialë, duke angazhuar ekspertizën përkatëse për të zhvilluar analizat e kërkuara, nëse lind nevoja.

14. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje për çdo anëtar të komitetit sektorial bëhet sipas përcaktimeve të bëra në vendimin normativ të masës së shpërblimit të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore.

15. Funksionimi i komiteteve sektoriale dhe shpërblimi i anëtarëve të tyre përballohen nga buxheti i shtetit i miratuar për AKAFPK-në.

16. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit,



Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

**VENDIM**  
Nr. 427, datë 26.6.2019

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PËRFSHIRJEN E KUALIFIKIMEVE PËR TË NXËNIT GJATË GJITHË JETËS, SIPAS NIVELEVE TË KORNIZËS SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE, PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL<sup>8</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të nenit 6, të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i nivelit të kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës, me qëllim përfshirjen e tyre në nivelet përkatëse të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (në vijim, KSHK), për arsimin dhe formimin profesional, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë vendim.

2. Objekt i këtij vendimi janë kualifikimet për të nxënëit gjatë gjithë jetës, që ofrohen me jo më pak se 125 (njëqind e njëzet e pesë) orë ose 5

(pesë) kredite ECTS (për kualifikime të arsimit të lartë).

3. Të gjitha kualifikimet për të nxënëit gjatë gjithë jetës, sipas përcaktimeve në shtojcën nr.1, të ligjit për KSHK-në, për të cilat kërkohet nga ofruesi përcaktimi në diplomën/certifikatën përkatëse të nivelit të kualifikimit, sipas niveleve të KSHK-së, plotësojnë kriteret dhe procedurat e parashikuara në këtë vendim për përfshirjen e tyre në nivelin përkatës të KSHK-së.

4. Këtyre kualifikimeve u caktohet niveli i KSHK-së si rezultat i krahasimit të rezultateve të deklaruara të të nxënëit për kualifikimin e dhënë me përshkruesit e detajuar të niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

**KREU II**  
**KRITERET PËR PËRFSHIRJEN E KUALIFIKIMEVE SIPAS NIVELEVE PËRKATËSE TË KSHK-SË**

1. Vendimmarrja, që rezulton pas një procesi të vlerësimit të rezultateve të të nxënëit të kualifikimit me përshkruesit e niveleve të KSHK-së, për përfshirjen e kualifikimeve, objekt i këtij vendimi në KSHK, duke përcaktuar nivelin e kualifikimit nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, sipas fushës së përgjegjesisë, bazohet në plotësimin e kriterëve, si më poshtë vijon:

a) Të ketë të përcaktuar qartë titullin e kualifikimit;

b) Ofruesi i kualifikimit të jetë i licencuar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga autoriteti që mbulon fushën përkatëse të përgjegjesisë për të ofruar këtë lloj kualifikimi, si dhe të jetë i autorizuar për të ofruar kualifikimin për të cilin kërkohet përfshirja e kualifikimit sipas nivelit të KSHK-së, para fillimit të ofrimit të kualifikimit;

c) Të jetë përcaktuar numri total i krediteve (ku aplikohet)/ngarkesa mësimore në orë, si dhe kohëzgjatja e kualifikimit;

ç) Të jetë arsyetuar me të dhëna faktike nevoja e kualifikimit në tregun e punës;

d) Kualifikimi të bazohet në rezultatet e të nxënëit;

<sup>8</sup> Ky vendim është përafshuar pjesërisht me:

Rekomandimin e Këshillit të Evropës (2017 / C 189/03), datë 22 maj 2017, “Mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe shfuqizimin e rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2008, për themelimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës”.



dh) Kualifikimi të ketë qëllime dhe objektiva të qarta, të ofrojë mundësi për progres, si dhe të ketë mbështetje nga grupet e interesit;

e) Niveli i propozuar i kualifikimit në KSHK të përcaktohet në mënyrë të qartë sipas përshkruesve të detajuar të niveleve të KSHK-së dhe të shoqërohet me arsyetimin përkatës, i cili argumenton arsyen e pozicionimit të këtij kualifikimi në nivelin e propozuar, vlerësimin e rëndësisë së kualifikimit dhe njohjes së tij brenda sektorit përkatës të kualifikimit, prezantimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave më të gjera, sipas përshkruesve përkatës të detajuar të niveleve të KSHK-së;

ë) Kërkesat për nivelin minimal hyrës të kualifikimit, në një kualifikim të caktuar për të nxënëit gjatë gjithë jetës, të jenë të qarta dhe t'u referohen përcaktimeve në shtojcën nr.1, të ligjit të KSHK-së.

f) Në rastin e kualifikimeve të ofruara në zbatim të ligjit për arsimin dhe formimin profesional (në vijim, AFP), përshkrimi i kualifikimeve të jetë i bazuar në përshkruesit /standardet e profesioneve përkatëse;

g) Të ketë kritere të qarta të vlerësimit të arritjeve të individit në fund të kualifikimit për të nxënëit gjatë gjithë jetës;

gj) Dokumenti i lëshuar nga ofruesi që certifikon zotërimin e kualifikimit përkatës lëshohet vetëm pas arritjes së një rezultati pozitiv në vlerësimin e rezultateve të kërkuara të të nxënëit (vlerësimit), të përcaktuara e të miratuara për kualifikimin përkatës dhe që përputhen me nivelin e KSHK-së, miratuar për këtë kualifikim sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Ai duhet të cilësojë në mënyrë të qartë që i referohet një kualifikimi për të nxënëit gjatë gjithë jetës;

h) Të plotësojë kushtet e nevojshme për ofrimin e kualifikimit respektiv në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë dhe të ketë kaluar me sukses procesin e sigurimit të jashtëm të cilësisë.

### KREU III

#### OFRUESIT DHE DOKUMENTACIONI

1. Kualifikimet për të nxënëit gjatë gjithë jetës që përfshihen në KSHK ofrohen vetëm nga

institucionet e licencuara/të aprovuara dhe të akredituara për këtë qëllim.

2. Ofruese janë të gjitha ato subjekte juridike, publike e jopublike, të cilat kanë të parashikuar, në objektin e tyre të veprimtarisë, ofrimin e kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës, si dhe plotësojnë kriteret e parashikuara për këtë qëllim, në përputhje me këtë vendim dhe akte të tjera, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

3. Ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për arsimin e formimin profesional janë përgjegjës për mbikëqyrjen e ofrimit të kualifikimeve dhe sigurimin e cilësisë, sipas fushave respektive të përgjegjësisë. Nëse ngrihen dyshime për parregullsi lidhur me kriteret apo procedurat e ofrimit të kualifikimeve nga ofruesi, ministri përgjegjës urdhëron strukturat përkatëse të ministrisë dhe/ose agjencinë/entin akreditues, në varësi të parregullsive të vërejtura, të realizojë një verifikim *ad hoc* të ofruesit.

4. Ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional përcaktojnë me udhëzim të përbashkët procedurat e inspektimit, me qëllim garantimin e paanshmërisë në procesin e inspektimit. Raporti i inspektimit përfshin, veç të tjerave, edhe një përshkrim të fakteve të vërtetuara, duke përfshirë parregullsitë e gjetura, qëllimin, shkaqet dhe efektet e tyre, së bashku me emrat e funksionet e atyre që janë përgjegjës për shkaktimin e tyre dhe rekomandimet për veprime korrigjuese.

5. Aplikanti paraqet dokumentacionin ligjor, si më poshtë vijon:

a) Kopje të ekstraktit historik të subjektit nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), e cila të parashikojë në objektin e veprimtarisë ofrimin e kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës;

b) Dokument të licencimit/autorizimit të ofruesit për të operuar në ofrimin e kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës, si dhe licencë për të ofruar këtë lloj kualifikimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, lëshuar nga autoriteti që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë;

c) Vërtetime (për administratorin /administratorët dhe shoqërinë), që certifikojnë se subjekti nuk është në ndjekje penale nga organi i prokurorisë;

ç) Vetëdeklarim ose dëshmi penaliteti për administratorin/administratorët;



d) Të dhëna për burimet financiare, shoqëruar me dokument bankar që shpreh vlerën e burimeve financiare që subjekti juridik zotëron, si dhe burimet materiale, bibliotekare dhe informatike të nevojshme për programet e reja të studimit;

dh) Adresë e subjektit, adresë elektronike dhe numër telefoni.

6. Përshkrimi i kualifikimit dhe përshkruesit e profesionit me të cilin lidhet ky kualifikim në rastin e AFP-së e në rastet e tjera ku parashikohet, përfshijnë:

a) titullin e kualifikimit;

b) argumentimin e nevojës për kualifikim në kontekstin e tendencave në tregun e punës, zhvillimin e teknologjive të reja dhe nevojave sociale;

c) emërtimin e dokumentit që lëshohet në përfundim të tij dhe vlefshmërinë;

ç) modelin e diplomës/certifikatës që do t'i lëshohet individit që ka përfunduar me sukses kualifikimin nga ofruesi;

d) në rast se parashikohet që kualifikimi për të nxënit gjatë gjithë jetës ofrohet përmes një programi studimi të përbashkët me institucione të tjera vendase apo të huaja, paraqitet një dokument zyrtar bashkëpunimi, si dhe dokumenti zyrtar i akreditimit të institucionit bashkëpunues, nëse ka;

dh) përshkrimin e përgjithshëm e të detajuar të kualifikimit, duke përfshirë të dhëna për planin mësimor dhe tërësinë e rezultateve të të nxënit në njohuri, aftësi dhe kompetenca më të gjera, që duhen arritur në përfundim të kualifikimit, objektivat e qëllimet e shprehura qartë, sipas përshkruesve të detajuar të niveleve të KSHK-së, mundësitë për progres të mëtejshëm, mbështetjen nga grupet e interesit, kriteret e vlerësimit të arritjeve të individit në përfundim të kualifikimit etj.;

e) ngarkesën e përafërt mësimore, të përcaktuara në orë e kredite ECTS (në rastin e kualifikimeve të ofruara në sistemin e arsimit të lartë), të nevojshme për të marrë kualifikimin;

ë) kërkesat për pranimin e individit në kualifikimin përkatës, në veçanti niveli i arsimimit të kërkuar, referuar përcaktimeve në shtojcën 1 të ligjit për KSHK-në;

f) në rastin e AFP-së dhe në rastet e tjera ku parashikohet, përshkrimin e profesionit, duke

përfshirë kodin përkatës të listës kombëtare të profesioneve, si dhe një listë të detajuar të funksioneve/detyrave dhe informacione të tjera të nevojshme që lidhen me profesionin;

g) mundësitë tipike të përdorimit të kualifikimit;

gj) rregulloren e funksionimit të programit përkatës të kualifikimit;

h) propozimin e nivelit të KSHK-së, duke përfshirë arsyetimin përkatës, i cili argumenton arsyen e pozicionimit të këtij kualifikimi në nivelin e propozuar, vlerësimin e rëndësisë së kualifikimit dhe të njohjes së tij brenda sektorit përkatës të kualifikimit, korrespondencën e njohurive, aftësive dhe të kompetencave më të gjera të deklaruara;

i) fushën respektive të kualifikimit sipas ISCED 2013-F;

j) Kopjen e mandatit të pagesës;

Për kualifikimet për të nxënit gjatë gjithë jetës, që parashikohen në nivelet 5-8 në fushën e arsimit të lartë, dokumenti që provon akreditimin e ofruesit dhe të programit përkatës të kualifikimit dorëzohet përpara përfundimit të procedurave për përfshirjen e kualifikimeve sipas niveleve të KSHK-së, për arsimin dhe formimin profesional.

#### KREU IV INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE DHE PROCEDURAT QË NDIQEN NGA OFRUESIT

1. Institucionet përgjegjëse për përcaktimin e niveleve të KSHK-së për kualifikimin përkatës përmes procesit të verifikimit të rezultateve të të nxënit me përshkruesit e niveleve janë:

a) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve;

b) Ministria përgjegjëse për arsimin për nënsektorin e arsimit të lartë dhe arsimin e përgjithshëm.

2. Institucionet përgjegjëse për ndjekjen e procedurave për përcaktimin e nivelit të KSHK-së për kualifikimin përkatës janë, si më poshtë vijon:

a) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) për nënsektorin e arsimit dhe formimit profesional;





b) Qendra e Shërbimeve Arsimore për nënsektorin e arsimit të lartë dhe arsimin e përgjithshëm.

3. Për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës në KSHK ngrihet komisioni për përfshirjen e kualifikimeve, objekt i këtij vendimi, nga institucionet përgjegjëse për secilin nënsektor të KSHK-së.

4. Komisioni asistohet nga sekretariati teknik me anëtarë nga institucionet përgjegjëse për ndjekjen e procedurave.

5. Institucionet përgjegjëse për përcaktimin e nivelit të KSHK-së bashkëpunojnë për përgatitjen e rregullores përkatëse për funksionimin e komisionit e të aplikimit dhe u propozojnë ministrave përgjegjës për arsimin dhe arsimin e formimin profesional draft-rregulloren për miratim. Rregullorja miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin dhe të ministrit përgjegjës për arsimin e formimin profesional, jo më vonë se 1 (një) vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Aplikimi për të përfshirë kualifikimet e të nxënit gjatë gjithë jetës në KSHK, për të përcaktuar nivelin përkatës, bëhet me anë të një kërkesë drejtuar institucioneve përgjegjëse për këtë qëllim, sipas këtij vendimi, e cila shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në këtë vendim.

7. Komisioni, pasi merr në shqyrtim informacionin e përcjellë nga aplikanti, kthen përgjigje brenda 1 (një) muaji, për përfshirjen e kualifikimit, objekt i këtij vendimi në KSHK, refuzimin e kërkesës apo plotësimin e dokumentacionit. Pas kërkesës për plotësim dokumentacioni, nëse dokumentacioni rezulton sërish i paplotë, praktika arkivohet dhe aplikanti riaplikon sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

8. Komisioni shprehet me vendim në rastet e vendimmarrjes për pranimin, refuzimin e kërkesës apo arkivimin e praktikës. Institucionet përgjegjëse për ndjekjen e procedurave, sipas këtij vendimi, përgatisin vërtetimin për përcaktimin e nivelit përkatës të KSHK-së për çdo aplikim. Në çdo rast njoftohet aplikuesi dhe, në rast të refuzimit të kërkesës, i jepen edhe arsytet përkatëse.

9. Niveli i miratuar i kualifikimit dhe numri e lloji i krediteve të fituara (kur këto janë të miratuara) vendosen në dokumentin vërtetues që

do të lëshohet në përfundim të kualifikimit, duke specifikuar llojin e kualifikimit sipas shtojcës nr. 1 të ligjit për KSHK-në.

10. Kualifikimet për të nxënit gjatë gjithë jetës, së cilave i është përcaktuar niveli sipas KSHK-së, përfshihen në regjistrin kombëtar për kualifikimet për të nxënit gjatë gjithë jetës, i cili hartohet, administrohet e mirëmbahet, sipas fushës së përgjegjesisë, nga institucionet respektive përgjegjëse. Nëse kualifikimet, objekt i këtij vendimi, nuk ofrohen për një periudhë 4-vjeçare nga momenti i përcaktimit të nivelit të KSHK-së, ato hiqen nga regjistri kombëtar i sipërcituar. Për kualifikimet, objekt i këtij vendimi, për të cilat kryhen ndryshime të kriterëve të deklaruara në momentin e përcaktimit të nivelit të KSHK-së, ofruesi aplikon, jo më vonë se 1 (një) muaj nga ndryshimi i kriterëve, për ripërcaktimin e nivelit sipas KSHK-së, sipas parashikimeve të këtij vendimi, duke përcjellë ndryshimet, përfshirë dokumentacionin e arsytimit përkatës justifikues. Në rast të kundërt, kualifikimi i ofruar nga ky ofrues hiqet nga regjistri kombëtar.

11. Kualifikimet për të nxënit gjatë gjithë jetës, së cilave i është përcaktuar niveli sipas KSHK-së dhe janë bërë pjesë e regjistrit kombëtar sipas ofertuesve, hiqen nga ky regjistër, përveç sa është parashikuar më sipër dhe në këto raste:

a) Vlerësim negativ në procesin e sigurimit të cilësisë. Në këtë rast, institucioni/enti përgjegjës për sigurimin e jashtëm të cilësisë njofton institucionet përgjegjëse, sipas fushës përkatëse të përgjegjesisë, për të ndjekur procedurat për heqjen e kualifikimit nga regjistri kombëtar i kualifikimeve;

b) Ofruesi lëshon diploma/certifikata për persona, të cilët nuk janë vlerësuar pozitivisht;

c) Vërehen parregullsi në ofrimin e kualifikimit në vijim të një inspektimi ose vlerësimi të jashtëm;

d) Ofruesi nuk ka marrë masa korrigjuese pavarësisht rekomandimeve të dhëna;

e) Ofruesi nuk plotëson më kushtet e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi për ofrimin e kualifikimeve dhe ushtrimin e aktivitetit.

12. Procedura për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës në KSHK nuk



zgjat më shumë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës së aplikantit.

#### KREU V

#### NJOHJA E KREDITEVE/REZULTATEVE TË TË NXËNIT DHE SIGURIMI I CILËSISË

1. Kreditet ECTS të përfituara përmes kualifikimeve për të nxënë gjatë gjithë jetës, së cilave i është përcaktuar niveli i KSHK-së, njihen në kuadër të kualifikimeve të ngjashme të të nxënë gjatë gjithë jetës të të njëjtit nivel të KSHK-së apo në kuadër të programeve të studimit të arsimit të lartë të të njëjtit nivel të KSHK-së.

2. Rezultatet e të nxënë të përfituara përmes kualifikimeve për të nxënë gjatë gjithë jetës, së cilave i është përcaktuar niveli i KSHK-së e që nuk ofrohen me kredite ECTS, njihen në kuadër të kualifikimeve të ngjashme për të nxënë gjatë gjithë jetës të të njëjtit nivel të KSHK-së apo në kuadër të kualifikimeve të tjera të të njëjtit nivel të KSHK-së, të cilat nuk ofrohen me ECTS.

3. Njohja, sipas përcaktimeve të pikave të sipërcituara, bëhet mbi bazën e vlerësimit të rezultateve të të nxënë me programin e studimit për të cilin kërkohet të bëhet njohja.

4. Ofruesi përfundon procesin e sigurimit të cilësisë përpara lëshimit të diplomave/certifikatave të kualifikimit përkatës, i cili parashikon sigurimin e brendshëm e të jashtëm të cilësisë, në përputhje me standardet evropiane të cilësisë të arsimit të lartë (*Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area - European Standards and Guidelines, ESG*), standardet e sigurimit të cilësisë në arsimin dhe formimin profesional (*European Quality Assurance in Vocational Education and Training, EQAVET*) dhe linjat guidë për vlerësimin (*European Guidelines for validating non-formal and informal learning (CEDEFOP 2009)*).

5. Sigurimi i brendshëm i cilësisë nga ofruesi kryhet përmes sistemit të brendshëm të ngritur të sigurimit të cilësisë, që përcakton qartë rregullat e operimit, procedurat, metodologjinë dhe organizimin e këtij sistemi. Qëllimi i sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në institucionin ofrues është të sigurojë që vlerësimi e certifikimi kryhen siç duhet dhe se ato përmirësohen në vazhdimësi.

6. Sistemi i sigurimit të jashtëm të cilësisë monitoron e vlerëson në mënyrë periodike aktivitetet që lidhen me lëshimin e dokumentit që certifikon zotërimin e kualifikimit dhe kryhet nga një autoritet/ent i jashtëm nga ai ofrues, në përputhje me përcaktimet në kuadrin ligjor në fuqi. Ky autoritet/ent vlerëson ofrimin e kualifikimit sipas standardeve përkatëse dhe asiston ofruesin në përmirësimin e proceseve të vlerësimit e të certifikimit.

7. Në procesin e sigurimit të jashtëm të cilësisë së kualifikimeve të arsimit të lartë mund të angazhohen enti/agjencia publike përkatëse e ngarkuar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, sipas nivelit e llojit të kualifikimit ose ente/agjenci publike homologe të huaja të regjistruara në EQAR. Ministri përgjegjës për arsimin e ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional përcaktojnë me urdhër të përbashkët listën e enteve të huaja të autorizuara për këtë qëllim, sipas fushës së përgjegjësisë.

8. Sigurimi i jashtëm i cilësisë për kualifikimet për të nxënë gjatë gjithë jetës në fushën e arsimit të lartë duhet të mbajë parasysh, si më poshtë vijon:

a) Akreditimi i programit të studimit duhet të përfshijë, veç të tjerave, dhe:

i. vlerësimin e kongruencës së rezultateve të të nxënë të kualifikimit të ofruar me përshkruesit përkatës të niveleve të KSHK-së;

ii. aftësinë për të arritur këto rezultate të të nxënë, duke pasur parasysh kushtet ku ofrohet programi;

iii. përshtatshmërinë e vlerësimit (validimit) të rezultateve të të nxënë.

b) Akreditimi institucional duhet të konsiderojë, veç të tjerave, dhe:

i. funksionimin e përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë;

ii. akreditimet e certifikimet e marra nga institucione ndërkombëtare nga ofruesi ose strukturat përbërëse të tij;

iii. rezultatet e akreditimit të mëparshëm të programeve.

9. Sigurimi i jashtëm i cilësisë duhet të marrë në konsideratë, veç të tjerave, dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga ana e ofruesit, si dhe të respektimit të kriterëve e të dokumentacionit të parashikuar në momentin e licencimit.



10. Për kualifikimet, të cilat shprehin dhe numrin e krediteve ECTS, për akreditimin e kualifikimit e të ofruesit, aplikohen gjithashtu dhe kriteret e standardet e cilësisë të parashikuara për programet e studimit dhe institucionet e arsimit të lartë. Me përfundimin me sukses të procedurave për akreditimin dhe përcaktimin e nivelit sipas KSHK-së, ofruesi parashikon në diplomë/certifikatë dhe numrin e krediteve ECTS e të dhënat për vendimin përkatës të akreditimit.

11. Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë për kualifikimet për të nxënëit gjatë gjithë jetës për nivelet 2-5 të KSHK-së, në fushën e përgjegjësisë së arsimit dhe të formimit profesional, kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.

12. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë është i detyrueshëm dhe periodik.

13. Ministri përgjegjës për arsimin ose ministri përgjegjës për arsimin e formimin profesional, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë, kryejnë verifikime të agjencisë/entit akreditues lidhur me zbatimin e detyrimeve që lidhen me procesin e sigurimit të jashtëm të cilësisë. Në rast të evidentimit të parregullsive, i kërkohet agjencisë/entit akreditues të korrigjojë parregullsitë ose procedohet me heqjen nga lista përkatëse.

14. Ofruesit derdhin tarifën si më poshtë në llogarinë e institucioneve përgjegjëse, të përcaktuara sipas këtij vendimi, për trajtimin e kërkesave të ofruesve për përfshirjen e kualifikimeve, objekt i këtij vendimi, në KSHK:

a) Tarifa për trajtimin, shqyrtimin e kërkesës dhe përfshirjen e kualifikimit, objekt i këtij vendimi në KSHK, është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për kualifikimet me kohëzgjatje deri në 6 (gjashtë) muaj/30 (tridhjetë) kredite ECTS dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për kualifikimet me kohëzgjatje mbi 6 (gjashtë) muaj/30 (tridhjetë) kredite ECTS;

b) Ofruesit i paguajnë një tarifë vjetore, prej 3% të të ardhurave që sigurohen nga tarifën e aplikuarë për kualifikimet për të nxënëit gjatë gjithë jetës, institucionit përgjegjës për ndjekjen e procedurave për përcaktimin e nivelit, sipas KSHK-së, për të mundësuar trajtimin e çështjeve të ndryshme që kanë lidhje me vlerësimin

periodik, shërbimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit kombëtar të kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës dhe të programit të aplikimit *on-line*.

15. Tarifa për trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesës për përfshirjen e ofruesve në listën e ofruesve të certifikuar për ofrimin e kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës dhe sigurimin e cilësisë miratohen më urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe të ministrit përgjegjës për financat.

## KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për kualifikimet për të nxënëit gjatë gjithë jetës, të ofruara si kurse të unifikuara të formimit profesional nga subjektet publike në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, përmbajtja e të cilave zhvillohet nga AKAFPK-ja, bazuar në një cikël të brendshëm të sigurimit të cilësisë, paraqitet vetëm dokumentacioni i parashikuar në këtë vendim e përjashtohen nga tarifën.

2. Ministritë përgjegjëse për menaxhimin e KSHK-së, sipas fushës së përgjegjësisë, jo më vonë se 1 (një) vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përshtatin kuadrin ligjor në fuqi për licencimin dhe akreditimin e ofruesve dhe të kualifikimeve, me kriteret dhe procedurat përkatëse për të licencuar/aprovuar e akredituar institucionet ofruese dhe kualifikimet, objekt i këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe ofruesit e kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**



## VENDIM

Nr. 428, datë 26.6.2019

**PËR MIRATIMIN E TABELËS SË  
PËRSHKRUESVE TË DETAJUAR PËR  
ÇDO NIVEL TË KORNIZËS SHQIPTARE  
TË KUALIFIKIMEVE<sup>9</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Miratimin e tabelës së përshkruesve të detajuar për çdo nivel të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**

<sup>9</sup> Ky vendim është përfaqësuar pjesërisht me:

Rekomandimin e Këshillit të Evropës (2017 / C 189/03), datë 22 maj 2017, “Mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe shfuqizimin e rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2008 mbi themelimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të nxënësit gjatë gjithë jetës”.



SHTOJCA NR. 1  
PËRSHKRUESIT E DETAJUAR TË NIVELEVE TË KORNIZËS SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE  
(KSHK)

Nivelet e KSHK	Njohuri	Aftësi	Kompetenca
8	<p>Zotërimi i krijimit dhe i interpretimit të njohurive të reja, nëpërmjet dijeve të thelluara, të një cilësie të tillë që të përmbushë kërkesat e thelbit të disiplinës dhe të publikimeve të nivelit të lartë<sup>10</sup>; Përdorimi i njohurive të specializuara për të analizuar, vlerësuar dhe përmbledhur ide të reja dhe komplekse që janë më të avancuarat në atë fushë.</p> <p>Zotërimi i përvetësimit sistematik dhe i të kuptuarit të trupit themelor të njohurive, të cilat janë thelbi i një discipline akademike ose i një fushe profesionale.</p> <p>Zotërimi i të kuptuarit dhe zbatimit i metodave dhe i teknikave më të avancuara në fushën apo në fushat e ekspertizës në kërkim shkencor<sup>11</sup>.</p>	<p>Aftësi të përgjithshme dhe të thelluara për konceptimin dhe realizimin me integritet të një projekti për generimin e njohurive të reja;</p> <p>Cilësi të transferueshme, të cilat kërkojnë ushtrimin e përgjegjësive personale dhe të nismave gjerësisht autonome në situata komplekse dhe kritike, të nevojshme për punime shkencore dhe inovacion.</p> <p>Aftësi për të dhënë një kontribut përmes hulumtimit origjinal që tenton të arrijë kufirin e njohurive duke zhvilluar një punë themeltare, disa prej të cilave meritojnë publikime në rrafsh kombëtar apo ndërkombëtar.</p> <p>Aftësi për analizë kritike, vlerësim dhe sintezë të ideve komplekse, si dhe komunikim me homologët dhe me komunitetin shkencor e akademik në përgjithësi, në fushën përkatëse të ekspertizës; promovimi në kontekstin akademik dhe profesional të zhvillimeve sociale, kulturore apo teknologjike në një shoqëri që bazohet në dije.</p>	<p>Zbatimi i gjykimeve mbi çështje të fushave speciale, me efektivitet në mjedise me specialistë dhe jo specialistë të fushës; Komunikimi në nivel të lartë gjuhësor, si në gjuhën amtare ashtu edhe në një gjuhë të huaj, i rezultateve të përfutur prej punimeve me karakter themelor ose të zbatuar me kolegë homologë, duke u angazhuar dhe në dialog kritik dhe duke drejtuar dhe ngritur procese sociale komplekse</p> <p>Zhvillimi në nivel të lartë i teknikave, përsosja e metodikave të reja në fushën e ekspertizës dhe zhvillimi i ideve dhe i proceseve të reja në kuadër të punës apo studimit, përfshirë dhe kërkimin.</p>
7	<p>Zotërimi sistematik i dijeve teorike dhe praktike shumë të specializuara me vetëdije kritike të problemeve të ditës dhe/ose të vizioneve të reja, të cilat janë ose konsiderohen si themeli i disiplinave akademike, fushave të studimit apo lëmit profesional dhe që krijojnë bazat ose mundësitë për origjinalitetin në zhvillimin dhe/ose aplikimin e ideve, shpesh në kontekstin e kërkimit, dhe për ndërveprimin midis fushave të ndryshme;</p> <p>Zotërimi dhe të kuptuarit e plotë të teknikave të zbatuara në kërkimin shkencor ose në</p>	<p>Aftësi të menaxhimit të të mësuarit vetjak si edhe të përdorimit metodik të dijeve të fituara dhe të burimeve parësore;</p> <p>Aftësi të transferueshme, të nevojshme për punësim, që kërkojnë:</p> <p>ushtrimin e nismave dhe përgjegjësive personale, vendimmarrje në kontekste komplekse dhe të paparashikueshme, aftësi të pavarura të të mësuarit, të kërkua për vijimin e progresit profesional.</p>	<p>Trajtimi i problemeve komplekse në mënyrë sistematike dhe krijuese duke dhënë gjykime edhe në mungesë të të dhënave të plota. Komunikim në mënyrë të qartë dhe të rrjedhshme në gjuhën amtare dhe në një gjuhë të huaj përfundimet e nxjerra dhe metodologjinë në një mjedis me specialistë dhe jospécialistë të fushës duke përdorur teknikat e duhura;</p> <p>Shqyrton dhe reflekton mbi norma, marrëdhënie sociale dhe etike dhe vepron për t'i ndryshuar ato.</p> <p>Demonstron aftësi drejtuese dhe vetëmenaxhuese në përballje me zgjidhjen e problemeve, ndryshimet në një mjedis kompleks, si dhe të vepruarit në mënyrë autonome në planifikim dhe vënie në jetë të</p>

<sup>10</sup> Referencimet kundrejt EQF

<sup>11</sup> referencimet kundrejt QF - EHEA



	<p>fushën e dijeve të avancuara; Originalitet në zbatimin e njohurive së bashku me të kuptuarit praktik se si teknikat e stabilizuara në kërkimin shkencor përdoren për të krijuar e interpretuar njohuritë e disiplinës në situata të reja të panjohura në kontekst të gjerë të fushës përkatëse të studimit; Zotërimi i të kuptuarit themelor për vlerësimin me sy kritik të kërkimit shkencor të ditës dhe të dijeve të avancuara, vlerësimi i metodologjive e zhvillimi i kritikës e tij si edhe konceptimi dhe propozimi i hipotezave të reja.</p> <p>Njohuri të vlerësimit të pasigurisë, dyzimit dhe kufijve të dijeve të fituara.</p>	<p>Aftësi specifike në zgjidhjen e problemeve dhe ose në inovacion me qëllim zhvillimin e njohurive dhe të procedurave, si dhe integrimin e njohurive nga fusha të ndryshme.</p> <p>Të qenurit kritik mbi çështjet e njohurive në një fushë dhe mbi lidhjen ndërmjet fushave të ndryshme të tyre.</p> <p>Aftësi për të integruar dijet, menaxhuar situata komplekse, formuluar gjykime me të dhëna të pakët ose të paplota, por që përfshin reflektimin mbi përgjegjësitë sociale dhe etike që lidhen me aplikimin e njohurive dhe të gjykimeve të tyre.</p>	<p>detyrave në nivel profesional ose të barasvlershëm me të duke sjellë risi në fushën e punës dhe të studimeve, edhe kur çështja është komplekse, e paparashikuar dhe kërkon zgjidhje, duke integruar e përfshirë mjaft faktorë;</p> <p>Zbatimi i metodave dhe i teknikave, të përvetësuara, përditësimi, konsolidimi, zgjerimi dhe zbatimi i tyre si edhe nisja e udhëheqja e projekteve që mbështeten mbi to;</p> <p>Kryerja e vlerësimit, me sy kritik e të argumentuar, dhe hipoteza e koncepte abstrakte mbi të dhëna, për një problem të dhënë, si edhe dhënia e gjykimit dhe e zgjidhjeve të mundshme të tij.</p>
6	<p>Përdor njohuri praktike dhe teorike të detajuara të një fushe, ku pjesë e tyre janë të avancuara dhe përfshijnë të kuptuarin kritik të teorive dhe parimeve të mirëpërcaktuara të fushave të tyre të studimit dhe të mënyrave me të cilat ato parime janë zhvilluar;</p> <p>Njohuri të metodave kryesore të hulumtimit dhe vlerësim kritik i metodikave të ndryshme të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve në fushën e tyre të zbatimit;</p> <p>Njohuri të të kuptuarit të kufijve të proceseve dhe të procedurave si edhe ndikimi i tyre në analizat dhe interpretimet e mbështetura në fushat e tyre të zbatimit.</p>	<p>Cilësi dhe aftësi të transferueshme, të nevojshme për punësim, të cilët kërkojnë ushtrimin e disa përgjegjësi personale dhe vendim-marrëse;</p> <p>Aftësi të të kuptuarit dhe të zbatimit njohurive të fituara të tyre në mënyrë profesionale në përputhje me fushën e ekspertizës.</p> <p>Aftësi për të zbatuar konceptet mbështetëse dhe parimet jashtë kontekstit, në të cilin ata janë studiuar, duke futur, sa herë që është e përshtatshme, zbatimin e atyre parimeve, metodave dhe mjeteve nën një këndvështrim punësimi dhe për zgjidhjen e problemeve në fusha komplekse e specifike, duke krijuar dhe mbështetur argumentet për të zgjidhur problemet.</p>	<p>Përdorimi i një sërë teknikash të përcaktuara për të filluar dhe për të ndërmarrë analiza kritike të informacionit dhe propozimi i zgjidhjeve për probleme të paparashikuara të dala në pah nga ato analiza apo punë konkrete në këtë kontekst;</p> <p>Cakton synime administrative, menaxhon burime dhe ekupe, shfaq përgjegjësi në punë dhe në studime, që janë të paparashikuara dhe që kërkojnë zgjidhje problemesh ku bashkëveprojnë shumë faktorë. Shfaq krijimtari në hartimin e projekteve dhe iniciativë në menaxhimin e proceseve, që synojnë trajtimin e të tjerëve dhe rritjen e performancës së ekupeve.</p> <p>Komunikimi me efektivitet, në gjuhën amtare dhe në një gjuhë të huaj në një mjedis specialistësh ose jospecialistësh:</p> <p>i informacionit, me argumente dhe analiza të kryera në forma të shumëllojshme cilësore dhe sasiore,</p> <p>i teknikave çelës të disiplinave të ndryshme në fushat e tyre të zbatimit;</p> <p>i ideve, problematikave dhe zgjidhjeve përkatëse.</p> <p>Shpreh pikëpamje gjithëpërfshirëse dhe manifeston solidaritet me të tjerët për çështje të caktuara.</p> <p>Mbledh dhe interpreton të dhëna të rëndësishme për të dhënë gjykime që përfshijnë reflektimin në çështje të rëndësishme sociale, shkencore apo etike.</p> <p>Në mënyrë të vazhdueshme vetëzhvillon kompetencat ekzistuese me pikësynim marrjen përsipër të përgjegjësi të rëndësishme brenda strukturave të punësimit.</p>



5	<p>Përdor një sasi të konsiderueshme njohurish të specializuara të koncepteve dhe të parimeve, praktike dhe teorike, brenda një fushe pune dhe/ose studimi dhe dëshmon vetëdije për kufijtë e këtyre njohurive;</p> <p>Përdorimi, përpunimi dhe analiza e informacioneve specifike sasiore dhe cilësore të fushës së studimit dhe/ose punës;</p> <p>Demonstrimi i njohurive parimeve, teorive, metodologjive të aplikuara brenda fushës së studimit në një nivel të caktuar mbështetur në libra të avancuar, të cilat mundësojnë mbështetje në një fushë të caktuar të punësimit apo profesionit, për zhvillimin e vetë individit si dhe ndjekjen e studimeve të mëtejshme të cilit të parë apo nivelit 6 të kornizës;</p> <p>Përdorimi i parimeve të planifikimit, organizimit dhe kontrollit të proceseve në një fushë të veçantë të veprimtarisë;</p> <p>Njohuri për të zhvilluar kritere vlerësimi, si edhe gjykime në përputhje me teoritë bazë dhe konceptet e tematikave të studimit.</p>	<p>Aftësi të plota teorike dhe praktike që nevojiten për të gjetur zgjidhje, identifikuar dhe përdorur të dhëna për të formuluar e dhënë përgjigje krijuese dhe strategjike për probleme të mirëpërcaktuara konkrete ose abstrakte, si dhe për të aplikuar njohuritë e marra në kontekstin e punës.</p> <p>Aftësi të të nxënit që mundësojnë ndërmarrjen e studimeve të mëtejshme me njëfarë autonomie.</p> <p>Kryerja e operacioneve komplekse me anë të mjeteve të punës, makinerive, aparaturave, apo pajisjeve të tjera.</p> <p>Demonstrimi i aftësive për planifikim, organizim dhe kontroll të veprimtarive të punës, të cilët kërkojnë ushtrimin e disa përgjegjësive personale</p> <p>Aftësi për kontroll dhe mbështetje për personelin, duke siguruar shpjegime ose udhëzues për të realizuar një veprimtari specifike.</p>	<p>Ushtrimi i menaxhimit dhe mbikëqyrjes në kontekstin e aktiviteteve të punës ose studimit aty ku ka ndryshim të paparashikueshëm rrethanash;</p> <p>Vlerësimi i përshtatshmërisë së metodikave të ndryshme për zgjidhjen e problemeve që lidhen me fushat e studimit apo të punës;</p> <p>Komunikimi i rezultateve të të nxënit, ideve, aftësive dhe aktiviteteve, si dhe formulimi i përgjigjeve për probleme abstrakte dhe konkrete, me argumente të strukturuar si edhe në mënyrë efektive, përmes informacionit sasior dhe cilësor, në nivele të ndryshme me kolegët mbikëqyrësit dhe klientët, në gjuhën amtare dhe në një gjuhë të huaj;</p> <p>Kryerja e tërësisë së detyrave në rrethana të ndryshme, marrja e përgjegjësive menaxheriale për ndarjen e burimeve dhe trajnimin dhe përmirësimin e performancës së tij dhe të tjerëve;</p> <p>Punë në mënyrë të pavarur në rrethana të ndryshueshme, duke marrë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave individuale dhe atyre të grupit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe duke u angazhuar në punën në grup;</p> <p>Mbajtja e përgjegjësisë për performancën e punës;</p> <p>Marrja e përgjegjësisë për përdorimin e duhur të mjeteve të punës;</p> <p>Demonstrimi i kuptimit të boshllëqeve në njohuritë, shprehitë dhe kompetencat e veta, dhe marrja e masave të nevojshme për përmirësimin e tyre me anë të vetë-studimit dhe pjesëmarrjes në seminare, trajnime etj.</p> <p>Tregon operacionalitet dhe shkathtësi brenda fushës së tij të kompetencës, si dhe ka aftësi të shprehë gjykime të bazuara në njohuritë e tij për çështje sociale dhe etike.</p>
4	<p>Njohuri faktike dhe teorike në një kontekst të gjerë brenda një fushë studimi dhe/ose pune;</p> <p>Njohuri të thella teorike faktike në një kontekst të gjerë brenda fushës së studimit dhe/ose të punës;</p> <p>Njohuri për mënyrat e përpunimit dhe përdorimit të informacionit kompleks;</p> <p>Shprehja e ideve me gojë dhe me shkrim, formulimi i detyrave, udhëzimeve, shpjegimeve, duke përdorur terminologjinë përkatëse;</p> <p>Njohuri të thella lidhur me</p>	<p>Një gamë të gjerë të aftësive njohëse dhe praktike për të zgjidhur problemet komplekse;</p> <p>Demonstrimi i të menduarit kreativ dhe aplikimi i metodave dhe mënyrave alternative në situata apo mjedise të panjohura dhe / ose të njohura;</p> <p>Aftësi për të shqyrtuar detyra dhe probleme në një fushë të punës dhe / ose studimit nga këndvështrime të ndryshme sipas kritereve të përcaktuara më parë;</p> <p>Aftësi për të transferuar njohuri dhe aftësi ndërmjet fushave të ndryshme të studimit ose të</p>	<p>Ushtrimi i vetëmenaxhimit brenda udhëzimeve të kontekstit të punës dhe/ose studimit, të cilat janë zakonisht të parashikueshme por në ndryshim;</p> <p>Demonstrimi i iniciativës dhe aftësisë për t'i vendosur vetes qëllime, për të planifikuar, për të justifikuar veprimet e tyre, si dhe të marrë përgjegjësinë për to;</p> <p>Marrja e përgjegjësisë gjatë monitorimit ose mbikëqyrjen së punës rutinë të të tjerëve;</p> <p>Aftësi për të shprehur një qëndrim kritik dhe për të marrë përgjegjësinë duke aplikuar teknologjitë e kërkuara;</p> <p>Punë në mënyrë të pavarur në kushte të ndryshueshme;</p>



	demokracinë dhe shoqërinë civile.	<p>punës në kryerjen e detyrave komplekse dhe zgjidhjen e problemeve specifike;</p> <p>Aftësi për të kryer operacione komplekse me anë të veglave të punës, instrumenteve matëse, makinerive dhe aparaturave.</p> <p>Aftësi për të organizuar, kontrolluar dhe mbështetur personelin, duke dhënë shpjegime ose udhëzime për të realizuar një aktivitet të veçantë;</p> <p>Aftësi për të vlerësuar cilësinë e produktit përfundimtar, si dhe të performancës së anëtarëve të ekipit;</p> <p>Aftësi për të zhvilluar një plan veprimi duke përdorur burimet në dispozicion.</p>	<p>Aftësi për të marrë vendime lidhur me kualifikimin e mëtejshëm dhe zhvillimin e ardhshëm të karrierës bazuar në kompetencat e veta;</p> <p>Demonstrimi i vetëdijes për mundësitë e aftësisimit të mëtejshëm;</p> <p>Aftësi për punë në mënyrë konstruktive në grupe heterogjene;</p> <p>Aftësi për të vendosur, në mënyrë të pavarur, për qasjen e prezantimit të suksesshëm në publik të llojeve të ndryshme të informacionit në fushën e studimit dhe / ose të punës;</p> <p>Kryerja e detyrave komplekse në kushte të ndryshueshme dhe marrja e përgjegjësisë për punën e të tjerëve dhe zgjidhjen e problemeve specifike;</p>
3	<p>Njohuri të fakteve, parimeve dhe koncepteve të përgjithshme në një fushë studimi dhe/ose pune;</p> <p>Njohuri për mënyrën e kërkimit, nxjerrjes, përpunimit dhe përdorimit të llojeve të ndryshme të informacionit;</p> <p>Njohuri për llojet e materialeve, instrumenteve, veglave të punës, dhe makinerive, si dhe për ndërldhjen midis tyre në një fushë të caktuar veprimtarie pune;</p> <p>Njohuri të përdorimit të terminologjisë përkatëse të fushës së studimit.</p>	<p>Aftësi bazë njohëse dhe praktike të nevojshme për të përmbushur detyra dhe zgjidhur probleme duke përdorur metoda, material, mjete pune dhe informacion bazë;</p> <p>Aftësi për të kryer, në mënyrë të pavarur, detyrat e mëparshme;</p> <p>Aftësi për të marrë vendim për një ndryshim të caktuar duke ndjekur rregullat dhe udhëzimet e nevojshme, në rastet kur kushtet e punës ndryshojnë;</p> <p>Aftësi për të kryer operacione komplekse me anë veglave të ndryshme të punës, makinerive aparatura dhe instrumenteve matëse;</p> <p>Aftësi për të kuptuar udhëzime, detyra dhe shpjegime të ndryshme nga ato të studiuar më parë;</p> <p>Aftësi për të shpjeguar veprimtaritë e realizuara, duke propozuar zgjidhje të reja.</p>	<p>Marrja e përgjegjësisë për të kryer detyrat në punë dhe / ose studim;</p> <p>Përshtatja e sjelljeve vetjake në rrethana të caktuara për zgjidhjen e problemeve;</p> <p>Punë në mënyrë të pavarur në kushte të ndryshueshme, duke marrë përgjegjësinë për të kryer detyrën e caktuar dhe për të vlerësuar performancën e vet në bazë të kriterëve të përcaktuara më parë;</p> <p>Demonstrimi i aftësisë për të marrë vendime në lidhje me arsimin e tij / saj dhe zhvillimin e ardhshëm të karrierës përmes vetë- vlerësimit të kompetencave të tij / saj;</p> <p>Demonstrimi i vetëdijes për mundësinë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm;</p> <p>Gatishmëri për të marrë pjesë në trajnime, duke e identifikuar fushën në të cilën është e nevojshme për të marrë më shumë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca;</p> <p>Komunikim në mënyrë efektive me kolegët, klientët dhe eprorin e drejtpërdrejtë.</p>
2	<p>Zotërim i njohurive themelore faktike në një fushë të caktuar të studimit dhe / ose punës;</p> <p>Njohuri si të sigurojë, përzgjedhë dhe përdorë informacion të thjeshtë;</p>	<p>Zotërimi i aftësive bazë njohëse dhe praktike të nevojshme për të kryer detyra të thjeshta, për të zgjidhur probleme rutinë dhe për të realizuar veprimtari rutinë;</p>	<p>Punë apo studim nën mbikëqyrje dhe me pak pavarësi.</p> <p>Ushtrimi i veprimtarisë në një shkallë relative të autonomisë në kontekste të njohura, duke marrë përgjegjësinë për kryerjen e një detyrë të caktuar;</p>





	<p>Zotërimi i njohurive bazë rreth fushave të rëndësishme sociale (të tilla si familja, shkolla, mjedisi i punës , komuniteti etj.);</p> <p>Njohja e mundësive dhe rreziqeve të përdorimit të teknologjive të kërkuara në mënyrë të pavarur.</p>	<p>Zbatimi i një numri të kufizuar aftësish për të kryer detyrat më komplekse në kontekste të njohura;</p> <p>Kryerja e operacioneve të thjeshta duke përdorur mjete pune dhe makineri të thjeshta;</p> <p>Aftësi për të orientuar vetveten dhe për të vepruar siç duhet në një kontekst të veçantë.</p> <p>Aftësi për të shpjeguar veprimtari të cilat ai/a jo nuk mund t'i realizojë, si dhe arsyen përse.</p>	<p>Veprimtari pune në kontekste të panjohura në vijim të udhëzimeve me shkrim ose me gojë të mbikëqyrësi;</p> <p>Veprimtari pune rutinë në rrethana të pandryshueshme;</p> <p>Demonstrimi i vetëdijes për të vijuar kualifikimin e tij / saj;</p> <p>Shkëmbime informacioni më gojë dhe shkrim;</p> <p>Komunikimi me sukses në një mjedis të ndryshueshëm shoqëror dhe kulturor;</p> <p>Demonstrimi i nevojës për të marrë disa kompetenca kyçe të rëndësishme (gjuhë amtare, matematikë, shkrim-lexim kompjuter etj.);</p> <p>Punë në grup, duke pranuar dhe shprehur një opinion dhe / ose kritikë.</p>
1	<p>Njohuri bazë për mjedisin që e rrethon por ka nevojë për praktikë dhe trajnim të vazhdueshëm.</p> <p>Njohuri bazë për mirëqenien dhe kujdesin për mjedisin.</p> <p>Njohuri të përgjithshme bazë.</p>	<p>Aftësi të nevojshme praktike për të kryer detyra të thjeshta të përditshme.</p> <p>Aftësi për të aplikuar njohuritë e nevojshme të fituara gjatë shkollimit, për të kryer detyra të ndryshme.</p> <p>Është i aftë të bëjë supozimet të bazuara në informacionin e mbledhur për botën.</p>	<p><i>Kompetencat personale, qytetare dhe dixhitale</i></p> <p>- është i aftë për të punuar nën mbikëqyrje, duke ndjekur një model apo udhëzim të caktuar; (ii) për të zgjedhur burimet e nevojshme për informacion ndihmues nga mësuesi, për të bërë një detyrë shkolle individualisht ose në grup; (iii) për të qenë i vlerësuar dhe për të vlerësuar të tjerët me ndihmën e mësuesit</p> <p><i>Të menduarit dhe të nxënëit për të mësuar kompetencat</i></p> <p>- Është i aftë për të studiuar dhe punuar me të tjerët për të marrë dhe ofruar informacion</p> <p><i>Komunikimi dhe kompetencat e shprehjes</i></p> <p>-Është i aftë për të: (i) biseduar me vetë-besim dhe komunikuar me shkrim; (ii) kuptuar dhe shprehur me gojë dhe me shkrim në gjuhë të huaja, për nevojë ose për situata të thjeshta; (iii) mbrojtur të drejtat e tij/e saj pa cenuar të drejtat e të tjerëve.</p>



**VENDIM**  
**Nr. 432, datë 26.6.2019**

**PËR FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN  
E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË SË  
INSTITUTIT KOMBËTAR TË  
REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË  
KULTURORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Përcaktimin e funksionimit dhe të mënyrës së zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (në vijim, IKRTK).

2. IKRTK-ja është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Tiranë.

3. IKRTK-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.

4. IKRTK-ja ka për mision krijimin, ruajtjen e përditësimin e Regjistrimit Kombëtar të Pasurive Kulturore, në formë elektronike dhe të shkruar.

5. IKRTK-ja vepron në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në fushat e përgjegjësive, si më poshtë vijon:

a) Regjistrimin, katalogimin informatik, dokumentimin, vlerësimin, promovimin e trashëgimisë kulturore;

b) Monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare brenda e jashtë Republikës së Shqipërisë.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË  
INSTITUTIT KOMBËTAR TË REGJIS-  
TRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

1. IKRTK-ja ka këto përgjegjësi:

a) Të organizojë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive në regjistrimin, katalogimin informatik, dokumentimin, vlerësimin e promovimin e trashëgimisë kulturore;

b) Të organizojë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive në monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë e të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë;

c) Të organizojë punën për ofrimin e shërbimeve organeve të administratës shtetërore qendrore, të pushtetit vendor, të institucioneve shkencore, kulturore apo fetare, të personave fizikë e juridikë privatë për evidentimin, regjistrimin dhe katalogimin e pasurive kulturore;

ç) Të organizojë punën për dokumentimin, sipas kriterëve shkencore të trashëgimisë kulturore, të mbikëqyrë e të monitorojë respektimin e të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes, me qëllim identifikimin, studimin, botimin dhe promovimin, ruajtjen e administrimin e *database*-it kombëtar të pasurive kulturore dhe të kontribuojë për rritjen e ndërgjegjësimit, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e pasurive kulturore në nivel kombëtar.

**III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I  
INSTITUTIT KOMBËTAR TË REGJIS-  
TRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE  
(IKRTK)**

1. IKRTK-ja e shtrin veprimtarinë e tij për trashëgiminë kulturore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në:

a) nivel qendror të regjistrimit të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet drejtorisë qendrore;

b) nivel rajonal, nëpërmjet zyrave rajonale të IKRTK-së dhe zyrave të eksportit të pasurive kulturore të luajtshme, të cilat funksionojnë pranë DRTK-ve.

2. IKRTK-ja menaxhon aktivitetin e zyrave rajonale dhe zyrave të eksportit të pasurive kulturore të luajtshme, sipas parashikimeve të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe të muzeve.

3. Pranë IKRTK-së funksionon Komisioni Këshillimor për Vlerësimin dhe Identifikimin e Vlerave Kulturore në pasuritë e luajtshme.

4. IKRTK-ja është institucion kombëtar i specializuar shkencor, i cili, në përmbushje të funksioneve të veta, bashkërendon punën me:

a) institucione publike në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

b) organe të administratës qendrore dhe organe të qeverisjes vendore;

c) institucione të tjera shkencore, kulturore, fetare;



ç) individë, persona fizikë e juridikë për regjistrimin, katalogimin informatik, dokumentimin, vlerësimin, promovimin e trashëgimisë kulturore, si dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare;

d) institucione të tjera të specializuara të sistemit të Akademisë së Shkencave, Akademisë së Studimeve Albanologjike, si dhe institucione homologe ose organizma ndërkombëtarë në fushën e trashëgimisë kulturore;

dh) organizata ndërkombëtare lidhur me implementimin e standardeve në fushën e dokumentimit, të regjistrimit, të monitorimit të qarkullimit të pasurive kulturore, luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore, si dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të operatorëve, pjesë të strukturave shtetërore, sistemit doganor, Policisë së Shtetit dhe institucioneve të specializuara për trashëgiminë kulturore;

e) institucionet e vetëqeverisjes vendore.

5. IKRTK-ja drejtohet e përfaqësohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e IKRTK-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

6. Struktura dhe organika e IKRTK-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

7. IKRTK-ja funksionon në bazë të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, të këtij vendimi dhe të statutit e të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

8. Statuti dhe rregullorja që përcaktojnë metodat e brendshme të punës së IKRTK-së miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

9. Marrëdhëniet e punës së drejtorit dhe të nëpunësve të IKRTK-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

10. Drejtori i IKRTK-së duhet të plotësojë kriteret profesionale, si më poshtë vijon:

a) Të ketë eksperiencë profesionale e të dokumentuar në fushën e tij të ekspertizës dhe të menaxhimit;

b) Nuk duhet të jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

11. IKRTK-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) Regjistron e dokumenton të gjitha pasuritë kulturore, materiale dhe jomateriale, si dhe pasuritë e peizazhit në pronësi publike e private në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) Regjistron në kartelat e pasurive kulturore vendimet e këshillave kolegjalë të trashëgimisë kulturore;

c) Regjistron transferimet e pasurive kulturore ndërmjet pushtetit qendror dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore ose të institucioneve të tjera publike vendore;

ç) Regjistron lejet për ndërhyrjet ruajtëse të miratuara nga KKTKM-ja;

d) Regjistron masat e mbrojtjes indirekte në regjistrat e pasurive;

dh) Regjistron objektet muzeore, koleksionet, si dhe lidhjen ose jo të objekteve muzeore me koleksionet, që janë pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore;

e) Harton platformën për regjistrimin e të gjitha pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme, që ruhen nga rrjeti muzeor i vendit, nga galeritë e artit, personat privatë, institucionet e specializuara vendore e kombëtare dhe bashkësitë fetare të regjistruara me ligj, për krijimin dhe përditësimin e Regjistrat Kombëtar të Pasurive Kulturore;

ë) Harton dhe mban regjistrin e ekspertëve vlerësues të pasurive kulturore të luajtshme;

f) Harton masat për ruajtjen, mbrojtjen, mirëmbajtjen, administrimin, tjetërsimin e qarkullimin e objekteve muzeore dhe të koleksioneve muzeore me propozim të përbashkët me IKTK-në;

g) Administron Katalogun Kombëtar të Pasurive Kulturore, nëpërmjet sistemit informatik kombëtar të administrimit të trashëgimisë kulturore, si dhe regjistrat kombëtarë të vlerave kulturore materiale e jomateriale;

gj) Administron katalogun e Fondit Muzeor Kombëtar;

h) Administron bazën shtetërore të të dhënave të pasurive kulturore;

i) Administron bazën e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura;

j) Asiston ministrinë në ushtrimin e kompetencave për zbatimin e politikave



qeveritare në fushën e trashëgimisë kulturore për funksionet që IKRTK-ja ka kompetencë;

k) Administron e përditëson Regjistrin Kombëtar të Pasurive Jomateriale dhe të Pasurive Materiale, në përputhje me seksionet përkatëse të pasurive kulturore të paluajtshme, si dhe të pasurive kulturore të luajtshme e të koleksioneve;

l) Administron një Regjistër Kombëtar të Licencave të Eksportit të Pasurive Kulturore;

ll) Administron Regjistrin e Tregtimit të Pasurive Kulturore;

m) Administron një kopje të dokumentacionit të marrjes në dorëzim të punimeve të ndërhyrjeve në pasuritë e paluajtshme;

n) Administron një kopje të listës së lejeve të ndërhyrjeve në pasuritë e peizazhit;

nj) Lëshon certifikata regjistrimi të pasurive kulturore, të luajtshme e të paluajtshme dhe, në rast të humbjes së saj, lëshon një dublikatë;

o) Lëshon dokumentacionin për ekzistencën e objekteve muzeore në muze, për krijimin dhe regjistrimin e muzeve ekzistues e të rinj;

p) Lëshon vërtetim për kopjet e autorizuar të çdo objekti muzeor;

q) Mbikëqyr e monitoron respektimin e të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare;

r) Mbikëqyr zbatimin apo shkeljen e procedurave (regjimit) të qarkullimit kombëtar dhe ndërkombëtar të certifikuar të pasurive kulturore të luajtshme;

rr) Asiston dhe denoncon pranë inspektoratit përgjegjës për trashëgiminë kulturore;

s) Zhvillon metodologjinë për dokumentimin e katalogimin e pasurive kulturore, si dhe koordinon bashkëpunimin me njësitë territoriale në fushën e pasurive kulturore;

sh) Kryen regjistrimin *on-line* të pasurive kulturore kombëtare dhe të çdo procedure për identifikim e regjistrim;

t) Monitoron procedurat e eksportit për qarkullimin kombëtar e ndërkombëtar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, në bashkëpunim me institucionet doganore dhe Policinë e Shtetit. Parashikon masat e nevojshme, me qëllim që pasuritë të mos pësojnë dëmtime gjatë transportit në rastin kur mbajtësi i pasurive kulturore ndryshon vendbanimin ose selinë, ndryshim, i cili deklarohet paraprakisht në

drejtorinë rajonale të trashëgimisë kulturore përkatëse;

th) I propozon ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore mundësinë e parablerjes së pasurive kulturore;

u) Koordinon procesin e pasqyrimin të të dhënave në regjistrat e tjerë publikë për pasuritë e trashëgimisë kulturore të deklaruara;

v) Miraton çdo vit listën e çmimeve të referencës për pasuritë kulturore;

x) I jep mendim Këshillit Kombëtar të Muzeve për përcaktimin e vlerës maksimale të transaksionit për pasurimin e fondit muzeor.

12. Zyrat rajonale të IKRTK-së dhe zyrat e eksportit të pasurive kulturore të luajtshme kanë për detyrë:

a) regjistrimin *on-line* të pasurive kulturore kombëtare dhe të çdo procedure për identifikim e regjistrim;

b) zbatimin e monitorimin e procedurave të eksportit për qarkullimin kombëtar dhe ndërkombëtar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, në bashkëpunim me institucionet doganore dhe Policinë e Shtetit.

13. Drejtori i IKRTK-së ka kompetencat dhe përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

a) Nxjerr vendimin për verifikimin e interesit kulturor në bazë të vendimit të Komisionit Këshillimor për Vlerësimin dhe Identifikimin e Vlerave Kulturore për Pasuritë e Luajtshme;

b) Shqyrton ankimin ndaj vendimit të zyrës për çështjet e eksportit për refuzimin e kërkesës për lëshimin e licencës së qarkullimit të lirë ose të përkohshëm. Ndaj vendimit të titullarit të IKRTK-së mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative;

c) Shpall në “mbrojtje paraprake” pasuritë kulturore të luajtshme, të cilat, pas verifikimit, janë identifikuar si pasuri me vlera kulturore;

ç) Akordon licencat e eksportit/importit të pasurive kulturore, në mbështetje me parashikimet e ligjit nr. 27/2018 dhe të klasifikuara në dy kategori:

i) Licenca eksporti të pasurive kulturore për qarkullimin e lirë të pasurive kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të tjera me afat 3-vjeçar dhe licenca për qarkullimin e përkohshëm të pasurive kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt



vendeve të tjera me afat të përcaktuar jo më shumë se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj;

ii) Licenca importi të pasurive kulturore për hyrjen e pasurive kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

14. IKRTK-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e IKRTK-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”.

15. Vula e IKRTK-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Struktura dhe organika e Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore miratohet me urdhër të Kryeministrit, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Statuti i Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore miratohet nga ministri i Kulturës, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Deri në fillimin e funksionimit të plotë, të miratimit të strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, sipas këtij vendimi, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore vazhdon të kryejë funksionet e saj sipas strukturës dhe organikës në fuqi.

4. Punonjësit aktualë të QKIPK-së riorganizohen sipas strukturës dhe organikës së re të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore. Ky proces udhëhiqet nga Ministria e Kulturës dhe zbatohet nga IKRTK-ja, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Punës.

5. Ngarkohet Ministria e Kulturës, që, në përputhje me nenin 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të bëjë transferimin e fondeve buxhetore nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të Institutit Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

6. Vendimi nr. 142, datë 27.3.1995, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore”, i ndryshuar, dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie ndesh me parashikimet e këtij vendimi shfuqizohen.

7. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

#### VENDIM Nr. 433, datë 26.6.2019

### PËR FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË SË QENDRËS KOMBËTARE TË VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

#### I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Përcaktimin e funksionimit dhe të mënyrës së zhvillimit të veprimtarisë së Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale (në vijim, QKVT).

2. QKVT-ja është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Tiranë.

3. QKVT-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

4. QKVT-ja ka për mision administrimin, studimin, kërkimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, popullarizimin dhe promovimin e pasurive kulturore jomateriale e të diversitetit



kulturor në nivel kombëtar, në bashkëpunim me subjekte publike e private.

5. QKVT-ja vepron në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në fushat e përgjegjësive, si më poshtë vijon:

- a) Trashëgimi kulturore jomateriale;
- b) Diversitet kulturor.

## II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË QENDRËS KOMBËTARE TË VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

1. QKVT-ja ka përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

a) Të organizojë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale lidhur me kushtet për rritjen e ndërgjegjësimit për ruajtjen e promovimin e saj;

b) Të organizojë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive në fushën e diversitetit kulturor në nivel kombëtar.

## III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS KOMBËTARE TË VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

1. QKVT-ja e shtrin veprimtarinë e saj për trashëgiminë kulturore jomateriale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. QKVT-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e QKVT-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Struktura dhe organika e QKVT-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

4. QKVT-ja funksionon në bazë të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, të këtij vendimi dhe statutit e të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

5. QKVT-ja realizon aktivitetin e saj në bashkëpunim me:

a) institucionet e tjera publike në varësi të ministrisë përgjegjëse të trashëgimisë kulturore, organet e administratës qendrore, organet e qeverisjes vendore dhe institucione të tjera shkencore, kulturore, fetare, persona fizikë e juridikë për administrimin, studimin, kërkimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, popullarizimin e

promovimin e pasurive kulturore jomateriale dhe të diversitetit kulturor në nivel kombëtar.

b) UNESCO-n dhe me organizata të tjera ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, promovimin e identitetit kulturor, si dhe ndërmerr nisma për njohjen e regjistrimin në nivel ndërkombëtar të vlerave kulturore jomateriale;

c) institucione të tjera të specializuara të sistemit të Akademisë së Shkencave, Akademisë së Studimeve Albanologjike, universiteteve përkatëse, si dhe institucione homologe ose organizma ndërkombëtarë në fushën e trashëgimisë kulturore.

6. Statuti dhe rregullorja, që përcaktojnë metodat e brendshme të punës së QKVT-së miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

7. Marrëdhëniet e punës së drejtorit, nëpunësve dhe të punonjësve të QKVT-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

8. Drejtori i QKVT-së emërohet ose lirohet nga detyra nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Procedura e emërimit dhe e lirimit të tij përcaktohet në statutin e QKVT-së.

9. Drejtori i QKVT-së duhet të plotësojë kriteret profesionale, si më poshtë vijon:

a) Të ketë eksperiencë profesionale e të dokumentuar në fushën e tij të ekspertizës dhe të menaxhimit;

b) Nuk duhet të jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

10. QKVT-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) Asiston ministrinë në ushtrimin e kompetencave të saj për zbatimin e politikave qeveritare në fushën e ruajtjes, mbrojtjes, promovimit dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore jomateriale;

b) Kërkon, verifikon dhe studion vlerat e trashëgimisë kulturore jomateriale;

c) Krijon dhe përditëson Regjistrin Kombëtar të Bartësve të Folklorit, Regjistrin e Vlerave të Trashëgimisë Jomateriale, listën e artizanëve, të cilët trashëgojnë dijetë të ndryshme, Regjistrin e Kryeveprave të Trashëgimisë Jomateriale dhe listën e trashëgimisë kulturore jomateriale në rrezik;



ç) Krijon dhe mirëmban një hartë interaktive të trashëgimisë kulturore jomateriale në territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) Lëshon dokumente, kopje të vërtetuara të tyre dhe kopje digjitale të arkivit, sipas tarifave të përcaktuara me udhëzim;

dh) Monitoron në terren të gjitha veprimtaritë e trashëgimisë jomateriale, që zhvillohen në rang vendi;

e) Përgatit raporte apo informacione për trashëgiminë jomateriale, të kërkuara nga organizmat ndërkombëtarë, dhe i paraqet ato pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale;

ë) Bashkëpunon me specialistët e trashëgimisë kulturore jomateriale pranë drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore, si dhe me institucionet kulturore-artistike, qendrore e vendore, shoqatat kulturore e individë të fushës së trashëgimisë jomateriale;

f) Organizon festivalet folklorike tipologjike kombëtare në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;

g) Organizon Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucione të tjera shtetërore e private, bazuar në rregulloren e tij, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

gj) Propozon, për miratim, pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, “Kryevlerat Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”;

h) Nxjerr vendimin për konstatimin ose jo të interesit kulturor të pasurisë kulturore jomateriale, objekt verifikimi, në zbatim të nenit 58, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, pas vendimit të komisionit këshillimor;

i) Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, merr masa dhe krijon kushte lehtësuese për promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale jashtë kufijve të vendit, të grupeve apo bartësve popullorë, për pjesëmarrje në turne, festivale apo takime ndërkombëtare të kësaj fushe.

11. Drejtori i QKVT-së ka kompetencat dhe përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

a) Analizon, zbërthen dhe siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikat e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

b) Është përgjegjës për hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike, në përputhje me objektivat dhe misionin e QKVT-së;

c) Planifikon, drejton e koordinon funksionimin e përgjithshëm të institucionit;

ç) Është sekretar i Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale;

d) Jep udhëzime lidhur me trajtimin e kërkesave që i kalojnë për shqyrtim Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale;

dh) Identifikon mundësitë për menaxhim të fondeve publike dhe të performancës së institucionit;

e) Ndjek e raporton zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga konventat, protokollet dhe marrëveshjet një-ose shumëpalëshe;

ë) Bashkërendon punën me institucionet monitoruese, me qëllim që konkluzionet dhe rekomandimet e monitorimit të përfshihen në programet dhe politikat që ndjek ministria;

f) Emëron dhe shkarkon punonjësit e QKVT-së në bazë të Kodit të Punës dhe të rregullores së brendshme të QKVT-së.

12. QKVT-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e QKVT-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale”.

13. Vula e QKVT-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Struktura dhe organika e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale miratohet me urdhër të Kryeministrit, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Statuti i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale miratohet nga ministri i Kulturës, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.



3. Deri në fillimin e funksionimit të plotë, të miratimit të strukturës dhe organikës së Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale, sipas këtij vendimi, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike vazhdon të kryejë funksionet e saj sipas strukturës dhe organikës në fuqi.

4. Punonjësit aktualë të Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike riorganizohen sipas strukturës dhe organikës së re të Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale. Ky proces udhëhiqet nga Ministria e Kulturës dhe zbatohet nga QKVT-ja, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Punës.

5. Ngarkohet Ministria e Kulturës, që, në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të bëjë transferimin e fondeve buxhetore nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike (QKVF) te Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale (QKVT).

6. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

**VENDIM**  
Nr. 434, datë 26.6.2019

**PËR FUNKSIONIMIN, ORGANIZIMIN  
DHE MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË  
VEPRIMTARISË SË MUZEUT  
KOMBËTAR TË PËRGJIMEVE  
“SHTËPIA ME GJETHE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 208, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Përcaktimin e funksionimit dhe të mënyrës së organizimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe”.

2. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” është person juridik, publik, buxhetor, i cili ushtron veprimtarinë e tij si një institucion i specializuar në fushën muzeore, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Tiranë.

3. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” është muze qendror, i specializuar, publik, që gëzon statusin “Muze kombëtar”.

4. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” ka për mision përkujtimin e dhunës psikologjike të regjimit komunist dhe kontrollin e qytetarëve nëpërmjet përgjimeve të kryera nga ish-Sigurimi i Shtetit.

5. Burimet e financimit të Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” janë, si më poshtë vijon:

- a) Buxheti i shtetit;
- b) Burime të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË  
MUZEUT KOMBËTAR TË PËRGJIMEVE  
“SHTËPIA ME GJETHE”**

1. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” ka përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

a) Të organizojë punën për ekspozimin, pasurimin, propagandimin, studimin e mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe të kujtesës kolektive të lidhura me dhunën psikologjike të regjimit komunist dhe kontrollin e qytetarëve nëpërmjet përgjimeve të kryera nga ish-Sigurimi i Shtetit;

b) Të organizojë punën për të siguruar dokumentimin e fakteve historike dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të lidhur me përkujtimin e dhunës psikologjike të regjimit komunist dhe kontrollin e qytetarëve nëpërmjet përgjimeve të kryera nga ish-Sigurimi i Shtetit;

c) Të ofrojë shërbime për publikun në funksion të përmbushjes së përgjegjësisë funksionale të tij.





### III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I MUZEUT KOMBËTAR TË PËRGJIMEVE “SHTËPIA ME GJETHE”

1. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” organizohet në nivel qendror.

2. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” funksionon në bazë të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, të këtij vendimi, të statutit dhe të rregullores së tij.

3. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” e realizon veprimtarinë e tij në bashkëpunim me:

a) organet e administratës shtetërore qendrore dhe organet e vetëqeverisjes vendore;

b) rrjetin muzeor shqiptar;

c) muzetë kombëtarë, muzetë tipologjike, muzetë vendore, muzetë privatë, për të tërhequr në fondet e tij objekte me vlera të veçanta, si dhe për ekspozita e aktivitete të tjera të përbashkëta;

ç) institucionet shkencore, kulturore, artistike e fetare, individët, personat fizikë e juridikë, privatë, për evidentimin, grumbullimin dhe restaurimin e objekteve, pjesë e fondit të tij, që janë vlera materiale të trashëgimisë kulturore;

d) institucionet e huaja simotra nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare, duke marrë në çdo rast miratimin e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

4. Struktura dhe organika e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

5. Statuti dhe rregullorja, që përcaktojnë metodat e brendshme të punës së Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

6. Marrëdhëniet juridike të punës së drejtorit, nëpunësve dhe të punonjësve të Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

7. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) Zbaton politikën e Ministrisë së Kulturës në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, në fushën e ekspozimit, të pasurimit, propagandimit, studimit, mbrojtjes, konservimit

dhe të restaurimit të vlerave të trashëgimisë kulturore e të kujtesës kolektive;

b) Ruan e studion provat materiale dhe jomateriale të trashëgimisë historike e kulturore të Shqipërisë, të cilat i komunikon dhe i paraqet në një mjedis që nxit edukimin e argëtimin;

c) Siguron disponueshmërinë e koleksioneve të muzeut për vizitorët dhe studiuesit;

ç) Bashkëpunon me subjektet arsimore, duke u ofruar personave të të gjitha moshave mundësi për të mësuar nëpërmjet kontaktit me materiale origjinale;

d) Organizon aktivitete, të cilat përbushin vizionin dhe misionin e tij në përkujtimin e dhunës psikologjike të regjimit komunist e të kontrollit të qytetarëve përmes ish-Sigurimit të Shtetit;

dh) Organizon, brenda dhe jashtë vendit, çeljen e ekspozitave, me objektet që disponon, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) Përgatit pasaportën shkencore të çdo objekti ekzistues apo të ri, që bëhet pjesë e fondit të tij dhe ia përcjell për regjistrim Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;

ë) Kryen hulumtime profesionale e shkencore për mbledhjen, vlerësimin, dhe ekspozimin e objekteve që disponon;

f) Nxit e inkurajon, nëpërmjet projekteve, veprimtarinë kërkimore-shkencore lidhur me fondet që administrojnë për studiuesit në fushën e historisë dhe punonjësve në fushën e muzeologjisë;

g) Inkurajon dialogun me dhe ndërmjet qytetarëve për të kaluarën, të tashmen e të ardhmen shqiptare.

8. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” drejtohet nga drejtori i muzeut, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e institucionit dhe përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

9. Drejtori i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” emërohet ose lirohet nga detyra nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Muzeve. Drejtori emërohet për një mandat tre-vjeçar. Procedura e emërimit dhe e lirimit të tij përcaktohet nga ministri në rregulloren për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit.



10. Drejtori i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” duhet të plotësojë kriteret profesionale, si më poshtë vijon:

a) Të ketë përvojë profesionale dhe të dokumentuar në fushën e tij të ekspertizës dhe të menaxhimit;

b) nuk duhet të jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

11. Drejtori i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” ka kompetencat, si më poshtë vijon:

a) Drejton veprimtarinë e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe”, në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin e institucionit dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të tij;

b) Përfaqëson Muzeun Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” në marrëdhënie me të tretët;

c) Ka të drejtë të lidhë marrëveshje për shkëmbimin e fondeve muzeore, pas marrjes së miratimit nga Këshilli Kombëtar i Muzeve. Procedura e ndjekur në këtë rast bëhet sipas nenit 225, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

ç) Merr masa mbrojtëse dhe ruajtjeje lidhur me fondin kombëtar të muzeut;

d) Emëron dhe liron nga detyra, në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës, të gjithë punonjësit e muzeut;

dh) Nxjerr urdhra e udhëzime me karakter të brendshëm për punonjësit e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe”;

e) Çdo kompetencë tjetër, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

12. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” ka logon dhe vulën e tij zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe””, sipas legjislacionit në fuqi.

13. Vula e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Struktura dhe organika e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” miratohet me urdhër të Kryeministrit brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Statuti i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” miratohet nga ministri i Kulturës brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me gjethe”, sipas këtij vendimi, muzeu kombëtar “Gjethi” vazhdon të kryejë funksionet e tij dhe funksionon sipas strukturës dhe organikës në fuqi.

4. Punonjësit aktualë të Muzeut Kombëtar “Gjethi” riorganizohen sipas strukturës dhe organikës së re. Ky proces udhëhiqet nga drejtues të lartë të Ministrisë së Kulturës, nën mbikëqyrjen e ministrit të Kulturës.

5. Ngarkohet Ministria e Kulturës, në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të bëjë transferimin e fondeve buxhetore nga muzeu kombëtar “Gjethi” te Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe”.

6. Vendimi nr. 208, datë 15.3.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e muzeut kombëtar “Gjethi””, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**



## VENDIM

Nr. 435, datë 26.6.2019

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE”, TRUALL, TË PASURISË ME NUMËR 327/1, ZONA KADASTRALE 2671, BASHKIA FINIQ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

Lidhja nr.1

Nr. Rend	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i Pasurisë	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Sipërdëtimore m <sup>2</sup>	Sipërfaqja zhvillimore m <sup>2</sup>	Emërtimi i strukturës
1	Vlorë	Finiq	2671	Finiq	327/1	3739	840	840	Magazinë bujqësore

## VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 327/1, zona kadastrale 2671, Bashkia Finiq, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, Qarku Vlorë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 327/1, zona kadastrale 2671, Bashkia Finiq.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë dhe Këshilli i Qarkut Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

**Erion Braçe**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

**ÇERTIFIKATË** 1744834  
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. SARANDË Zona Kadastrale Nr. 2671  
 Numri i Pasurisë 327/1 Volumi 2 Faqe 147  
 Adresa e Pasurisë FINIQ  
 Lloji i Pasurisë ARE  
 Sipërfaqja Totale 3739.00 m2  
 Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -  
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
PETRO	ZISO	BOZHORI	1/1	

- është pronar i pasurisë me numër 327/1  
 - janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart   
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi   
 - kufizimet e pasurisë janë : V , L , J , P


**Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

**Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 29/9/2017 Nr. 9399**

Data e lëshimit të çertifikatës 3/10/2017

Lëshuesi i çertifikatës  
REGJISTRUESI  
**ALBA KOLA**







## VENDIM

Nr. 436, datë 26.6.2019

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE”, TRUALL, TË PASURISË ME NUMËR 120/10, ZONA KADASTRALE 1167, BASHKIA VORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 120/10, zona kadastrale 1167, Bashkia Vorë, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, Qarku Tiranë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 120/10, zona kadastrale 1167, Bashkia Vorë.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Tiranë dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

## Lidhja nr. 1

Nr. Rend	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i Pasurisë	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Sip. ndërtimore m <sup>2</sup>	Sip. zhvillimore m <sup>2</sup>	Emërtimi i strukturës
1	Tiranë	Vorë	1167	Bërxull	120/10	8200	474.24	2372	“Kapanon për grumbullimin e produkteve bujqësore 1 kat”





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

**ÇERTIFIKATË**  
**PËR VËRTETIM PRONËSIE**

1584706

Z.V.R.P.P. TIRANË  
Zyra e Regjistrimit \_\_\_\_\_ Zona Kadastrale Nr. 1167  
120/10  
Numri i Pasurisë \_\_\_\_\_ Volumi <sup>2</sup> \_\_\_\_\_ Faqe 182  
Adresa e Pasurisë \_\_\_\_\_  
BERXULL  
ARE  
Lloji i Pasurisë \_\_\_\_\_  
8200.00 \_\_\_\_\_ m2  
Sipërfaqja Totale \_\_\_\_\_  
Nga kjo : Sa Truall \_\_\_\_\_ Nga kjo : Sa Ndërtesa \_\_\_\_\_  
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes \_\_\_\_\_ %

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Zoti ( Zotërinjtë )

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
SHOQERIA	"	PALLETS @ PACKAGING	1/1	TIRANE
ALBANIA "		SH.P.K		

- është pronar i \_\_\_\_\_ pasurisë me numër 120/10  
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart \_\_\_\_\_  
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi \_\_\_\_\_  
- kufizimet e pasurisë janë : V \_\_\_\_\_, L \_\_\_\_\_, J \_\_\_\_\_, P \_\_\_\_\_

**Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me  
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të  
Paluajtshme.**

**Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së  
paraqitur nga i (të) interesuari (t)  
më datë \_\_\_\_\_ Nr. 2443**

Data e lëshimit të çertifikatës  
23/1/2018

Lëshuesi i çertifikatës  
REGJISTRUESI  
**VALDRIN PJETRI**  
Z.V.R.P.P.  
TIRANE





Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

**KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME**Vol. 2, Fq. 182**A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE**Zona Kadastrale: 1167 NR.i PASURISE : 120/10

--&gt; Vizion nga: Vol. \_\_\_\_\_, Fq. \_\_\_\_\_

Indeksi i Hartes: K-34-88-(215-A)

Vizion në: Vol. \_\_\_\_\_, Fq. \_\_\_\_\_ deri në: Vol. \_\_\_\_\_, Fq. \_\_\_\_\_ --&gt;


Adresa e Pasurisë: Rrethi TIRANE Q/F BERXULLPERFUNDIMTARE (data): 9/2/1998

Rr/L \_\_\_\_\_ P/G \_\_\_\_\_ SH \_\_\_\_\_ K \_\_\_\_\_ Ap \_\_\_\_\_

Përshkrim i veçantë:

**B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE**Lloji i Pasurisë: ARE Brenda V.K.N. : 0, Ref: \_\_\_\_\_

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Trual	Nga Sip. Trual: sa Ndërtesë	Per pjesen e përbashkët:
1. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	1. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	1. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	<b>PALLAT</b>
2. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	2. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	2. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	Kuota e pjesmarrjes: _____ %
3. <u>8,200.00</u> m <sup>2</sup> Ref. <u>02050</u>	3. <u>0.00</u> m <sup>2</sup> Ref. <u>02050</u>	3. <u>0.00</u> m <sup>2</sup> Ref. <u>02050</u>	Nr i Pasurise (pallat):
4. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	4. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	4. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	Vol. _____ Faqe _____

**C - SEKSIONI I PRONESISE**

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
00003302	23/01/2018	Shoqëria " Pallets @ Packaging Albania " sh.p.k				I	TIRANE		23/01/2018	Urdher Korrigjimi	<i>AS/001</i>

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqesues i familjes; B - bashkëpronar (%)





**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,  
SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

Ok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
13360	05/04/2018	15	MBI PASURINA REGJISTROHET KONTRATA E SERVITUTIT ME PALE ALI ABAS ALLMETA DHE ALZAN ENGIJELL LEKAJ NE LIDHJE ME RRUGE KALIMI TE PERBASHKET.		D NOTE NR 385 REP NR 230 KOL DT 03.02.2018.	<i>AZ/101</i>

**E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj**

Ok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E DREJTËSISË**  
**ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**  
**ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË**  
 Adresa: Rruga Jordan Misja, Tirane

TIRANË, me 5 / 4 /2018

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone  
Në regjistrin Vol 2, Faqe 182, Zona Kadastrale 1167, Qyteti Tiranë

**REGJISTRUESI**

VALDRIN PJETRI






### HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

<p style="text-align: center;"><b>ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME TIRANË</b></p> <p style="text-align: center;"><b>REGJISTRUES</b> Valdrin Pjetri</p> <div style="text-align: center;"> <p><b>Z.V.R.P.P TIRANË</b></p> </div> <p style="text-align: center; font-size: small;">Vula/Firma</p>	<p><b>A. IDENTIFIKIMI I PASURISE</b>                  ZONA KADASTRALE <u>1167</u>                  NR. I PASURISE: <u>120/10</u> VOL <u>2</u> FQ <u>182</u>                  INDEKSI I HARTES: <u>K-34-88-(215-A)</u> SHKALLA: <u>1:2500</u>                  ADRESA E PASURISE: Rrethi <u>TIRANË</u> Q/F <u>BEXHULL</u>                  Rr/L: _____ P/G _____ SH _____ K _____ Ap _____</p> <p><b>B. KUFIZIMET</b>                  V. _____                  L. _____                  J. _____                  P. _____</p> <p><b>C. PRONARI</b>                  "PALLETS @ PACKAGING                  ALBANIA" SH.P.K</p> <p><b>D. Data:</b> <u>1</u> / <u>1</u> / 2018</p>
--	--



**VENDIM****Nr. 438, datë 26.6.2019****PËR SHKËMBIMIN E  
PRONËS/PASURIVE ME NR. 171/59, NR.  
171/143, ZONA KADASTRALE 3963, ME  
SIPËRFAQE 12000 M<sup>2</sup>, ME PASURITË ME  
NR. 401/5, NR. 401/3, NR. 53/46, NR.  
53/33, ZONA KADASTRALE 2735, ME  
SIPËRFAQE 9956 M<sup>2</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 5, 6, 10, 11, 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të nenit 757, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shkëmbimin e pronës shtetërore, “rrugë ngastrash”, “arë”, me numra pasurie: 401/5, 401/3, 53/46, 53/33, zona kadastrale 2735,

fshati Mullet, Bashkia Tiranë, me sipërfaqe prej 9 956 m<sup>2</sup>, në përgjegjësi administrimi të Bashkisë Tiranë, me pasuritë me numër 171/59 dhe 171/143, zona kadastrale 3963, me sipërfaqe prej 12000 m<sup>2</sup>, në pronësi të shoqërisë “*Classic S&P*”, sh.p.k., sipas certifikatave të pasurisë e kartelave të pasurive të paluajtshme, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shkëmbimi i pronave të kryhet pa shpërblim apo kompensim mbi vlerën e tyre.

3. Shkëmbimi të realizohet nëpërmjet një kontrate shkëmbimi me shoqërinë “*Classic S&P*”, sh.p.k., e cila do të nënshkruhet nga Bashkia Tiranë.

4. Pas shkëmbimit, pasuritë me numër 171/59 e 171/143, zona kadastrale 3963, të përdoren nga Bashkia Tiranë.

5. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR  
Erion Braçe**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

**ÇERTIFIKATË** 1822319  
**PËR VËRTETIM PRONËSIE**

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. TIRANË Zona Kadastrale Nr. 3963  
 Numri i Pasurisë 171/59 Volumi 3 Faqe 82  
 Adresa e Pasurisë FORTUZAJ  
 Lloji i Pasurisë PEMETORE  
 Sipërfaqja Totale 6572.00 m2  
 Nga kjo : Sa Truall \_\_\_\_\_ Nga kjo : Sa Ndërtesa - \_\_\_\_\_  
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes \_\_\_\_\_ %

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Zoti ( Zotërinjtë )

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
CLASSIC	S&J SHPK		1/1	TIRANË

- është pronar i \_\_\_\_\_ pasurisë me numër 171/59  
 - janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart \_\_\_\_\_  
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi \_\_\_\_\_  
 - kufizimet e pasurisë janë : V \_\_\_\_\_, L \_\_\_\_\_, J \_\_\_\_\_, P \_\_\_\_\_

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 10/5/2019 Nr 48072

Data e lëshimit të çertifikatës  
10/5/2019

Lëshuesi i çertifikatës  
REGJISTRUESI  
ARJAN VAKAJA

DREJTORIA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME  
TIRANË





M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

## KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 3, Fq. 82

## I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

--&gt; Vijon nga: Vol. , Fq.

Kadastrale: 3963 NR.i PASURISE : 171/59

Vijon në: Vol. , Fq. deri në: Vol. , Fq. --&gt;

Mueksi i Hartes: K-34-100-(40-A)

Adresa e Pasurisë: Rrethi TIRANË Q/F FORTUZAJ

PERFUNDIMTARE (data):

Rr/L P/G SH K Ap

## B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: PEMETORE Brenda V.K.N. : , Ref.:

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Trual	Nga Sip. Trual: sa Ndërtest
1. 6,572.00 m <sup>2</sup> Ref. 00000298	1. m <sup>2</sup> Ref.	1. m <sup>2</sup> Ref.
2. m <sup>2</sup> Ref.	2. m <sup>2</sup> Ref.	2. m <sup>2</sup> Ref.
3. m <sup>2</sup> Ref.	3. m <sup>2</sup> Ref.	3. m <sup>2</sup> Ref.
4. m <sup>2</sup> Ref.	4. m <sup>2</sup> Ref.	4. m <sup>2</sup> Ref.

Per pjesen e përbashkët:

PALLAT


Kuota e pjesmarjes:

%

Nr i Pasurise (pallat):

Vol. Faqe.

Përshkrim i veçantë:



## C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrimi	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
00000391	10/05/2019	Classic S&j Shpk			K724190020	I	TIRANË	3,943,200	10/05/2019	K.SH	

Shënime: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar (%)



  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
 ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

**ÇERTIFIKATË** 1822320  
**PËR VËRTETIM PRONËSIE**

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. TIRANË Zona Kadastrale Nr. 3963  
 Numri i Pasurisë 171/143 Volumi 3 Faqe 83  
 Adresa e Pasurisë FORTUZAJ  
 Lloji i Pasurisë PEMETORE  
 Sipërfaqja Totale 5428.00 m<sup>2</sup>  
 Nga kjo : Sa Truall \_\_\_\_\_ Nga kjo : Sa Ndërtesa - \_\_\_\_\_  
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes \_\_\_\_\_ %

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Zoti ( Zotërinjtë )

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
CLASSIC	S & J	SH.P.K.	1/1	TIRANE

- është pronar i pasurisë me numër 171/143

- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart \_\_\_\_\_

- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi \_\_\_\_\_

- kufizimet e pasurisë janë : V \_\_\_\_\_, L \_\_\_\_\_, J \_\_\_\_\_, P \_\_\_\_\_

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 10/5/2019 Nr 48075

Data e lëshimit të çertifikatës  
10/5/2019

Lëshuesi i çertifikatës  
REGJISTRUESI  
ARJAN KAZI







K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 3, Fq. 83

ENI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Kadastrale: 3963 NR. i PASURISE : 171/143

--> Vijeon nga: Vol. , Fq.

Indeksi i Hartes: K-34-100-(40-A)

Vijeon ne: Vol. , Fq. deri ne: Vol. , Fq. -->

Adresa e Pasurise: Rrethi TIRANE Q/F FORTUZAJ

PERFUNDIMTARE (data):

Rr/L P/G SH K Ap

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurise: PEMETORE Brenda V.K.N. : , Ref. :

Sip. Totale e Pasurise:	Nga Sip. Totale: sa Trual	Nga Sip. Truall: sa Nderest
1. 5,428.00 m <sup>2</sup> Ref. 00000298	1. m <sup>2</sup> Ref.	1. m <sup>2</sup> Ref.
2. m <sup>2</sup> Ref.	2. m <sup>2</sup> Ref.	2. m <sup>2</sup> Ref.
3. m <sup>2</sup> Ref.	3. m <sup>2</sup> Ref.	3. m <sup>2</sup> Ref.
4. m <sup>2</sup> Ref.	4. m <sup>2</sup> Ref.	4. m <sup>2</sup> Ref.

Per pjesen e perbashket:

PALLAT

Kuota e pjesmarjes:

%

Nr i Pasurise (pallat):

Vol. Faqe.



C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lesh. Çertifikatës	Shënime	Firma
00000391	10/05/2019	Classic S & J Sh.p.k.			K724190020	I	TIRANE	3,256,800	10/05/2019	K.SH	

shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar (%)



## VENDIM

Nr. 439, datë 26.6.2019

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH  
BUXHETORE BRENDË PROGRAMEVE  
TË MIRATUARA NË BUXHETIN E  
VITIT 2019, PËR MINISTRINË E  
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES  
SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor”, dhe të nenit 18, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor “Shërbimet e kujdesit parësor”, në artikullin 604, “Të tjera transferime korrente të brendshme”, të pakësohet fondi prej 749 300 000 (shtatëqind e dyzet e nëntë milionë e treqind mijë) lekësh.

b) Në programin buxhetor “Shërbimet e kujdesit dytësor”, në artikullin 604, “Të tjera transferime korrente të brendshme”, të shtohet fondi prej 749 300 000 (shtatëqind e dyzet e nëntë milionë e treqind mijë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**

## VENDIM

Nr. 440, datë 26.6.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN  
NR. 46, DATË 30.1.2019, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E  
SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE  
SPITALORE NGA SKEMA E  
DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË  
KUJDESIT SHËNDETËSOR  
PËR VITIN 2019”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Shtojca 2, bashkëlidhur vendimit nr. 46, datë 30.1.2019, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për spitalet për vitin 2019.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**





SHTOJCA NR.2  
BUXHETI PER SHERBIMIN SPITALOR 2019

000 LEKE

NR	SPITALET	BUXHET 2019					TOTAL
		600	601	602	604	rezerve	
1	BERAT	261,780	43,670	162,000			467,450
2	BULQIZE	70,250	11,700	30,000			111,950
3	DELVINE	33,100	5,370	5,500			43,970
4	DEVOLL	44,610	7,460	10,000			62,070
5	DIBER	233,780	38,980	110,000			382,760
6	ELBASAN	400,120	66,700	227,612			694,432
7	FIER	342,670	56,970	187,209			586,849
8	GRAMSH	106,350	17,780	36,000			160,130
9	GJIROKASTER	192,600	31,910	120,000			344,510
10	HAS	40,230	6,690	12,000			58,920
11	KAVAJE	101,630	16,910	28,000			146,540
12	KOLONJE	78,670	13,100	20,000			111,770
13	KORCE	378,900	62,850	185,000			626,750
14	KRUJE	113,170	18,850	26,000			158,020
15	KUCOVE	61,600	10,240	15,000			86,840
16	KUKES	226,450	37,780	100,000			364,230
17	KURBIN	73,940	12,400	28,000			114,340
18	LEZHE	224,650	37,460	112,000			374,110
19	LIBRAZHD	132,820	22,130	50,000			204,950
20	LUSHNJE	206,650	34,460	100,000			341,110
21	M.MADHE	21,270	3,550	6,000			30,820
22	MALLAKASTER	38,620	6,430	11,000			56,050
23	MAT	109,620	18,290	35,000			162,910
24	MIRDITE	93,440	15,600	25,000			134,040
25	PEQIN	33,900	5,600	5,500			45,000
26	PERMET	75,300	12,450	35,000			122,750
27	POGRADEC	150,380	25,090	70,000			245,470
28	PUKE	86,010	14,330	30,000			130,340
29	SARANDE	136,750	22,740	104,500			263,990
30	SKRAPAR	76,300	12,650	16,000			104,950
31	SHKODER	479,900	80,030	195,000			754,930
32	TEPELENE	80,900	13,500	16,000			110,400
33	QSUT	2,126,450	346,350	4,038,143			6,510,943
34	SUOGJ "Mbretresha Geraldine"	278,350	46,400	252,000			576,750
35	SUOGJ "Koço Gliozheni"	228,800	38,150	160,000			426,950
36	SU "Shefqet Ndroqi"	312,400	50,800	360,000			723,200
37	SU Trauma	117,150	19,500	130,000			266,650
38	TROPOJE	93,540	15,530	30,000			139,070
39	VLORE	367,100	61,150	271,959			700,209
40	PAKETAT E SHERBIMEVE NE SPITALET JOPUBLIKE				1,649,474		1,649,474
41	TRAJTIME ME VKM				40,000		40,000
42	TRANSFERTA PER INDIVIDET (MJEKE SPECIALISTE)				50,000		50,000
43	PAGESA TE SHERBIMEVE PPP				2,886,275		2,886,275
44	REZERVE					173,640	173,640
	<b>TOTAL</b>	<b>8,230,150</b>	<b>1,361,550</b>	<b>7,355,423</b>	<b>4,625,749</b>	<b>173,640</b>	<b>21,746,512</b>



**URDHËR**  
**Nr. 380, datë 26.6.2019**

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, përfshi përgjigjet e kërkesave social-juridike të përshpejtuara, z. Arben Dervishllari, drejtor i Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 27.6.2019 deri në datën 28.6.2019.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Arben Dervishllari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM I ARKIVAVE**  
**Ardit Bido**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 1064 lekë